

Organ Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes



Mbrojtja

Viti i 91-të i botimit
Mars 2023 / Nr. 3



**Qytetari i armës
në transformimin
e së ardhmes**

DREJTOR I QKMBMMFA
ARBEN SKËNDERAJ

Shefe e Sektorit të Botimeve & Kryeredaktore
ANJEZA MUSOLLARI

GRAPHIC DESIGNER
AFËRDITA HYSAJ

REDAKTORE / KORREKTORE
SUELA HODA

BASHKËPUNËTORË
KOLONEL HYSNI GJERGJI
PROF. ASOC. DR. ZAHO GOLEMI

REVISTA MBROJTJA
Organ Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes
Viti i 91-të i botimit
Nr. 3/ 2023


© Ministria e Mbrojtjes

Materialet e publikuara në këtë revistë nuk mund të riprodhohen elektronikisht apo fizikisht e të përdoren për qëllime përfuturi, pa marrë autorizim nga botuesit e saj.

Botues:
Qendra e Kulturës, Medias, Botimeve të Mbrojtjes dhe Muzeut
Drejtoria e Kulturës, Medias dhe Botimeve të Mbrojtjes

Adresa:
Rruga e Dibrës/ Garnizoni "Skënderbej"

Revista mund të gjendet në formatin elektronik (pdf) në adresën:
<http://www.mbrojtja.gov.al/index.php/publikimet/revista-mbrojtja>



Mbrojtja

- Arritjet dhe objektivat e Ministrisë së Mbrojtjes në rrugëtimin e saj përgjatë 2022 - 20234
- Ministri Peleshi: Vijimi i ndihmës për Ukrainën, me rëndësi për sigurinë e Aleancës7
- Peleshi në Forumin e Sigurisë dhe Mbrojtjes "Schuman": Bashkëpunimi, e vetmja rrugë për të siguruar paqen.....8
- Ministri Peleshi, komandantja e Gardës së New Jersey-it dhe ambasadorja Yuri Kim, vizitë në pikën e rekrutimeve në qendër të Tiranës12
- SHSHPFA, gjeneral brigade Arben Kingji merr pjesë në takimin e 188-të të Komitetit Ushtarak të NATO-s në Bruksel16
- Kryetari i Komitetit Ushtarak të NATO-s, admiral Rob Bauer, vizitë zyrtare në Shqipëri18
- KLO, vizita në Qendrën Kombëtare Operacionale të Emergjencave Civile, Komandën e FT dhe ROS.....22
- Hapet Kursi i Lartë i Sigurisë dhe Mbrojtjes (KLSM-13)23
- Kolonel Arben Toska: Ndihe mi krenarë për produktin e punës suaj, ambicien drejt standardeve të avancuara, të denjë për të shërbyer në radhët e Forcave të Armatosura24
- Atashetë ushtarakë të vendeve të NATO-s, të akredituar në Republikën e Shqipërisë, vizitojnë AFA-në26
- AFA zhvillon "FACULTY FOUNDATION DEVELOPMENT PROGRAM"27
- Presidenti Begaj: Në shërbim të jetës, atdheut, sovranit36
- Udhëtim të mbarë në shekullin XXI!.....58
- 1 prilli 'historik' i shqiptarëve62
- Bioterrorizmi: A duhet të shqetësohemi?.....66
- Konflikti në Ukrainë, në një fazë të re dhe më të ndërlikuar të luftës70
- Presidenti Bajram Begaj, vizitë në selinë e NATO-s74
- Uniforma ushtarake, kjo përfaqësi historike në kohë lufte dhe paqe78
- Shkolla ushtarake "Skënderbej", histori suksesi ndër breza.....84
- "Fidanishtja" skënderbegase, elita e sportit kombëtar92
- Siguria, mbrojtja dhe policimi në publikimet zyrtare shqiptare94

16

SHSHPFA, gjeneral brigade Arben Kingji merr pjesë në takimin e 188-të të Komitetit Ushtarak të NATO-s në Bruksel

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneral brigade Arben Kingji mori pjesë në takimin e 188-të të Komitetit Ushtarak të NATO-s...

50

Gjeneralmajor

Manushaqe Shehu: Nëse nuk ka tavan, kufi kemi qiellin, prandaj forca, mos pushoni, derisa çdonjëra prej grave dhe vajzave të ketë mundësinë që meriton!

04

Arritjet dhe objektivat e Ministrit të Mbrojtjes përgjatë 2022 - 2023

36

Presidenti Begaj: Në shërbim të jetës, atdheut, sovranit

Shqipëria europiane është Shqipëria e Gjergj Kastriotit dhe e Nënë Terezës, e Ismail Qemalit dhe e Fan Nolit; është Shqipëria e rinisë antifashiste dhe e studentëve të dhjetorit; është Shqipëria e qytetarëve që kanë dhunti e zotësi...



Intervistë me komandantin e AFA-së, gjeneral brigade Bilbil Bitri Drejt suksesit të “Defender Europe 2023”

Stërvița e NATO-s në Shqipëri, “Defender Europe 2021”, është konsideruar si tregues i nivelit të ngushtë të bashkëpunimit dhe i marrëdhënieve që Shqipëria ka me SHBA-të. Shqipëria ishte vendi mikpritës i stërviçes, me mbi 17 mijë ...

Faqe 54



Ish-presidenti Alfred Moisiu Një karrierë në ushtri, dhe gjithë jetën për ushtrinë...

Alfred Spiro Moisiu, lindi më 1 dhjetor 1929, në qytetin e Shkodrës. Ka kryer studimet e shkollës së mesme në Tiranë, me ndërprerje për shkak të luftës, në vitet 1941-1945. Ka marrë pjesë në Lëvizjen Antifashiste Nacional-Çlirimtare që në vitin 1942, fillimisht në grupet edukative...

Faqe 44





Arritjet dhe objektivat e **Ministrisë së Mbrojtjes** në rrugëtimin e saj përgjatë 2022 - 2023

Viti 2022 numëron një sërë arritjesh për Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura të Shqipërisë

- Nisja e punës për ndërtimin e Bazës Ajrore taktike të NATO-s, në Kuçovë;

“Shqipëria ka pozicion strategjik në Ballkanin Perëndimor, por është edhe vend aleat i NATO-s, i sigurt, i qartë në orientimin e vet edhe ka një rol të rëndësishëm për të luajtur edhe në vendet ku jetojnë shqiptarë: në Kosovë, Maqedoninë e Veriut, por edhe vende të tjera”, - u shpreh në fjalën e tij ministri Peleshi.

- Nënshkrimi i kontratës së shërbimit satelitor në fushën e Mbrojtjes dhe Sigurisë;
- Me vendim qeverie, u rritën në masën 30% pagat për të gjithë ushtarakët e Forcave të Armatosura;
- Falë bashkëpunimit të rëndësishëm dhe partneritetit strategjik me SHBA-të, ky vit mban rekordin e projekteve për modernizimin e FA-së e tre prej tyre janë:

- Nisja e zbatimit të projektit për ngritjen dhe fuqizimin e Njësisë Ushtarake të Mbrojtjes Kibernetike;

- Përfundimi i fazës së parë të projektit të komunikimit Tokë-Ajër-Tokë (GAG);

- Pajisja me sistemin raketor antitank “Javelin” dhe atë kundërajror “Stinger”;

• Një tjetër aspekt i rëndësishëm për FA-të është edhe fakti se SHBA aktivizoi në Shqipëri Shtabin e Përparuar të Komandës së Forcave Speciale amerikane.

• Shqipëria nënshkroi edhe marrëveshjen për shtimin e flotës ajrore me avionë luftarakë pa pilotë “Bayraktar” me kompaninë turke “Baykar”.

“Dronët ‘Bayraktar’ kanë reputacion, pasi kanë provuar të jenë të suksesshëm në kuptimin e aftësisë së tyre mbrojtëse ushtarake, por ne do t’i përdorim ato edhe për qëllime civile, madje shpresojmë të mos i përdorim për qëllime të tilla. Të kombinuar edhe me shërbimet satelitore

do të na japin një potencial të jashtëzakonshëm, i cili ka nevojë të dijë vetëm të përdoret”, - tha Peleshi.

Investimi i ri që po kryhet në mbështetje të Akademisë së FA-së

Po punohet për ndërtimin e kampusit të ri të AFA-së me të gjithë parametrat. Është duke përfunduar master-plani, aty ku sot është Batalioni i Mbështetjes.

Një investim që në rajon do të jetë projekti më i mirë, më i bukur dhe më i plotë.

Në situatën e re të sigurisë, sipas ministrit Peleshi sfidë është edhe ngritja e nivelit të kërkimit shkencor. “Ne duam ta bëjmë AFA-në realisht avangardë të mendimit shkencor, të dijes, të karakterit. Synojmë që të përgatisim këtu ekselencën karakteriale, por edhe të dijes shqiptare, të japim shembujt dhe modelin më të mirë të patriotëve të vërtetë me vepra dhe jo me fjalë. Ne po ndërtojmë qendrën e Inovacionit, e cila po merr jetë dhe shumë shpejt do të jetë funksionale”, - deklaroi ministri i Mbrojtjes.

I suksesshëm rezultoi për Batalionin e Këmbësorisë së Lehtë ky vit, pasi u certifikua si “combat ready” nga NATO - Grup

- Gjatë këtij viti nisi zbatimin e projektit që shndërron Akademinë e FA-së nën modelin amerikan “West Point”, ndërsa nisi edhe viti i parë akademik në Kolegjin e Mbrojtjes.
- Shqipëria vazhdon të jetë me sukses eksportuese e paqes me 7 misione jashtë vendit, duke u bashkuar rishtas në misionin e ri të NATO-s në Novo Selo, Bullgari.
- Që nga nisja e agresionit rus në shkurt të vitit 2022, Shqipëria u rreshtua në anën e paqes dhe sigurisë, duke qenë një mbështetëse aktive në nivel politik dhe ushtarak për Ukrainën.
- Emergjencat civile morën një tjetër vëmendje të shtuar. Shqipëria u bë anëtare e Mekanizmit Europian të Mbrojtjes Civile, ndërsa u themelua Qendra Kombëtare Operacionale e Emergjencave Civile.
- U nënshkrua marrëveshja e huasë me qe-verinë italiane prej 30 milionë eurosh për fuqizimin e Sistemit të Mbrojtjes Civile. U mbështetën 13 projekte për Bashkitë për reduktimin e riskut nga fatkeqësitë natyrore.

Sporti dhe kultura morën një dimension të ri brenda FA-së

- U krijua një strukturë e posaçme e sportistëve elitare pranë Ministrisë së Mbrojtjes si dhe u ngrit Orkestra Simfonike dhe kori i Forcave të Armatosura.
- Me rastin e 110 - vjetorit të Pavarësisë dhe 110 - vjetorit të krijimit të Forcave të Armatosura, 300 artistë nga vendet e NATO-s dhe Kosovës performuan në Tiranë.
- Pas një ndërprerjeje disavjeçare, del print revista “Mbrojtja”, organ i Ministrisë së Mbrojtjes.
- Drejt hapësirës nisen satelitët “Albania 1”, “Albania 2”.

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi: “Sa i përket satelitëve “Albania 1” dhe “Albania 2”, imazhet që do sigurohen prej tyre do të kontribuojnë në shumë elementë. Satelitët japin informacionin. Ju siguroj që satelitët do jenë një mjet i rëndësishëm për t’u përdorur nga institucione e Policisë së Shtetit. Kur investon në teknologji investon për të kursyer. Janë kursim kohe dhe parash. Ne kemi një agjenci shtetërore që kanë bërë një punë fantastike. Këto dy kapacitete do jenë vlerë e shtuar, por edhe kursim parash për buxhetin e shtetit.”

Përgjatë vitit 2023 rritja e pagave do të vijojë edhe me 7% për të gjitha gradat, si dhe do zbatohet implementimi i paketës sociale për ushtarakët.

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi tha se këtë vit do t’i jepet më shumë prioritet fushës së sigurisë kibernetike. Këtë vit do të ndërtohet qendra operacionale e fushës kibernetike.



Ministri Peleshi u shpreh se: “2023 do të jetë viti kur njësia ushtarake e Mbrojtjes Kibernetike do të ketë plotësuar 100% kapacitetet e veta njerëzore.

Një proces i rëndësishëm i FA-së janë rekrutimet

Duke ndryshuar strukturën është trefishuar numri i kapaciteteve.

- Janë rritur pagat, duke i bërë më fleksibël;
- Për specialistët e fushës së IT-së dhe Sigurisë Kibernetike po aplikohet një regjim i veçantë kompetitiv.

Vëmendje e veçantë gjatë vitit 2023 do t’iu kushtohet edhe Emergjencave Civile

Dy avionë dhe mjete të posaçme për Mbrojtjen Civile do i shtohen vendit tonë me anë të kredisë me vlerë 30 milion euro pas marrëveshjes me Italinë.

Miratohet fondi prej 200 milionë lekësh për emergjencat civile

Ministria e Mbrojtjes alokoi fondin brenda 2 ditësh pas kërkesës së kryetarëve të Bashkive, pas evidentimit të një problematike emergjente apo shterimit të mundësive të tyre për ndërhyrje.

Ndërsa qeveria italiane do të bëjë një financim prej 30 milionë eurosh për emergjencat civile në Shqipëri. Në çdo rast që bashkitë do të përballen me situata të krijuara nga Emergjencat Civile, brenda dy ditësh ata mund të marrin fondin e nevojshëm për të mbuluar shpenzimet e paparashikuara në buxhetet e tyre.



Prioritetet e vitit 2023

- Shqipëria do të vazhdojë të jetë vend kontribuues në arenën ndërkombëtare. Do të punohet për shtimin e personelit pjesëmarrës të FARSH-it në OKB.
- Do të mbahet në nivelet më të larta konsultimi diplomatik dhe ndërveprueshmëria në këtë fushë me strukturat e aleancës, për një përfaqësim sa më dinjitoz në Samitin e Vilnius-it, në korrik 2023, si dhe në Ministerialin e Ministrave të Mbrojtjes së NATO-s.
- Me marrjen e statusit të vendit kandidat, mjaft e rëndësishme është dhe vëmendja që do t'i kushtohet bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë në Bashkimin Europian, me synim implementimin e projekteve, thithjen e fondeve, plotësimin e detyrimeve në nivel kombëtar.

- Në vitin 2023 do të vijojë partneriteti në OSBE, me pjesëmarrjen në aktivitetet e kësaj organizate, duke u bërë pjesë e projekteve të reja, si dhe inspektimeve të armë-kontrollit.

- Bashkëpunimi dypalësh do të jetë intensiv, ndërmjet strukturave të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm, me atashetë e huaj ushtarakë të akredituar në vend si dhe me atashetë ushtarakë të Republikës së Shqipërisë në vendet aleate.

- Shqipëria në nivel rajonal do të ndjekë politikën e fqinjësisë së mirë, bashkëpunimit me vendet e Ballkanit Perëndimor, duke promovuar qartë politikën e “dyerve të hapura” në rajon.

- Kosova, në rrafshin diplomatik, mbetet interesi ynë kombëtar i rëndësishëm.

- Do të punohet për zhvillimin dhe mbrojtjen, në gatishmëri të kapaciteteve tokësore, detare, ajrore si dhe mbështetjen logjistike në të gjitha nivelet e komandim-kontrollit, për pjesëmarrje në operacionet e mbrojtjes kombëtare dhe kolektive ndaj krizave të paparashikuara dhe përballimit me efikasitet të emergjencave civile/fatkeqësive natyrore.

- Rritja e ndërveprueshmërisë, si brenda FA-së ashtu edhe me vendet e aleancës në aktivitetet stërvitore dhe zhvillimit të kapaciteteve, bazuar në doktrinën e Aleancës.

- Modernizimi, si një proces shumë-nivelesh dhe i pandashëm.

- Forca tokësore do të vijojë kompletimin me mjete të blinduara taktike, armatim dhe aksesore për të gjithë tipat e armatimit të lehtë të këmbësorisë; kompletimin me sisteme të mbështetjes me zjarr. Gjithashtu kompletimi i

sistemit radar i lokalizimit të armatimit të artilerisë së kundërshtarit etj.

- Forca Detare do të vijojë modernizimin dhe rinovimin e Sistemit të Integruar të Vëzhgimit të Hapësirës Detare; Zhvillimin e kapaciteteve të Qendrës së Zhytjes, si kapacitet kombëtar; Sigurimin e pajisjeve speciale për operacionet e ndalimit detar.

- Forca Ajrore do të vijojë me rritjen e kapaciteteve të flotës ajrore me helikopterë “Black Hawk”, pajisjen me kapacitete luftarake të papilutuar, kapacitete të mbrojtjes ajrore.

- Komanda Mbështetëse do të vijojë, me kompletimin e kompanisë EOD, me mjete speciale, si dhe me zbatimin e projektit të modernizimit me mjete transporti dhe speciale për FA-në.



Takimi i Ministrave të Mbrojtjes të NATO-s

Ministri Peleshi: Vijimi i ndihmës për Ukrainën, me rëndësi për sigurinë e Aleancës

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi mori pjesë në Takimin dyditor të Ministrave të Mbrojtjes të vendeve të Aleancës, që u mbajt në selinë e NATO-s në Bruksel. Fokusi i diskutimeve ishte lufta në Ukrainë, e cila javën që vjen shënon njëvjetorin e fillimit të saj. Përfaqësuesit e lartë të vendeve të Aleancës theksuan nevojën urgjente për më shumë mbështetje me sisteme armatimi, tanke, artileri dhe municione të kalibrave të ndryshëm, me qëllim mbrojtjen e Ukrainës nga agresioni rus.

Këto çështje u adresuan edhe gjatë takimit të veçantë të Grupit të Kontaktit për Mbrojtjen e Ukrainës, që u mbajt para fillimit të Takimit të Ministrave të Mbrojtjes, në selinë e NATO-s, ku pjesë ishte gjithashtu edhe ministri i Mbrojtjes, Niko Peleshi. Sekretari i Përgjithshëm i Aleancës, z. Jens Stoltenberg theksoi rëndësinë e rritjes së furnizimeve me armatim dhe municione për Kievin, në një kohë mjaft kritike për fatin e luftës atje.

Vëmendje të veçantë mori edhe forcimi i elementëve të parandalimit dhe mbrojtjes së NATO-s, si dhe ngritja dhe zhvillimi i industrive të prodhimit të armatimit dhe municioneve të vendeve të Aleancës, me qëllim

kompensimin e armatim - municioneve të dërguara në Ukrainë, por edhe për të shtuar rezervat e aleatëve. Ministri i Mbrojtjes, z. Niko Peleshi, veç pjesëmarrjes në Takimin e Ministrave të Mbrojtjes dhe në Takimin e Grupit të Kontaktit për Ukrainën, mori pjesë edhe në Takimin e Ministrave të Mbrojtjes së vendeve kontribuuese në Grup-Batalionin e drejtuar nga Kanadaja në Letoni.

Ministri Peleshi e vlerësoi këtë takim si mjaft të rëndësishëm, në një moment tepër kritik për mbrojtjen dhe sigurinë e Aleatëve. Po ashtu, ministri Peleshi cilësoi të rëndësishme edhe ndihmën e vazhdueshme për Ukrainën, duke vlerësuar popullin ukrainas për kurajën dhe vendosmërinë e treguar, si dhe lidershipin e qeverisë, ndërsa po i afrohem përvjetorit të parë të fillimit të luftës.

Ky takim shërbeu edhe për hapjen e diskutimeve dhe çështjeve që priten të trajtohen gjatë Samitit të NATO-s, që do të mbahet në Vilnius, Lituani, më 11 - 12 korrik të këtij viti. Gjatë takimeve në Bruksel, ministri Peleshi i shprehu ngushëllime homologut turk, për jetët e humbura nga tërmeti shkatërrues i 6 shkurtit, që preku Turqinë dhe Sirinë.



Peleshi në Forumin e Sigurisë dhe Mbrojtjes “Schuman”: Bashkëpunimi, e vetmja rrugë për të siguruar paqen

Ministri i Mbrojtjes, Niko Peleshi mori pjesë në Forumin e Partneritetit të Sigurisë dhe Mbrojtjes “Schuman”, me temë “Së bashku më të fortë, në një botë të paqëndrueshme”, që u mbajt në Bruksel.

Ministri Peleshi mori fjalën në panelin me temë “T’i përgjigjemi së bashku krizës”, ku foli për ndryshimin e sigurisë ndërkombëtare, pas agresionit rus në Ukrainë: “Imazhi i sigurisë ndërkombëtare ka ndryshuar thellësisht. Agresioni i pandër-

prerë rus ndaj Ukrainës ka nxjerrë në pah rëndësinë e sigurisë si një çështje politike. Pas tronditjes së skenës së sigurisë, konfliktet e mundshme të fjetura dhe çështjet e pazgjidhura ndërmjet shteteve janë bërë gjithnjë e më delikate. Vendet me të drejtë janë bërë më vigjilente dhe po ndërmarrin hapa për t’u përgatitur për konflikte të mundshme, duke rritur kapacitetet e tyre të mbrojtjes”, - u shpreh ministri Peleshi.

Sipas ministrit Peleshi, krizat e mëdha zakonisht e çojnë

historinë në një nyje kritike dhe nevoja për zgjidhje oportune sjell në skenë idetë e mëdha inovative. Ai shtoi se ky forum mbahet pikërisht në një kohë kur paqja dhe siguria janë në kërcënim, ndaj shtoi ai: “Le ta kthejmë nevojën për zgjidhje në një shtysë për një kapërcim të qëndrueshëm në mënyrën sesi përgatitemi për të parandaluar krizat, në vend që të përballemi me pasojat e padëshiruara”.

Ministri i Mbrojtjes vuri theksin tek përpjekjet dhe investimet që po bëheshin në bashkëpunim me SHBA-të, BE-në dhe NATO-n, sa i përket sigurisë kibernetike: “Forcimi i sigurisë kibernetike, kjo fushë e re luftarake, kërkon investime në infrastrukturë si edhe në kapacitetet njerëzore dhe duhet të zhvillohet në një kohë të shkurtër dhe njëkohësisht me një buxhet mjaft të madh”, - tha ministri. Duke theksuar se vendet duhet të jenë më vigjilentë ndaj kësaj lufte të re, me të cilën Shqipëria u përball vitin e kaluar, z. Peleshi tha se: “Përvoja e Shqipërisë mund të shërbejë si një ‘epurve të’, ose shembull për vendet e tjera evropiane apo dhe vetë strukturat evropiane. Natyra e disa krizave shkon përtej kontrollit dhe aftësisë së një shteti të vetëm, pavarësisht nga fuqia apo pasuria e tij. Lufta kibernetike është një shembull klasik. Duke qenë se kjo lloj lufte nuk njej kufij, luftimi i saj brenda kufijve të një vendi është i pasuksesshëm”. Ministri i Mbrojtjes foli edhe për rrezikun që i kanoset Ballkanit Perëndimor nga një përhapje e mundshme e konfliktit në Ukrainë: “Ballkani Perëndimor sot ndihet i kërcënuar si nga ndryshimet gjeopolitike globale, por veçanërisht nga rreziku që mund të krijohet nga përhapja e mundshme e luftës në Ukrainë. Ka vende që nuk kanë njohje reciproke, si Kosova dhe Serbia dhe ka vende ku dallimet etnike mund të krijojnë

destabilitet, si Bosnja dhe Hercegovina. Për më tepër, prania e ndikimit rus në median dhe politikën e disa vendeve të rajonit ka shkaktuar shqetësim. Përballë këtyre rrethanave, e vetmja mënyrë për të siguruar paqen dhe stabilitetin është pjesëmarrja në ‘të njëjtin klub’, integrimi i përbashkët në strukturat euroatlantike. Në dallim nga njëri - tjetri kostoja e izolimit është edhe më e madhe se kostoja e integritimit. Dialogu Kosovë - Serbi dhe marrëveshja e pranuar reciprokisht së fundmi mund të le-



htësojnë ‘pranverën’ e shumëpritur mes dy vendeve dhe të sjellin një epokë të artë të paqes dhe përparimit të garantuar për rajonin në familjen evropiane”, - u shpreh në fjalën e tij, ministri i Mbrojtjes, Niko Peleshi.



MINISTRI I MBROJTJES NIKO PELESHI, vizitë zyrtare në Pentagon

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, gjatë vizitës së tij zyrtare në SHBA, u prit në Pentagon nga sekretari amerikan i Mbrojtjes, Lloyd J. Austin III.

Bisedimet e tyre u fokusuan në vazhdimin e bashkëpunimit strategjik të Shqipërisë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës në fushën e Mbrojtjes dhe Sigurisë si dhe në forcimin e dialogut politik.

Sekretari Austin dhe ministri Peleshi diskutuan për ndihmën që iu dha Shqipërisë nga Garda Kombëtare e New Jersey-t, pas sulmit kibernetik dhe ranë dakord të vazhdojnë të punojnë së bashku për të forcuar edhe më shumë aftësitë e mbrojtjes kibernetike të Ministrisë së Mbrojtjes së Shqipërisë.

Ministri i Mbrojtjes Peleshi shprehu falënderimet për mbështetjen e menjëhershme që dhanë ekipet e specializuara amerikane të mbrojtjes kibernetike, ndërsa shprehu nevojën që mbështetja e SHBA-ve të jetë më e zgjeruar edhe për sistemet e tjera në vend, veç atyre të Ministrisë së Mbrojtjes.

Gjatë bisedës, Ministri Peleshi e konsideroi vitin e kaluar, vit rekord sa i përket projekteve të përbashkëta me SHBA-të, duke përmendur këtu nisjen e punës për Bazën Taktike të NATO-s në Kuçovë, modernizimin e Forcës Ajrore me helikopterët "Black Hawk", si dhe projektet në edukimin ushtarak, etj.

Ministri Peleshi i prezantoi sekretarit amerikan të Mbrojtjes edhe projektin e portit të ri të Porto Romanos si dhe rëndësinë strategjike që ky port ka për rajonin, Evropën Juglindore dhe Aleancën e NATO-s. Gjithashtu theksoi angazhimin e vendit tonë për të qenë faktor stabiliteti në rajon dhe më gjerë, ndërsa u shpreh se Kosova është interesi ynë strategjik kombëtar dhe ne e mbështesim aspiratën euroatlantike të Kosovës. Sekretari Lloyd J. Austin III falënderoi ministrin Peleshi për pritjen që Shqipëria i bëri Stërvitjes "Defender Europe - 21" dhe të Brigadës së Ndihmës së Forcave të Sigurisë së Ushtrisë Amerikane. Sekretari Austin përgëzoi ministrin Peleshi për mbështetjen e palëkundur të Shqipërisë për Ukrainën, për angazhimin në NATO dhe përfshirjen në të gjitha operacionet e Aleancës.





Takimi i 10-të i Grupit të Kontaktit për Ukrainën

Ministri Peleshi: Në unitet me partnerët tanë, në emër të lirisë dhe të drejtës së jetës në Ukrainë

Ministri i Mbrojtjes, Niko Peleshi dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneral brigade Arben Kingji morën pjesë në takimin e dhjetë të Grupit të Kontaktit për Ukrainën, thirrur nga Sekretari i Mbrojtjes i SHBA-ve, Lloyd J. Austin III.

Takimi u mbajt virtualisht dhe pjesë e tij ishin dhe vendet anëtare dhe partnere të NATO-s.

Ministri Peleshi u shpreh se: “Në takim, mes 54 vendeve pjesëmarrës, aleatë dhe partnerë të koalicionit, u vlerësua qëndresa e popullit dhe qeverisë ukrainase, duke mbështetur fort përpjekjet për të mbrojtur territoret e rimarra dhe çlirimin e atyre që janë ende nën pushtimin rus.

Në fund të fjalës së tij, ministri Peleshi shprehu solidaritetin e tij dhe shtetit shqiptar ndaj Ukrainës: “Në unitet me partnerët tanë, për të vijuar ndihmën në emër të lirisë dhe të drejtës së jetës në Ukrainë”.

Ukraina ndodhet në luftë që prej 24 shkurtit të kaluar, kur u sulmua nga Rusia. Shqipëria dhe Forcat e Armatosura

shqiptare janë rreshtuar në krah të aleatëve në mbështetje të Ukrainës dhe popullit të saj, në këtë luftë të padrejtë dhe të paligjshme të Rosisë ndaj shtetit fqinj dhe sovran.

Ky është takimi i 10-të i Grupit të Kontaktit për Mbështetjen e Ukrainës, që nga krijimi i tij në prill 2022 dhe i treti për vitin 2023.





Ministri Peleshi, komandantja e Gardës së New Jersey-it dhe ambasadorja Yuri Kim, vizitë në pikën e rekrutimeve në qendër të Tiranës

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi së bashku me ambasadorën amerikane Yuri Kim dhe komandanten e Gardës Kombëtare të New Jersey-it, gjeneral brigade Lisa Hou, e cila ndodhet në Shqipëri vizituan pikën e rekrutimeve të ngritur në qendër të Tiranës. Komandantja e

Gardës Kombëtare të New Jersey-it dhe ambasadorja Yuri Kim diskutuan me pjesëtarë të FA-së dhe të rinjtë që kanë shprehur interes për të aplikuar për 400 pozicionet e lira dhe për t'u bërë pjesë e Forcave të Armatosura. Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, teksa shpjegoi reformat e ndërmarra vitet e fundit në Forcat e Armatosura dhe në

fushën e mbrojtjes, vlerësoi mbështetjen dhe partneritetin strategjik me SH-BA-të. “Jemi duke reformuar edhe infrastrukturën, por edhe sistemin e shpërblimeve, pagesave, trajtimit social të ushtarakëve tanë. Kështu që ka shumë arsye se përse të rinjtë e sotëm ia vlen ta konsiderojnë dhe të bëhen pjesë e Forcave të Armatosu-

ra dhe Akademisë së FA-së. Unë jam i lumtur që jam sot me dy përfaqësuese të partnerit tonë strategjik që është më pranë Ministrisë së Mbrojtjes, me ambasadorin Yuri Kim, por edhe me gjeneralen Hou nga Garda e New Jersey-it. Me Gardën e New Jersey-it kemi celebruar 20-vjetorin e partneritetit. Një mbështetje e gjithanshme. Një nga mbështetjet është edhe ngritja e kapaciteteve të pilotëve tanë dhe teknikëve për flotën e re të helikopterëve “Black Hawk”, që ne jemi duke ngritur. Së shpejti presim helikopterët e parë. Jemi me fat që kemi partnerë të tillë, aq më tepër kur siguria dhe mbrojtja është një prioritet i dorës së parë për të gjithë globin”, - u shpreh ministri Peleshi. Gjeneral brigade Lisa Hou vlerësoi gjithashtu bashkëpunimin me Shqipërinë. “Kemi 20 vjet partneritet dhe ai bëhet më i fortë çdo vit. Ne trajnohemi së bashku, zhvillohemi së bashku dhe e bëjmë njëri-tjetrin më të fortë”, - tha Komandantja e Gardës Kombëtare të New Jersey-it. Nga ana e saj, ambasadorja Yuri Kim bëri një thirrje për të gjithë të rinjtë shqiptarë të bëhen pjesë e FA-ve, për t’i shërbyer vendit. “Forcat e Armatosura janë shumë të rëndësishme për çdo vend, përfshirë SHBA-të dhe Shqipërinë. Shpresojmë që njerëzit më të mirë të afrohen për t’i shërbyer vendit. Kështu

që kjo fushatë rekrutimesh është shumë impresionuese”, - u shpreh ambasadorja amerikane Yuri Kim. I gjithë muaji mars do të jetë muaji i rekrutimeve për pozicionet ushtar/detar aktiv në Forcat e Armatosura. Ministria e Mbrojtjes ka hapur ap-

likimet në Qendrën e Personel Rekrutimit, por edhe në pikën e ngritur në qendër të kryeqytetit për t’u dhënë mundësinë të gjithë të rinjve të përfitojnë nga 400 pozicionet e lira, duke garantuar trajtimin të mirë financiar dhe social.



Ministri Peleshi: Progres drejt rritjes së numrit të grave në sektorët prioritarë, siç është siguria kibernetike, ku 50% janë gra dhe vajza

Një ekip i Gardës Kombëtare të New Jersey - it, së bashku me gra dhe vajza të Forcave të Armatosura të Shqipërisë organizuan në Tiranë Forumin “Sfidat e sigurisë në Evropë - Gratë, paqja dhe siguria”. Synimi i këtij aktiviteti, me rastin e Festës së Gruas, është fuqizimi i rolit të grave ushtarake, si pjesë e Forcave të Armatosura. Në forumin, që shërbeu edhe si një trajnim për gratë ushtarake për çështje që lidhen me sigurinë e paqen, ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi falënderoi Gardën Kombëtare të New Jersey - it.

Z. Peleshi theksoi përparimin që është bërë në Forcat e Armatosura të Shqipërisë, duke hequr kufizimin e pjesëmarrjes së vajzave dhe grave në FA. “Sfidat e sigurisë janë bërë më të mprehta, për më tepër për një rajon si rajoni ynë i Ballkanit Perëndimor, i cili është një rajon ende i brishtë. Kemi një direktivë të OKB-së për barazinë gjinore, mbi të cilën në 2022 ne hartuam edhe Planin e Barazisë Gjinore në çështjet e sigurisë dhe të mbrojtjes për një periudhë 10 - vjeçare. Ne kemi bërë një progres të rëndësishëm në aspektin e dokumenteve, sepse deri në vitin 2022 ne kemi pasur një kufizim, që tanimë duket absurd, dhe i tillë ka qenë, pra në Forcat e Armatosura nuk duhet të kishte më shumë se 15% gra. Tani ky kufizim është hequr. Në planin tonë nuk ka kufizim. Kemi rritje të konsiderueshme të pjesëmarrjes në FA, rritje të titullimit të oficerëve të reja, të rritjes së numrit të grave e vajzave në sektorët shumë prioritarë,

siç është siguria kibernetike, ku 50% janë gra dhe vajza”, - u shpreh ministri Peleshi.

E pranishme në forum, ambasadorja amerikane Yuri Kim, vlerësoi Shqipërinë si aleatë të denjë të SHBA-ve. “Për ne, për SHBA-të, është një parim i qartë.

Ne duam të jemi bashkë me vendet e tjera që besojnë si ne, që fëmijët tanë duhet të jetojnë në një botë të lirë, të hapur, të sigurt dhe që përparon. Dhe për ne nuk ka një aleat më të mirë se sa Shqipëria. Ne jemi krenarë t’ju kemi aleatë në NATO. Ne jemi krenarë të



shohim përparimin tuaj në rrugën drejt anëtarësimit të plotë në Bashkimin Evropian”, - u shpreh ambasadorja Kim. Duke kujtuar thënien e heroit tonë kombëtar, Gjergj Kastrioti - Skënderbeu, “Bashkimi bën fuqinë”, ambasadorja tha se Shqipëria dhe SHBA-të duhet të qëndrojnë së bashku dhe ky është një komponent kyç në përballimin e sfidave të sigurisë në të gjithë botën.

Ndërsa komandantja e Gardës Kombëtare të New Jersey - it, gjeneral brigade Lisa Hou foli për sfidat e sigurisë në Evropë që vijnë jo vetëm për shkak të luftës në Ukrainë. Sipas saj, shumë shtete po përballen sot me sfida në sigurinë kibernetike, ndaj edhe vuri theksin në forcimin e bashkëpunimit mes të gjitha vendeve të NATO-s.



“Për SHBA-të, është një parim i qartë. Ne duam të jemi bashkë me vendet e tjera që besojnë si ne, që fëmijët tanë të jetojnë në një botë të lirë, të sigurt dhe që përparon. Për ne nuk ka një aleat më të mirë se sa Shqipëria. Ne jemi krenarë t’ju kemi aleatë në NATO.”





SHSHPFA, gjeneral brigade Arben Kingji merr pjesë në takimin e 188-të të Komitetit Ushtarak të NATO-s në Bruksel



Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneral brigade Arben Kingji mori pjesë në takimin e 188-të të Komitetit Ushtarak të NATO-s në Bruksel. Në këtë takim, vëmendje të veçantë mori diskutimi mbi sfidat e reja me të cilat përballet Aleanca dhe nisja e një faze të re të mbrojtjes kolektive. Takimi u përcoll me një mesazh të qartë ndaj përkushtimit të vendeve anëtare për një bashkëpunim sa më të ngushtë në implementimin dhe ndërthurjen e koncepteve dhe planeve të reja të mbrojtjes së NATO-s; si dhe mbështetjen e përbashkët ndaj luftës në Ukrainë dhe ecurinë e misionit KFOR, në ruajtjen e qëndrueshmërisë së sigurisë në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Përgjatë sesioneve dyditore të takimit, gjeneral brigade Kingji paraqiti qëndrimin zyrtar të Shqipërisë dhe FARSH-së, duke vlerësuar maksimalisht rolin e NATO-s në përgjigje ndaj zhvillimeve të fundit brenda Aleancës dhe në rajonin tonë.



SHSHPFA, takim me personelin nënoficer

Në sallën e auditoriumit të Ministrisë së Mbrojtjes u zhvillua takimi i shefit të Shtabit të Përgjithshëm, gjeneral brigade Arben Kingji me personelin nënoficer kryekapter/kapter të FA-së.

Në këtë takim u ndanë mendime, ide, si dhe këshillat për fuqizimin e rolit të nënoficerit si instruktor, planëzues stërvitjeje dhe ekspert i zoti në çdo fushë, përmes disiplinës, kërkesës për vetëzhvillim dhe punës profesionale të vazhdueshme.

Të gjithë trupës së nënoficerëve, gjeneral brigade Kingji iu shprehu falënderimet e tij për karakterin, integritetin dhe motivimin e fortë që ekziston mes tyre, duke treguar cilësitë më të mira në çdo stërvitje dhe angazhim, brenda dhe jashtë vendit.



Kryetari i Komitetit Ushtarak të NATO-s, admiral Rob Bauer, vizitë zyrtare në Shqipëri

Me ftesë të shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneral brigade Arben Kingji, kryetari i Komitetit Ushtarak të NATO-s, admiral Rob Bauer zhvilloi një vizitë zyrtare në vendin tonë. Në vizitën e zhvilluar në Ministrinë e Mbrojtjes, ai u prit me nderimet më të larta ushtarake nga gjeneral brigade Kingji. Admiral Bauer, gjatë takimit me gjeneral brigade Kingjin, e falënderoi atë për mikpritjen e përzemërt si dhe i shprehu mirënjohjen për mundësinë e njohjes nga afër me kapacitetet ushtarake të Forcave të Armatosura të Shqipërisë. Gjatë takimit, ai vlerësoi maksimalisht rolin dhe kontributin e vendit tonë në NATO.

“Shqipëria është një aleat i vyer. Në këtë epokë të re të mbrojtjes kolektive, ne jemi më të fortë së bashku. Vendi juaj jep kontribute jetësore në NATO, jo vetëm në angazhimet në misionet paqeruajtëse në KFOR, në Kosovë dhe Irak, po ashtu kontribuon me trupa në grup-batalione shumëkombëshe në Letoni dhe Bullgari. Ky është një komponent i rëndësishëm i shkurajimit dhe mbrojtjes së NATO-s në krahun lindor të Aleancës”, - u shpreh ndër të tjera admiral Bauer.

Nga ana e tij, shefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneral brigade Arben Kingji falënderoi admiralin Bauer për vlerësimet e larta për rolin dhe kontributin e FARSH në operacionet e NATO-s, duke u shprehur ndër të tjera: “Ne jemi krenarë që shërbejmë sot me dinjitet në vijën e parë të frontit të Aleancës, në këto kohë të vështira, kur siguria është e kërcënuar, të rreshtuar përkrah aleatëve në Letoni, Bullgari e deri në Kosovë”, - u shpreh gjeneral Kingji.

Më tej, takimet e admiralit Bauer vijuan me krerët më të lartë të qeverisë, ai u prit nga Presidenti i Republikës, z. Bajram Begaj, Kryeministri i Shqipërisë, z. Edi Rama dhe ministri i Mbrojtjes, z. Niko Peleshi.

Presidenti i Republikës, Bajram Begaj, në takim me kryetarin e Komitetit Ushtarak të NATO-s, admiral Rob Bauer, e falënderoi për vizitën në Shqipëri në këtë

kohë sfidash për paqen dhe sigurinë në hapësirën euroatlantike, si pasojë e agresionit të paligjshëm të Rusisë ndaj Ukrainës. Presidenti Begaj vlerësoi Admralin Bauer për drejtimin me vizion dhe përkushtim të Komitetit Ushtarak dhe kontributin që Komiteti Ushtarak jep në drejtim të përshtatjes dhe forcimit të kapaciteteve dhe kohezionit të aleancës.

Kreu i Shtetit bëri me dije se, Shqipëria mbetet e angazhuar në misione dhe operacione të NATO-s, ka rritur kontributet për vitin 2023 në KFOR, dhe është e gatshme për rritjen e tyre nëse do të jetë e nevojshme. Shqipëria qëndron në krah dhe do vijojë të mbështesë Ukrainën në aspektin politik, diplomatik dhe ushtarak.

Në vijim, Presidenti Begaj vlerësoi angazhimin e NATO-s në rajon dhe rolin e misionit të KFOR-it në ruajtjen e paqes dhe sigurisë. Shqipëria mbështet dialogun ndërmjet Serbisë dhe Kosovës të ndërmjetësuar nga BE dhe mbështetur nga SHBA-të në drejtim të arritjes së një marrëveshjeje, Kosova që nga viti 2008 është e pavarur dhe me vizion të qartë euroatlantik dhe në këtë kontekst mbështet një bashkëpunim akoma më të ngushtë dhe të thelluar me NATO-n.

Kreu i Shtetit diskutoi edhe lidhur me sulmin kibernetik të sponsorizuar nga Irani ndaj Shqipërisë dhe vlerësoi





bashkëpunimin me NATO-n për rikuperimin nga ky sulm. Në këtë drejtim Presidenti Begaj vlerësoi thellimin e bashkëpunimit dhe kontributit që struktura, agjenci dhe entitete të NATO-s mund të japin në drejtim të forcimit të mbrojtjes kibernetike, përfundimtare që do çojë në njohje reciproke.

Ndërsa në takimin me kryeministrin shqiptar, z. Edi Rama, admiral Bauer u fokusua në rëndësinë e qëndrueshmërisë kibernetike dhe angazhimit të Shqipërisë në Ballkanin Perëndimor.

Kryetari nënvizoi rolin pozitiv që Shqipëria po luan për të promovuar paqen dhe stabilitetin në rajon. “Vlerësoj angazhimit të Shqipërisë për të promovuar stabilitetin dhe bashkëpunimin në të gjithë Ballkanin Perëndimor. Kontributet e Shqipërisë në NATO forcojnë jo vetëm sigurinë rajonale, por edhe atë evropiane”, - shtoi ai.

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi e vlerësoi këtë vizitë si mjaft të rëndësishme në një kohë të trazuar për situatën e mbrojtjes dhe sigurisë, jo vetëm në kontinentin evropian, por në të gjithë botën mbarë.

Më tej ministri i Mbrojtjes e përgëzoi kreun e Komitetit Ushtarak për lidhshmërinë e treguar deri më tani me autoritetet më të larta ushtarake të NATO-s si dhe për këshillat ushtarake mjaft të vlefshme dhe profesionale, të marra nëpërmjet konsensusit të të gjithë vendeve anëtare dhe rëndësinë e tyre në vendimmarrjen politike. Ministri Peleshi theksoi mbështetjen e pakursyer të vendit tonë në aspektin politik, diplomatik, ushtarak dhe ekonomik si dhe vijimin e kësaj mbështetjeje brenda mundësive dhe kapaciteteve tona për aq kohë sa të nevojitet.

Gjithashtu, ministri Peleshi garantoj kreun e Komitetit Ushtarak për përbushjen e zotimit për arritjen e buxhetit të Mbrojtjes në

2% deri në vitin 2024, ndonëse kjo shifër, për situatën aktuale të sigurisë, nuk është e mjaftueshme.

Një vëmendje të veçantë gjatë bisedës mori edhe situata e sigurisë në Kosovë, e cila nuk duhet lënë jashtë vëmendjes së Aleancës, aq më tepër në një kohë kur retorika pro ruse në Ballkan shtohet dita-ditës.

Në përfundim të takimit, të dy bashkëbiseduesit ranë dakord për të zbatuar vendimet e marra nga kryetarët e shteteve dhe qeverive të vendeve të NATO-s gjatë Samitit të Madridit, vitin e kaluar, por edhe për çështjet që do të diskutohen në Samitin e ardhshëm në Vilnius, Lituani, më 11 - 12 korrik 2023.

Kryetari vizitoj gjithashtu Regjimentin e Operacioneve Speciale në Zall-Herr, ku vëzhgoj drejtpërdrejt një demonstrim të Forcave të Operacioneve Speciale Shqiptare. “Më bëri përshtypje shfaqja e bërë sot nga bashkimi më elitari i Shqipërisë, ata demonstruan unitetin e qartë të qëllimit, profesionalizmin dhe jetuan në përputhje me reputacionin e tyre ndërkombëtar”, - theksoi në fjalën e tij admiral Bauer. Më tej admiral Bauer iu drejtua anëtarëve të kurseve të nivelit të lartë në Kolegjin e Mbrojtjes dhe Sigurisë të Forcave të Armatosura Shqiptare, ku theksoi rëndësinë e të qenit i përgatitur dhe i gatshëm për t’u përshtatur dhe për të pritur të papriturën. Admiral Bauer tha se: “Trupat shqiptare ndihmojnë për të mbajtur Aleancën tonë të sigurt. Këta ‘bija dhe bijat shqiptarë’ e ndihmojnë Aleancën të ngrihet lart. Ata janë të gatshëm t’i vënë të gjitha në linjë për të mbështetur rendin e bazuar në rregulla ndërkombëtare, për të promovuar demokracinë dhe për të krijuar siguri dhe stabilitet për vendin e tyre. Shqipëria është një aleate e vlerësuar. Në këtë epokë të re të mbrojtjes kolektive, ne jemi më të fortë së bashku.”

Gjeneral Kingji priti në takim komandanten e Gardës Kombëtare të New Jersey-it, gjeneral brigade Lisa Hou

Gjeneral brigade Lisa J. Hou, pasi vlerësoi maksimalisht bashkëpunimin ushtarak dypalësh, si një ndër partneritetet më të suksesshme që ka Garda Kombëtare e New Jersey-it, siguroi rritjen e mbështetjes së mëtejshme në fushat në të cilat Forcat e Armatosura kanë nevojë.

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneral brigade Arben Kingji priti në një takim të veçantë komandanten e Gardës Kombëtare të New Jersey-it, gjeneral brigade Lisa J. Hou. Gjeneral Kingji, pas urimit të mirëseardhjes për gjeneral Hou, shprehu konsideratat më të larta për mbështetjen dhe kontributin që japin SHBA-të nëpërmjet programeve të partneritetit dhe bashkëpunimit, në ndihmë të përmirësimit të kapaciteteve të Forcave të Armatosura. Takimi ndërmjet gjeneral brigade Kingjit dhe gjeneral brigade Lisa Hou u fokusua në marrëdhëniet dypalëshe të bashkëpunimit ushtarak.

Gjeneral Hou u njoh mbi ecurinë e procesit të zhvillimit dhe modernizimit të mëtejshëm të FARSH-së në pajisje, teknikë, infrastrukturë, arsimimin ushtarak, mbrojtjen kibernetike, si dhe bashkëpunimin në fushën e stërvitjes dhe trajnimit të përbashkët.

Fokusi i takimit bilateral ishte thellimi

i bashkëpunimit në interes të trajnimit të mëtejshëm të personelit, kryesisht në përdorimin e teknikës së re të armatimit, mbrojtjes kundër armëve të dëmtimit në masë, në fushën e zbulimit, si dhe në përmirësimin e të gjithë procesit të mirëmbajtjes logjistike në Forcat e Armatosura.

Gjeneral brigade Lisa J. Hou, pasi vlerësoi maksimalisht bashkëpunimin ushtarak dypalësh, si një ndër partneritetet më të suksesshme që ka Garda Kombëtare e New Jersey-it, siguroi rritjen e mbështetjes së mëtejshme në fushat në të cilat Forcat e Armatosura kanë nevojë.

Vizita e gjeneral brigade Hou përkon me aktivitetin “Women in Military” nga ekipi amerikan i Gardës Kombëtare të New Jersey-it, 05 - 10 mars 2023, si dhe me pjesëmarrjen e pesë ekipeve të ndryshme të trajnimit nga Garda Kombëtare në fushat e arsimimit, shëndetësisë, mbrojtjes kundër-kimike, zbulimit dhe mbrojtjes kibernetike





SHSHPFA, gjeneral brigade Arben Kingji, në kuadër të përgatitjeve për stërvitjet “Defender Europe-23”, “Strong Balkan-23”, vizitoi ambientet e Komandës së Forcës Tokësore dhe Regjimentit të Operacioneve Speciale. Si dhe u njoh me ecurinë e procesit të punimeve mbi përmirësimin e infrastrukturës stërvitore dhe akomoduese. Gjeneral brigade Arben Kingji u ofroi strukturave përgjegjëse gjithë mbështetjen e tij për realizimin me sukses të këtyre stërvitjeve me vlerë të madhe për ushtrinë shqiptare.



Gjeneral brigade Arben Kingji priti në takim atasheun ushtarak të BE-së, kolonel Pietro Mostardi



Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH-së, gjeneral brigade Arben Kingji, priti në takim atasheun ushtarak të Bashkimit Evropian, kolonel Pietro Mostardi (jo-rezident në Shqipëri). Gjeneral brigade Kingji u shpreh se ky takim është një mundësi e mirë për të diskutuar nga afër çështje në interes të përbashkët në fushën e Mbrojtjes dhe Sigurisë. Kontributi i Shqipërisë në misionet dhe operacionet në kuadër të NATO-s janë një shembull mjaft i mirë për të shërbyer më tej bashkëpunimit në të ardhmen për pjesëmarrjen e FARSH-së në operacione dhe misione të drejtuara nga BE. Ndër të tjera, gjeneral brigade Kingji riafirmoi qëndrimin e qartë të Shqipërisë në çështjen e Kosovës, si pjesë e intere-

sit tonë kombëtar, në mbështetje të të gjitha aspiratave të saj në anëtarësimin në organizmat ndërkombëtare dhe jo vetëm. Shqipëria do të vazhdojë të luajë një rol të rëndësishëm në rajonin e Ballkanit, duke promovuar paqe, siguri dhe prosperitet. Atasheu ushtarak i BE-së, kolonel Mostardi e vlerësoi rolin e Shqipërisë, duke e cilësuar atë partner të besueshëm. Do të punojmë së bashku për të gjetur mundësi të reja bashkëpunimi në projekte dhe pjesëmarrje në misione. Historiku i bashkëpunimit ushtarak me BE-në e ka zanafillën që në vitin 2005, me pjesëmarrjen në misionin MINURCAT, në Çad, në misionin EUTM, në Mali, operacionin detar EUNAVFOR në Somali, misionin EUFOR-ALTHEA në Bosnje-Hercegovinë.



KLO, vizita në Qendrën Kombëtare Operacionale të Emergjencave Civile, Komandën e FT dhe ROS

Në vijim të realizimit të programit mësimor kursantët e Kursit të Lartë të Oficerit, pranë Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë, zhvilluan një vizitë njohëse në Qendrën Kombëtare Operacionale të Emergjencave Civile, Tiranë.

Stafi akademik dhe grupi mësimor u pritën nga drejtori i përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, z. Haki Cako, i cili pasi i uroi mirëseardhjen i njohu ata më anë të një brifingu me: misionin, detyrat, pjesëmarrjen në operacione brenda dhe jashtë vendit si dhe rolin që kjo qendër realizon në varësi të vendit dhe llojit të emergjencës.

Më tej vizita vijoi me një sesion pyetje-përgjigje, ku kursantët adresuan pyetje, duke u ndalur tek angazhimet e fundit dhe detyrat në të ardhmen. Shefi i departamentit të operacioneve, kolonel Isuf Hamati dhe kursantët shprehën mirënjohjen për informacionin e ofruar si dhe kontributin që kjo qendër jep në përballimin e detyrave në operacionet e E-C brenda dhe jashtë vendit.

Vizita nga afër e kësaj qendre konsolidoi akoma më shumë njohuritë e kursantëve për rolin dhe përgjegjësitë aktuale të saj. Një tjetër vizitë njohëse në kuadër realizimit të programit mësimor, kursantët e Kursit të Lartë të Oficerit zhvilluan pranë Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë në Komandën e Forcës Tokësore dhe Regjimentin e Operacioneve Speciale, Zall-Herr. Stafi akademik dhe grupi mësimor u pritën

nga gjeneral brigade Ferdinand Dimo, zëvendëskomandanti i FT, i cili pasi i uroi mirëseardhjen stafit dhe grupit mësimor të Kursit të Lartë ia dha fjalën kolonel Beqir Tafilit, i cili i njohu ata me misionin, detyrat, pjesëmarrjen në operacione brenda dhe jashtë vendit si dhe projektet e modernizimit që do ndikojnë në përbushjen e detyrave.

Më tej, vizita vijoi me një sesion pyetje-përgjigje, ku kursantët adresuan pyetje duke u ndalur tek angazhimet e fundit dhe detyrat në të ardhmen. Me shumë interes u prit nga kursantët diskutimet për planet e modernizimit të FT dhe ndryshimet e propozuara për strukturën e aktivizimi të komponentit rezervist. Vizita vijoi në Regjimentin e Operacioneve Speciale (ROS), ku u njohën me misionin detyrat, kontributin në operacione dhe planet për të ardhmen për zhvillimin dhe modernizimin e këtij regjimenti.



Hapet Kursi i Lartë i Sigurisë dhe Mbrojtjes (KLSM-13)



Në sallën e auditoriumit “Gjeneral Enrico Tellini”, në Garnizonin “Skënderbej”, Kolegji i Mbrojtjes dhe Sigurisë organizoi ceremoninë e hapjes së Kursit të Lartë të Sigurisë dhe Mbrojtjes (KLSM-13), me pjesëmarrjen e zëvendësshit të Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Manushaqe Shehu, gjeneralëve, atashëve ushtarake të akredituar në Shqipëri, drejtorëve dhe ushtarakëve të tjerë të lartë të Shtabit të Përgjithshëm, etj.

Zëvendëskomandanti i Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë, kolonel Emëror Hajdarasi, në fjalën e tij të hapjes, uroi pjesëmarrësit në kurs nga FARSH, Institucionet e Sigurisë në vend, vendet e rajonit dhe ato aleate për fillimin e kursit dhe falënderoi

vendet për dërgimin e përfaqësuesve pjesëmarrës në Kursin e Lartë të Sigurisë dhe Mbrojtjes, pranë Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë. Në fjalën e rastit, kolonel Hajdarasi tha: “Si një prioritet pozitiv e bashkëpunimit, kursi është krijuar për t’u ofruar studentëve tanë njohuritë, të kuptuarit dhe mjetet e nevojshme që ata të bëhen komandantë, politikëbërës dhe menaxherë krijues dhe proaktivë. Gjatë këtij kursi ka shumë çështje për të diskutuar, vlerësuar dhe nxjerrë mësim, për shkak të një ndryshimi total të mjedisit të sigurisë të shkaktuar një vit më parë, që kur Rusia nisi pushtimin

e saj ndaj Ukrainës, konflikti më i madh në Evropë që nga Lufta e Dytë Botërore. Arritjet e këtij kursi nuk mund të kuptohen pa kontributin e lektorëve nga Kolegji i Mbrojtjes i NATO-s, Kolegji Baltik, Qendra “Marshall”, Kolegji i Luftës së Ushtrisë Amerikane dhe Instituti për Studime Globale në Romë, Forcat e Armatosura Shqiptare dhe Institucionet Shqiptare të Sigurisë.

Duke përfutur nga ky rast, dëshiroj t’i falënderoj të gjithë për mbështetjen e tyre për konsolidimin dhe përparimin e këtij kursi. Ne jemi mjaft optimistë në përmbushjen e objektivave të

kursit, pasi kemi mbështetje të plotë nga institucionet shqiptare, veçanërisht nga Ministria e Mbrojtjes, Shtabi i Përgjithshëm i FA-së si dhe partnerët tanë ndërkombëtarë. Falënderime të veçanta shkojnë për pjesëmarrësit e huaj në këtë kurs, të cilët vijnë nga: Bullgaria, Gjeorgjia, Greqia, Italia, Kosova dhe Maqedonia e Veriut”.

Më pas përshëndeti zëvendëshefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Manushaqe Shehu, e cila në fjalën e saj u shpreh: “Ndihem e nderuar të jem sot në ceremoninë e hapjes së kursit të 13-të të Lartë të Sigurisë dhe Mbrojtjes, dua të falënderoj lidhshpimin ushtarak të shteteve që iu përgjigjën në formë pozitive ftesës për dërgimin e përfaqësuesve në këtë kurs,



duke i sjellë më afër ushtarakët me shoqërinë civile, kjo është më e rëndësishme në mjedisin e sigurisë që po jetojmë. Kam besimin tek lektorët dhe stafi akademik, të cilët do ta bëjnë këtë kurs të larmishëm dhe mjaft praktik. Shoqëria jonë ka nevojë për lidhshpimin tuaj. Në Kursin e Lartë të Sigurisë dhe Mbrojtjes marrin pjesë 15 ushtarakë të lartë nga Forcat e Armatosura të Shqipërisë, Bullgarisë, Gjeorgjisë, Greqisë, Italisë, Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut si dhe përfaqësues nga institucione në vartësi të Ministrisë së Brendshme, të Parlamentit dhe Presidencës.



Kolonel Arben Toska: Ndihe mi krenarë për produktin e punës suaj, ambicien drejt standardeve të avancuara, të denjë për të shërbyer në radhët e Forcave të Armatosura

“ Në mjediset e Qendrës së Arsimimit Profesional të Ushtarëve, Vlorë, u zhvillua ceremonia e Certifikimit dhe Betimit të rekrutëve, të cilët përfunduan kursin e Stërvitjes Individuale Bazë (SIB). Në përfundim të këtij kursi në Bunavi, b1k, b3k të FT-së dhe batalionit të Mbështetjes së SHP, u certifikuan 63 rekrutë, të rinj e të reja nga mbarë vendi, të cilët tashmë janë pjesë e Forcave tona të Armatosura.



Në ceremoni mori pjesë zëvendëskomandanti i Akademisë së Forcave të Armatosura, kolonel Arben Toska, i cili shprehu vlerësime për rekrutët e sapo certifikuar dhe konsiderata të veçanta për ceremoninë e zhvilluar, gjithashtu falënderoi familjarët, të afërmit e rekrutëve pjesëmarrës në ceremoni, dhe personelin trajnues, ku ndër të tjera theksoi: “Ndihe mi krenarë për produktin e punës suaj, për këtë forcë ushtarake që keni stërvitur, për përpjekjet tuaja të vazhdueshme në drejtim të konsolidimit të sistemit të stërvitjes së ushrit të Forcave të Armatosura, për ambicien tuaj për të zbatuar standarde të avancuara në procesin stërvitor, për gjithçka që ju keni bërë për edukimin e këtyre të rinjve, tashmë të denjë për të shërbyer në radhët e Forcave të Armatosura”.

Gjatë fjalës së rastit në këtë ceremoni, komandanti i QAPU-ve, nënkolonel Bujar Fejzo, ndër të tjera falënderoi rekrutët

e sapo certifikuar, për përkushtimin dhe seriozitetin e treguar gjatë stërvitjes në Bunavi. Ai shprehu besimin se dijet dhe aftësitë e fituara do t’iu shërbejnë për të rritur më tej profesionalizmin gjatë kryerjes së detyrave në repartet e Forcave të Armatosura, ku do të shërbejnë. “Dita e sotme është e veçantë për Ju, - vijoi përshëndet-

jen nënkolonel Fejzo, - pasi do të betoheni si ushtarakë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Ju do të betoheni para flamurit tonë kombëtar, për t’i qëndruar besnikë atdheut, detyrës dhe ligjit”. Mes urimeve më të mira, rekrutët u përcollën nga Bunavia për në repartet e Forcave të Armatosura.

Ekipi i Akademisë Ushtarake “West Point”, vizitë në AFA

Në kuadër të masave për transformimin e Akademisë së Forcave të Armatosura (AFA), sipas modelit të Akademisë Amerikane “West Point” dhe programit të partneritetit me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, një ekip nga Akademia Ushtarake e Akademisë “West Point”, SHBA, zhvilloi një vizitë pune në Akademinë e Forcave të Armatosura.

Qëllimi i vizitës ishte vijimi i punës për përgatitjen e programeve mësimore dhe kurrikulave për programet e studimit “Marrëdhënie Ndërkombëtare në Fushën e Mbrojtjes” dhe “Shkenca Komunikimi në Fushën e Mbrojtjes”, që janë të planifikuara për t’u hapur gjatë vitit akademik 2023-2024. Në përfundim të vizitës u rishikuan dhe u përgatitën kurrikulat mësimore për programet “Marrëdhënie Ndërkombëtare në Fushën e Mbrojtjes” dhe “Shkenca Komunikimi Fushën e Mbrojtjes”. Të dyja programet u kompletuan me Sullabus-et respektive. Një vëmendje të veçantë mori përgatitja e programit të karakterit. Krijimi i karakterit për programet e studimit për vitin akademik 2023-2024 do të jetë një nga katër shtyllat kryesore që do të shërbejnë për përgatitjen e drejtuesve të ardhshëm të gatshëm të shërbejnë me nder, të udhëheqin me nder dhe të demonstrojnë performancë të shkëlqyer. Puna dhe bashkëpunimi me akademinë “West Point” do të vijojë edhe në ditët në vijim deri në përgatitjen e plotë të programeve dhe akreditimin e tyre.



Atashetë ushtarakë të vendeve të NATO-s, të akredituar në Republikën e Shqipërisë, vizitojnë AFA-në



Në kuadër të planit vjetor të Atasheve Ushtarakë, të akredituar në Republikën e Shqipërisë, AU të vendeve të NATO-s vizituan AFA-në. Ata u pritën nga komandanti AFA-së, gjeneral brigade Bilbil Bitri, i cili i njohti ata me zhvillimet e fundit të AFA-së. Në veçanti u theksua procesi i transformimit të AFA-së sipas modelit të Akademisë Amerikane “West Point”, një prioritet që ka vëmendjen edhe të Qeverisë Shqiptare, Ministrit të Mbrojtjes, Shefit të Shtabit të Përgjithshëm dhe që mbështetet edhe nga aleati strategjik SHBA. Gjeneral Bitri i falënderoi atashetë për mbështetjen që vendet e tyre kanë dhënë në drejtim të arsimimit të oficerëve, ku aktualisht janë rreth 51 studentë që studiojnë në SHBA, Turqi, Itali, Gjermani, Greqi, Kosovë. Atashetë Ushtarakë vlerësuan arritjet e AFA-së dhe gatishmërinë për vijimin e bashkëpunimit ushtarak bilateral.





AFA zhvillon “FACULTY FOUNDATION DEVELOPMENT PROGRAM”

U zhvillua programi trajnues “FACULTY FOUNDATION DEVELOPMENT PROGRAM”, në FMS nga Shoqëria për Partneritet për Paqe për Akademitë Ushtarake dhe Institucionet e Studimeve të Sigurisë. Objektivi i këtij trajnimi ishte që në përfundim të tij pjesëmarrësit të njiheshin, përvetësonin dhe aplikonin sa më shumë nga metodat të cilat shërbejnë për planifikimin e leksioneve dhe kurrikulave, duke pasur parasysh ruajtjen e raportit të nivelit ndërmjet pritshmërive, strategjisë së implementimit dhe vlerësimit të leksioneve, kurrikulave apo programeve. Trajnimi u zhvillua në mënyrë interaktive, ku vlen të theksohet se jo vetëm u mësuan dhe praktikuan metodat e mësimdhënies, hartimit të leksioneve e programeve dhe vlerësimit të tyre, por u zhvilluan diskutime të frytshme nga shkëmbimi i eksperiencave të gjithsecilit prej pjesëmarrësve, duke mësuar shumë nga njëri-tjetri.

Objektivi i trajnimit u përmbush dhe pjesëmarrësit u pajisën me një paketë njohurish teoriko-praktike, të cilat janë të aplikueshme dhe të vlefshme për sferën e ushtrimit të profesionit të mësimdhënies po ashtu edhe të zhvillimit të planeve, programeve apo kurrikulave. Në përfundim të trajnimit për të gjithë pjesëmarrësit në këtë fazë të trajnimit si dhe në fazën e parë të tij, të zhvilluar gjatë vitit 2022, u shpërndanë certifikatat përkatëse.



AFA, fituese e 4 kupave në 5-garëshin mes FT dhe KM



Në Regjimentin ROS, batalioni Special/Komando, midis forcave u zhvillua 5-garëshi Ushtarak, në të cilin ekipi i AFA-së i dominoi të gjitha garat. Dita e parë ishte në disiplinën e qitjes, ku ekipi i AFA-së zuri vendin e parë, duke lënë mbrapa FT; Dita e dytë Brez-Kalitje, ku ekipi i AFA-së zuri vendin e parë si dhe vendin e dytë si individ në Brez-Kalitje, major Bledar Mesi me rezultat 3.23; Dita e tretë Granad, ku ekipi i AFA-së zuri vendin e parë; Dita e katërt vrapim 8 km, ku ekipi i AFA-së zuri vendin e parë si dhe në vend të parë si individ major Bledar Mesi me rezultatin 27min 56 sek si dhe vendin e dytë studenti Përparim Gashi me rezultatin 29min 06 sek. Në përfundim AFA u shpall Kampion.

Ekipet pjesëmarrëse në 5-garëshin Ushtarak:
AFA
FT
KM



Studentët zhvilluan stërvitjen me dalje në “fushim dimëror”, në rajonin e Zall-Bastarit

Studentët e vitit të tretë, që ndjekin ciklin e parë të studimeve Bachelor në shkencë ushtarake, zhvilluan stërvitjen me dalje në “fushim dimëror”, në rajonin e Zall-Bastarit. Në këtë stërvitje morën pjesë 52 studentë, 3 komandues, 4 pedagogë, si dhe 7 personel mbështetës. Qëllimi i stërvitjes ishte testimi i njohurive të marra nga studentët, testimi dhe zhvillimi i mëtejshëm i aftësive drejtuese të tyre, në kushte ekstreme të motit. Studentët zhvilluan marshimin me mjete në rrugëkalimin nga dislokimi i përhershëm në drejtim të rajonit të stërvitjes. Vijuan angazhimin për ngritjen e fushimit dhe krijimin e kushteve për fjetje, ushqim dhe shërbim shëndetësor. Realizuan përnjohjen e rajonit të stërvitjes, zhvilluan topografi ushtarake, realizuan operacionet e kërkim-kontaktit, zbritje nga lartësitë (alpinizëm) dhe goditje objekti. Studentët vijuan marshimin taktik në drejtim të Fekenit dhe kthim, ku u organizuan për të zhvilluar alpinizmin. Stërvitja vijoi me kalimin e pengesave ujore, alpinizëm, kryerje të luftimit në qendrat e banuara, pika kontrolli, si dhe operacione kërkim-kontakti.





Zhvillohet ceremonia e betimit të studentëve të AFA-së

Në Akademinë e Forcave të Armatosura u zhvillua ceremonia e betimit të studentëve dhe kadetëve të rinj. Të pranishëm në këtë ceremoni ishin ministri i Mbrojtjes z. Niko Peleshi, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneral brigade Arben Kingji, komandanti i Akademisë së Forcave të Armatosura, gjeneral brigade Bilbil Bitri, komandantë forcash, drejtorë, si dhe familjarë e të afërm të studentëve.

Në fjalën e tij përshëndetëse, dekani i Fakultetit të Mbrojtjes dhe Sigurisë, kolonel Ilirjan Dauti, falënderoi të pranishmit, si dhe familjarët e studentëve për mbështetjen që u kanë dhënë në zgjedhjen e një profesioni kaq të bukur, por plot sfida dhe sakrifica. “Ju sot vini me një status të vlerë, nga një qytetar i zakonshëm në një ushtarak të devotshëm.

Të aftë fizikisht dhe psikologjikisht për të përballuar sfidat që do ju dalin përpara. Të vetëdijshëm se të qenit ushtarak nuk e bën dot çdokush, por ai që ka vullnetin, moralin dhe motivacionin për t’i shërbyer popullit dhe atdheut. Jemi të bindur se rrugën e nisur do ta përfundoni me sukses të plotë. Atdheu nga sot do të këtë dhe 80 luftëtarë të tjerë, të gatshëm për t’u sakrifikuar për të”, - do të mbyllte fjalën e tij kolonel Dauti. Ministri i Mbrojtjes, z. Niko Peleshi, në fjalën e tij u shpreh se ishte një kënaqësi krejt e veçantë të ishte i pranishëm në këtë ceremoni, si dhe foli për transparencën dhe meritokracinë gjatë procesit të përzgjedhjes mes shumë kandidatëve të tjerë.

“Para tre muajsh, falë rezultateve dhe meritave tuaja, u përzgjedhët për t’iu

bashkuar Forcave tona të Armatosura. Nderi, Detyra, Atdheu janë pasaporta juaj morale me të cilën do të përfaqësoni denjësisht kombin shqiptar ku do t’ju thërrasë detyra”, - u shpreh z. Peleshi, i cili nuk la pa përmendur sfidat me të cilat studentët dhe kadetët e rinj do të përballen.

“Në të ardhmen, një pjesë e mirë e juaja do të kenë mundësinë për të shërbyer në angazhimet dhe operacionet jashtë vendit, për të cilat jam i bindur që, ashtu si dhe paraardhësit tuaj, do të lini gjurmët tuaja të lavdisë”.

Në fund të fjalës së tij, ministri Peleshi përmendi edhe një herë punën dhe përkushtimin e kuadrove dhe gjithë efektivit jo vetëm për stërvitjen, por edhe për përmirësimin e kushteve të punës, stërvitjes, jetesës dhe i siguroi se mbështetja e tij personale apo e Ministrisë së Mbrojtjes do të jetë e vijueshme, jo vetëm për këtë strukturë, por për të gjithë Forcat e Armatosura. “Politikat mbështetëse të Qeverisë dhe Ministrisë së Mbrojtjes për motivimin mbështetjen, përkujdesjen, modernizimin, dhe arsimimin cilësor me pikësynim arritjen e standardit të akademisë “West Point”, do jenë fokus kryesor për vazhdimësinë”. Në fund të ceremonisë studentë dhe kadetë bënë betimin e tyre nën flamurin shqiptar.



BASHKËPUNIME

Ekspertë nga Brukseli, trajnim për emergjencat në Tiranë

Një grup ekspertësh të DG-Echos nga Brukseli ndodhen në Tiranë, për të marrë pjesë në një workshop dyditor, të organizuar nga AKMC dhe në bashkëpunim me strukturat operacionale, ministritë e linjës, dy prefekturat, Agjencinë Shtetërore të Informacionit dhe Gjeohapësirës, Institutin e Gjeoshkencës, Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore, si dhe agjenci të tjera, që kanë rolin e tyre në Mbrojtjen Civile. Ky bashkëpunim vjen pak kohë pas anëtarësimit të Shqipërisë në Mekanizmin Evropian të Mbrojtjes Civile. Në fjalën e tij, në nisje të këtij workshop-i, drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, Haki Çako, duke i uruar mirëseardhjen ekspertëve të Mekanizmit të Mbrojtjes Civile, vuri në dukje faktin se prej tre vitesh punë intensive në gjenezë të Sistemit të Mbrojtjes Civile, qeveria shqiptare i është nënshtruar një reforme të thellë në sistemin e menaxhimit të fatkeqësive, duke e zhvendosur vëmendjen nga një menaxhim pasiv i situatave,



në një menaxhim proaktiv, të orientuar në parandalim dhe gatishmëri, si dhe qëndrueshmërinë e Sistemit të Mbrojtjes Civile, si një mekanizëm gjithëpërfshirës dhe funksional. Drejtori i Përgjithshëm i AKMC-së, përmendi hapat kryesorë, duke filluar nga miratimi i ligjit për Mbrojtjen Civile, krijimin e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, hartimin e 16

akteve nënligjore në funksion të Ligjit 45, tre dokumentet strategjike si dhe Planin Kombëtar të Emergjencave, që pritet të miratohet brenda këtij viti. Drejtori i Përgjithshëm i AKMC-së, përmendi edhe misionin e parë të Shqipërisë nën koordinimin e Mekanizmit Evropian të Mbrojtjes Civile, në mbështetje të situatës së tmerrshme të krijuar nga tërmeti në Turqi.





AKMC certifikon Skuadrën e Vullnetarëve të Reagimit të Shpejtë

Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (AKMC) certifikoi Skuadrën e Vullnetarëve të Reagimit të Shpejtë, të cilët u trajnuan në teori dhe praktikë për disa muaj me radhë, përmes një donacioni të "LëvizAlbania". Të rinjtë e kësaj skuadre u pajisën me certifikatat përkatëse nga AKMC dhe konsiderohen pjesë e rrjetit të vullnetarëve në rastet e fatkeqësive natyrore.

Në ceremoninë e zhvilluar me rastin e certifikimit të tyre, drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, z. Haki Çako, e vuri theksin tek kjo iniciativë, duke e cilësuar atë si një vizion dhe vullnet, që i shërben Mbrojtjes Civile, por edhe krijimit të një kulture të përhershme për krijimin, trajnimin dhe ngritjen e rrjeteve të vullnetarëve në Shqipëri. Zoti Çako tha se në principet e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, por edhe një reforme të jashtëzakonshme që është ndërmarrë deri tani, por edhe më shumë në të ardhmen, vullnetarizmi është një pjesë e rëndësishme, ndërsa i cilësoi të rinjtë e Skuadrës së Reagimit të Shpejtë, si partnerë: "Besoj në misionin, besimin dhe përgjegjësitë tuaja.

Ju do të jeni promotorë për të ndryshuar situatat. Keni një mision të rëndësishëm dhe në trajnimin disamujor me ekspertët e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile keni marrë bazat, sepse, për ne fokusi është Mbrojtja Civile", - tha Çako, ndërsa u bëri të ditur të rinjve të këtij rrjeti vullne-



tarësh, se për herë të parë u miratua nga qeveria shqiptare, Strategjia e Riskut nga Fatkeqësitë Natyrore, një dokument që ka munguar deri më tani.

Duke folur për vullnetarizmin, zoti Çako u ndal tek ky proces, të cilin e quajti një investim të së ardhmes dhe vlerë të shtuar për Mbrojtjen Civile, referuar praktikave më të mira evropiane. Shqipëria është anëtarësuar tashmë në Mekanizmin e

Mbrojtjes Civile Evropiane dhe po punohet me të gjithë kuadrin ligjor për të qenë dhe vepruar njësoj si agjencitë e tjera të Mbrojtjes Civile, ku një element mjaft i rëndësishëm është vullnetarizmi. Zoti Çako foli edhe për aspektin ligjor, një nga sfidat e tjera që ka shërbimi vullnetar dhe për të cilin janë duke punuar grupe pune, për të finalizuar deri në detaje këtë strukturë.



Përfundon Kursi Bazë i Oficerit në Qendrën Stërvitore të Forcës Ajrore, në specialitetin "Forcë Ajrore"

Në mjediset e Qendrës Stërvitore Kuçovë, u zhvillua ceremonia e përfundimit të Kursit Bazë të Oficerit (KBO) në specialitetin "Forcë Ajrore", i cili zgjati tre muaj.

Në këtë ceremoni morën pjesë komandanti i Bazës Ajrore Kuçovë, kolonel Adrian Kuli, komandanti i Qendrës Stërvitore, major Ervin Demo si dhe përfaqësues nga Komanda e Forcës Ajrore.



Në fjalën e tij, kolonel Adrian Kuli, në emër dhe të komandantit të Forcës Ajrore, falënderoi instruktorët, kursantët dhe pjesëmarrësit për mbarëvajtjen e kursit dhe për rezultatet e arritura. Më pas ai theksoi rëndësinë e kualifikimeve të trupës së oficerëve për ecjen e tyre në karrierë dhe përballimin e sfidave në

kuadër të zhvillimeve të pritshme në Forcën Ajrore.

Ceremonia përfundoi me shpërndarjen e certifikatave për oficerët të cilët përfunduan KBO.



Anijet e Grupit II të Gatshëm të Anijeve Minaheqëse të NATO-s vizitojnë Portin e Durrësit

Anijet e Grupit të Dytë të Gatshëm të Anijeve Minaheqëse të NATO-s (Standing NATO Mine Countermeasures Group Two - SNMCMG2), të përbërë nga anija flamurtare e FD turke TCG "Yüzbaşı Günör", TCG "Enez" (FD turke), dhe ITS "Numana" (FD italiane) zhvilluan një vizitë në portin e Durrësit.

Në ditën e parë të vizitës së tyre, përfaqësues të Shtabit të SNMCMG2 zhvilluan një vizitë zyrtare në Komandën e Forcës Detare, në të cilën u pritën nga shefi i Shtabit të Forcës Detare, kapiten i rangut I Arsen Mullaj. Pas vizitës në Forcën Detare, delegacioni i SNMCMG2 zhvilluan vizita kortezie në bashkinë dhe prefekturën Durrës. Gjithashtu, komandanti i Forcës Detare, kundëradmiral Adnand Agastra zhvilloi një vizitë kortezie në bordin e anijes flamurtare. Gjatë këtij takimi admiral Agastra uroi erëra të mbara dhe suksese gjatë zhvillimit të stërvitjes së përbashkët me anijet e Forcës Detare. Gjatë stërvitjes u përpunuan elementë të ndryshëm stërvitorë sipas manualeve standarde të NATO-s, kalim tranzit në kanale të ngushta, transferim i postës, formacione të ndryshme lundrimi. Gjithashtu u zhvillua stërvitja e përbashkët PASSEX.

Në përfundim të stërvitjes u zhvillua edhe një operacion për kërkimin e minave ose pajisjeve shpërthyes në fund të detit në rajonin e Porto - Romanos, Durrës.



Anija "Lissus" e Forcës Detare nisët me mision në detin Mesdhe, si pjesë e operacioneve të NATO-s

Anija "Lissus" dhe një ekip efektivash të Forcës Detare do të jetë pjesë e operacioneve të përqendruara (FOCOPS) të NATO-s, në detin Mesdhe.

Në ceremoninë e përcjelljes së ekuipazhit, zëvendës shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Manushaqe Shehu u shpreh se: "Me këtë mision Forca Detare rikthehet të kontribuojë si faktor i rritjes së sigurisë detare, pas një angazhimi të suksesshëm trevjeçar nga viti 2016 - 2019, në aktivitetin e NATO-s "Sea Guardian", në detin Egje, ku bëri të mundur dhënien e ndihmës mbi 1 800 personave, në rrezik për jetën. Ky është një tregues i qartë për rolin e Shqipërisë si një faktor stabiliteti dhe sigurie në rajon dhe më gjerë.

Ndryshe nga misioni i kryer në vitin 2016 - 2019 në detin Egje, që kishte karakter humanitar, kjo është hera e parë që Forca jonë Detare angazhohet në një operacion të mirëfillt të rritjes së sigurisë detare", - u shpreh gjeneralmajor Manushaqe Shehu.

Më tej në fjalën e saj, zëvendës shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, u shpreh e bindur se efektivët e anijes do të tregojnë profesionalizëm, përkushtim dhe korrektësi gjatë kryerjes së detyrave. Në ceremoninë e përcjelljes së trupave morën pjesë edhe komandantët të forcave të ndryshme.



Stërvitje e përbashkët mes Forcës Detare shqiptare dhe Forcës Detare spanjolle

Në ishullin e Sazanit u zhvillua një stërvitje e përbashkët midis Forcës Detare shqiptare dhe Forcës Detare spanjolle. Në stërvitje morën pjesë anijet spanjolle L-61 "Juan Carlos I", një anije shumë-rolesh zbarkuese, dy avionë F-18 nga aeroplanmbajtësja amerikane "G. W. Bush" dhe fregata spanjolle F-103 "Blas de Lezo".

Nga Forca Detare morën pjesë anijet e Grupit të Parë Patrullues P-132 Oriku, P-134 Butrinti si dhe efektivët e Grupit të Bordingut.

Gjatë stërvitjes "MisEx 830" u zhvilluan manovra të thjeshta taktike, formacione të ndryshme si zhvillim të embargos detare, ku mjetet detare u mbështetën nga mjete ajrore.

Gjithashtu u krye operacion zbarkimi i përbashkët detar dhe ajror me helikopter dhe gomone në ishullin e Sazanit, sipas skenarit stërvitor për shpëtim dhe evakuim të efektivëve të rrëzuar në zonë armiqësore.

U zhvilluan stërvitje SurfEx për mbrojtjen e komandës së Task Forcës nga sulme dhe mjete të ndryshme në zonë armiqësore. Qëllimi i kësaj stërvitjeje ishte integrimi i kapaciteteve detare dhe ajrore për evakuim të personelit në zonë të rrezikuar nga sulme ajrore, sipërfaqësore dhe nënujore në bashkëpunim midis dy Forcave Detare.



Zhvillohet Stërvitja II e Përbashkët mes Forcës Detare shqiptare dhe asaj spanjolle

Në vetëm një muaj pas përfundimit të Stërvitjes së Parë të Përbashkët mes Forcës Detare shqiptare dhe spanjolle, në detin Adriatik u zhvillua stërvitja e dytë e përbashkët, ku morën pjesë anijet spanjolle L - 61 "Juan Carlos I", anije shumë-rolesh si zbarkuese dhe aeroplanmbajtësja, fregata F - 82 "Victoria". Nga Forca Detare mori pjesë anija P - 134 "Butrinti" si dhe efektivët e Grupit të Bordingut. Stërvitja u zhvillua në kushte të përkeqësuar të motit, me qëllim përgatitjen e efektivëve për reagim në situata të vështira.

Anija e Rojës Bregdetare italiane "ITCG PB Alfredo Peluso", vizitë në portin e Durrësit

Në kuadër të bashkëpunimit dypalësh ndërmjet Forcës Detare shqiptare dhe Forcave Detare të Italisë, anija e Rojës Bregdetare italiane "ITCG PB Alfredo Peluso" vizitoi Portin e Durrësit.

Gjatë qëndrimit në vendin tonë, komandanti i anijes italiane kapitenlejtënant Antonio Barbieri i shoqëruar nga atasheu ushtarak italian, kolonel Nicola Piccolo, zhvilluan një vizitë në Komandën e Forcës Detare, ku u pritën nga komandanti i FD-së, kundëradmiral Adnand Agastra.

Kundëradmiral Agastra u uroi mirëseardhjen dhe i falënderoi për bashkëpunimin e deritanishëm dhe veçanërisht për ndihmën e dhënë nga pala italiane ndër vite.

Ekui-pazhi i anijes italiane me efektivat e Grupit II Patrullues të Forcës Detare zhvilluan stërvitje të ndryshme që lidhen me veprimet e efektivit në luftën kundër zjarrit, ujit apo avarive të ndryshme në anije. Këto stërvitje ndikuan pozitivisht në trajnimin e efektiveve si dhe ndërveprimin ndërmjet forcave, duke përmirësuar pritshmëritë në realizimin e detyrave dhe objektivave në zbatimin e ligshmërisë dhe sigurisë lundrimore.

Po kështu anija italiane u vizitua nga nxënësit e Shkollës së Mesme të Navigacionit të qytetit Durrës, të cilët bënë një vizitë në anije dhe u njohën nga afër me detyrat që kryejnë efektivat e Rojës Bregdetare në Itali.



Operacion SAR nga efektivi i anijes P-116 "Bora"

Roja Bregdetare është njoftuar nga QNOD për situatën e vështirë në të cilën ndodhej anija e peshkimit tip "flug" me emrin "Makaj 0624", me 3 persona në bord, e cila ka pësuar avari në sistemin elektrik të motorit dhe nuk mund të lundronte.

Mjeti lundruar i ndodhur në rrezik ka kërkuar ndihmë. Menjëherë pas marrjes së informacionit, Roja Bregdetare organizoi operacionin, duke i dhënë ndihmë të menjëhershme personave në bord.

Mjeti u identifikua në distancën 22 milje në veri të ishullit të Sazanit, nga anija P-116 e Forcës Detare, e cila i dha ndihmë menjëherë mjetit të rimorkiuar në drejtim të Triportit në Vlorë.



Operacion SAR nga efektivi i anijes P - 04 "Semani"

Ekui-pazhi i anijes P - 04 "Semani", pasi mori njoftimin se një flugë peshkimi kishte pësuar avari, shkoi për t'i ardhur në ndihmë. Fluga e peshkimit "Makaj" me tre persona në bord, në distancë rreth 4,7 milje në jugperëndim të Kepit të Rodonit, po shtyhej nga era për në det të hapur.

Po këtij mjeti i është dhënë ndihmë, më datë 12 janar 2023, në zonën e derdhjes së Vjosës nga Anija P-116, e cila e ka rimorkiuar dhe dërguar në Triport.

Efektivi i anijes P - 04, i Forcës Detare, i ka ardhur në ndihmë në kohën e duhur dhe realizoi rimorkimin për në Portin e Durrësit.





Zhvillohet ceremonia e fillimit të stërvitjes vjetore nga Forca Detare, për vitin 2023

Në Bazën Detare Pashaliman është zhvilluar ceremonia e fillimit të stërvitjes vjetore të Forcës Detare për vitin 2023.

Pjesëmarrës në këtë ceremoni ishte komandanti i Forcës Detare, kundëradmiral Adnand Agastra, i cili gjatë fjalës përshëndetëse vlerësoi punën e palodhur të deritanishme dhe i uroi suksese efektive pjesëmarrës në vijim të këtij cikli stërvitor.

Stërvitja do të zhvillohet nga të gjithë repartet dhe nënrepartet në nivel anije, grup anije si dhe Grup i Bordingut të Forcës Detare.

Kjo stërvitje është ndër aktivitetet kryesore të Forcës Detare, e cila është garant në suksesin e zhvillimeve të stërvitjeve para dislokuese, për pjesëmarrjen e Forcës Detare në Operacionet e NATO-s, FOCOPS dhe në operacionin në Detin Egje.

Prej shumë vitesh Forca Detare stërvitet sipas standardeve të NATO-s, në të cilat përfshihen aktivitetet stërvitore brenda dhe jashtë vendit dhe vizitat që realizohen në vendin tonë me stërvitjet e përbashkëta, si qëllim rritjen e ndërveprueshmërisë, e cila ka ndikim të drejtpërdrejtë në rritjen e sigurisë Detare.



Ekuipazhi i Forcës Detare i vjen në ndihmë anijes tregtare të përfshirë nga flakët e zjarrit

Siguria Portuale Durrës ka njoftuar se një anije tregtare që ndodhej në radën e Durrësit kishte prezencë tymi (zjarri). Menjëherë u njoftua Komanda e Forcës Detare dhe QBO, pas njoftimit të menjëhershëm, anijes P - 04 "Semani", iu dha kushtrim për dalje në rajon, monitorim, raportim dhe asistencë, si dhe anijes

P-133 "Lissus" për dalje në det, asistencë dhe dhënie ndihme për fikjen e zjarrit në anijen tregtare. Anija në avari është tregtarja me emër "Kledes Mary" me flamur të Panamasë, e cila ka pësuar zjarr në një lokal poshtë urës së komandimit.

Forca Detare ka të angazhuar në operacion dy anije P-133 "Lissus" dhe P-04 "Semani". Gjithashtu ndodheshin mjete nga PKM, Siguria Portuale Kapitaneria. Situata e zjarrit u vendos nën kontroll, duke ardhur në ndihmë në kohën e duhur.



Presidenti Begaj: Në shërbim të jetës, atdheut, sovranit



Shqipëria europiane është Shqipëria e Gjergj Kastriotit dhe e Nënë Terezës, e Ismail Qemalit dhe e Fan Nolit; është Shqipëria e rinisë antifashiste dhe e studentëve të dhjetorit; është Shqipëria e qytetarëve që kanë dhunti e zotësi për të konkurruar e fituar në një shoqëri të bazuar mbi meritën.



Presidenti i Shqipërisë apo Institucioni kushtetues i Presidentit të Republikës sipas Kushtetutës së Shqipërisë është kryetari i shtetit. Kryetar i Republikës së Shqipërisë është Presidenti Bajram Begaj. Sipas nenit 86 të Kushtetutës, Presidenti i Republikës është kryetar shteti dhe përfaqëson unitetin e popullit.

Përfundimi i luftës së Dytë Botërore dhe çlirimi i Shqipërisë, në vitin 1944, u shoqërua me zgjedhjet e para parlamentare, të dhjetorit të vitit 1945, dhe me kalimin e funksionit të Kryetarit të Shtetit në organ kolegjal, si Presidium i Kuvendit Popullor. Në periudhën 11 janar 1946 – 12 dhjetor 1990, funksionet e Kryetarit të Shtetit u kryen nga Omer Nishani (10 janar 1946 - 1 gusht 1953), Haxhi Lleshi (1 gusht 1953 - 22 nëntor 1982) dhe Ramiz Alia (22 nëntor 1982 - 22 shkurt 1991).

Më 22 shkurt 1991, u krijua Këshilli Presidencial i drejtuar nga Ramiz Alia, i cili i ushtroi funksionet deri më 30 prill 1991.

Më 30 prill 1991, me zgjedhjen e Presidentit të parë të Republikës parlamentare nga ana e një parlamenti shumë-partiak, prej më shume se 30 vjetësh, krijohet Institucioni kushtetues i Presidentit të Republikës.

Sot, në krye të këtij institucioni qëndron për herë të tretë një ish-ushtarak karriere, idealet e të cilit qartazi duken të jenë 'mbi palët'.

Ish-gjeneralmajor Bajram Begaj, në një prej deklaratave të tij do të shprehë: "Puna ime si mjek dhe si ushtarak më ka mësuar shumë, por mbi të gjitha më ka mësuar vlerën e respektit për tjetrin dhe të dashurisë për Atdheun, respekti për tjetrin dhe dashuria për Atdheun do të jenë shigjetat e busullës sime në atë detyrë të lartë. Vetëm përkushtimi me besnikëri absolute ndaj Republikës, qytetarëve dhe Kushtetutës së saj, mund ta tregojnë sadopak madhësinë e këtij nderi."

Sh.t. z. Bajram Begaj, i betuar para 'ligjit të Sokratit' si mjek, para flamurit kuq e zi si ushtarak i devotshëm dhe para Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë si i përlururi i sovranit të tij, me formim intelektual dhe atdhetar,



“Nuk toleroj askënd që vendos interesat politike mbi kombën”

të duhurin për përfaqësim dinjitoz të Shqipërisë në diplomacitë botërore.

Një pikë referimi për brezat e rinj është udhëtimi i tij drejt shkallës më të lartë të hierarkisë.

Sh.t. z. Bajram Begaj ka lindur më datë 20 mars 1967, në Rrogozhinë. Në vitin 1989, ka përfunduar studimet pranë Universitetit të Tiranës, Fakulteti i Mjekësisë, dega Mjekësi e Përgjithshme dhe është titulluar oficer aktiv në specialitetin “Mjekësi” në vitin 1998.

Më 1 gusht 2020, mori drejtimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Përpara se të merre detyrën e shefit të Shtabit të Përgjithshëm, gjeneralmajor prof. asoc. Bajram Begaj, për një periudhë trevjeçare, ka shërbyer në detyrën e komandantit të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes.

Gjatë karrierës së tij ushtarake, gjeneralmajor Bajram Begaj ka shërbyer në pozicione të ndryshme drejtuese në Forcat e Armatosura, si: zëvendës drejtor i Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”; drejtor i Përgjithshëm i Spitalit Ushtarak Qendror Universitar; drejtor i Inspektoratit Shëndetësor, kryeinspektor dhe këshilltar i Inspektoratit Shëndetësor në Shtabin e Përgjithshëm të FA-së; shef i Njësisë Mjekësore Ushtarake dhe zëvendës drejtor i Spitalit Universitar të Traumës, si dhe detyra të tjera në strukturat e Forcave të Armatosura.

Gjeneralmajor Begaj ka ndjekur kualifikime dhe specializime të ndryshme në fushën ushtarake dhe atë mjekësore, në institucionet arsimore brenda dhe jashtë vendit. Ai ka përfunduar Kursin e Lartë për Sigurinë dhe Mbrojtjen pranë Akademisë së Forcave të Armatosura, Shkollën e Thelluar Pasuniversitare të Mjekësisë dhe specializimin pasuniversitar në profilin Gastrohepatologji, pranë Fakultetit të Mjekësisë, Tiranë.

Gjithashtu ka ndjekur kursin e menaxhimit spitalor dhe kursin e liderimit mjekësor strategjik, në SHBA, Kursin e Lartë Ndërkombëtar të Menaxhimit të Mbrojtjes, pranë Institutit të Menaxhimit të Burimeve të Mbrojtjes në Shkollën Pasuniversitare të Marinës në SHBA, Seminarin e Lartë Ekzekutiv pranë Qendrës “Marshall”, Gjermani, si dhe kurse e kualifikime të tjera ushtarake. Gjeneralmajor Bajram Begaj, ka përfunduar “Doktoratën në Fushën e Mjekësisë”, pranë Fakultetit të Mjekësisë si dhe mban titullin “Profesor i Asociuar” në Mjekësi. Njëkohësisht është vlerësuar me medalje të ndryshme për arritje gjatë karrierës së tij ushtarake.

Presidenti Begaj ka ndjekur kualifikime dhe specializime të ndryshme në fushën ushtarake dhe atë mjekësore, në institucionet arsimore brenda dhe jashtë vendit. Bajram Begaj është profesor i asociuar i mjekësisë. Ai është martuar me znj. Armanda Begaj dhe së bashku kanë dy fëmijë.



Roli i snajperëve, si një nga armët me vdekjeprurëse në fushën e luftimit, mbetet i pazëvendësueshëm. Personeli i batalionit të Dytë të Këmbësorisë (b2k), nën drejtimin e instruktorëve amerikanë të SFAB, zhvilluan këto ditë të ftohta dimri, një trajnim të avancuar dhe qitje me këtë lloj arme, në kushtet e temperaturave të ulëta, me qëllim rritjen e mëtejshme profesionale.



Batalioni i Tretë i Këmbësorisë, përfundoi stërvitjen dimërore “Tomori-23”, duke testuar me sukses aftësitë profesionale të efektivëve të tij në terrenin e vështirë malor dhe me dëborë, të malit të Tomorit.

Kursi “Komando”, konsiderohet si një nga kurset më të vështira, që zhvillohet në Regjimentin e Operacioneve Speciale (ROS). Për mbi 72 orë, kandidatët për beretën blu iu nënshtruan stërvitjes komplekse në rajonin e Fekenit, ku testuan aftësitë dhe rezistencën e tyre psiko-fizike.



30 trupa nga batalioni i tretë i këmbësisë (b3k), u nisën me mision në Pejë, Kosovë, si pjesë e misionit të NATO-s, KFOR.

Në ceremoninë e organizuar me këtë rast, në ambientet e b3k merrnin pjesë: kryetarja e bashkisë Dimal, znj. Juliana Mema, zëvendëskomandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Ferdinand Dimo, miq dhe familjarë të efektivave të kontingjentit paqeruajtës etj.

Fjala e hapjes u mbajt nga komandanti i b3k, kolonel Gëzim Marku, i cili ndër të tjera theksin e vuri tek eksperiencia e krijuar nga efektivët e b3k ndër vite, për sa i takon pjesëmarrjes në operacione paqeruajtëse. Është kjo eksperiencë, por edhe trajnimi i vijueshëm që kryhet në këtë repart ato që sipas kolonel Markut, e mbushin me besim se ky mision do të jetë i suksesshëm, ashtu si edhe misionet paraardhëse.

Të pranishmit i përshëndeti në emër të kontingjentit komandanti i këtyre efektivëve, major Mariglen Tomani, i cili, pasi falënderoi eprorët për besimin e treguar, i siguroi ata se misionin që iu është ngarkuar, do ta kryejnë me devotshmëri dhe profesionalizëm. Duke marrë fjalën në ceremoni, zëvendëskomandanti i Forcës Tokësore, gjeneral Dimo ndër të tjera tha: "...Sot është një ditë e veçantë dhe kuptimplotë. Ceremonia e sotme, i bashkohet dhjetëra ceremonive të organizuara me raste të tilla nga Forca Tokësore, jo vetëm për të përcjellë, por edhe të për të nderuar dhe respektuar djemtë dhe vajzat e saj më të mirë nën uniformë. Misioni, ku ju shkoni sot është një mision në shërbim të paqes dhe sigurisë. Ju do jeni ambasadorët tanë më të mirë në rajon. Mbajeni lart flamurin tonë kombëtar dhe emrin shqiptar, duke treguar çdo ditë nivelin tuaj profesional në bashkëveprim me aleatët. Qëndroni përkrah njëri-tjetrit, në çdo situatë dhe në çdo nevojë...".

Në mbyllje të fjalës së tij, gjeneral Dimo i siguroi familjarët e paqeruajtësve të kontingjentit I shtesë me mision në Kosovë, se Forca Tokësore, por edhe Shtabi i Përgjithshëm dhe Ministria e Mbrojtjes do të jenë gjithmonë në kontakt me ta



Forca Tokësore nis kontingjentin e I shtesë në kuadër të misionit KFOR



dhe pranë tyre, për çdo problem apo nevojë që do të kenë. Kontingjenti I shtesë, përbëhet nga një togë e efektivëve të batalionit të Tretë të Këmbësisë dhe do t'i bashkohet trupave të kontingjentit

të Forcës Tokësore që ndodhen aktualisht në Pejë, Kosovë, në kuadër të misionit KFOR. Me nisjen e këtij kontingjenti, Forca Tokësore shton kontributet e saj në interes të paqes dhe sigurisë rajonale.





ZHVILLOHET CEREMONIA E PËRFUNDIMIT TË KURSIT XVIII “KOMANDO”

Në ambientet e Regjimenteve të Operacioneve Speciale (ROS), u zhvillua ceremonia e përfundimit të kursit XVIII “Komando”, ku ndër të tjerë merrnin pjesë: zëvendëskomandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Ferdinand Dimo, komandanti i Forcës Ajrore, gjeneral brigade Ylli Pulaj, komandanti i Forcës Detare, kundëradmiral Adnand Agastra, komandanti i Akademisë së Forcave të Armatosura, gjeneral brigade Bilbil Bitri, drejtori i Shtabit të Përgjithshëm, kolonel Arben Zani, atasheu ushtarak i Republikës së Kosovës në vendin tonë, major Enver Hoti, komandantë të reparteve vartës të FT etj. Aktiviteti u hap nga komandanti i ROS, nënkolonel Ajet Jata, i cili theksoi se: “Përgjatë 14 javëve stërvitje, me fokus në taktikat “komando”, përgatitje zjarri, drejtim trupash, alpinizëm, topografi, përgatitje fizike etj., me plot bindjen ju themi se aftësitë e çdo kursanti tashmë janë të ndryshme nga aftësitë e çdo ushtaraku tjetër”.

Një falënderim dhe përgëzim të veçantë, komandanti i ROS adresoi edhe për kursantët nga Republika e Kosovës, të cilët treguan përgatitje dhe formim të lartë ushtarak gjatë gjithë kursit.

Ceremoninë e përshëndeti edhe zëvendëskomandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Ferdinand Dimo, i cili pasi përgëzoi kursantët për këtë arritje në karrierën e tyre, ndër të tjera tha: “...përfundimi i çdo lloj kursi, është për ne ushtarakët një tullë më tepër në murin e karrierës tonë, por përfundimi i një kursi të tillë, siç është kursi “komando”, të cilët ju arritët ta përfundoni me sukses, është një krenari e shtuar për vetë faktin se jo të gjithë janë të aftë të marrin iniciativë të tilla të guximshme, për t’iu nënshtruar ngarkesës së madhe psikologjike dhe fizike, që parashikon programi stërvitor i këtij kursi. Duhet të ndiheni krenarë, që pas kaq sakrificash të mëdha ju treguat se mund t’ia dilni. Vendosmëria, disiplina dhe shpirti i sakrificës që ju treguat, duhet të jetë shembull edhe për ushtarakët e tjerë, jo vetëm të Forcës Tokësore, por të të



gjithë Forcave të Armatosura. Forca Tokësore është krenare gjithashtu që ka në mesin e saj njerëz të kalibrit tuaj të përgatitur dhe të gatshëm për t’u përballur me çdo sfidë....”

Të pranishmit në ceremoni, patën rastin të shikojnë nga afër nëpërmjet stacioneve stërvitore, disa demonstrime nga taktikat “komando”.

Ceremonia u mbyll me betimin “komando” dhe me vendosjen e beretës blu.





Batalioni i Tretë i Këmbëtorisë, mirëpret kursantët e Kursit Themelor të Oficerit të Shtabit (KTHOSH). Gjatë prezantimit të punës së tyre, risollën në vëmendje rëndësinë e këtij batalioni dhe ushtrimin me profesionalizëm të detyrave të caktuara.



“Junior Command and Leadership Course” po zhvillohet në Forcën Tokësore, nën drejtimin e instruktorëve britanikë, të British Military Advisory Training Team (BMAT), synon rritjen e aftësive profesionale, në fokus ato të lidhshpimit ushtarak të rolit bazë oficer dhe nënoficer.



Kursantët e Kursit Bazë të Oficerit në Qendrën Stërvitore, gjatë zhvillimit të temës "Kontroll turmash", treguan përkushtim dhe interes të lartë në përvetësimin e programit trajnues.



Vetëm pak ditë pas dislokimit të tyre në “Camp Villaggio Italia”, në Pejë, Kosovë, trupat e kontingjentit I shtesë në misionin KFOR, i nënshtrohen trajnimit “Fire Phobia”, me synim rritjen e aftësive operacionale.



“Dhuro gjak, shpëto jetë!”

Forca Tokësore qëndron gjithmonë në krah të njerëzve në nevojë

Me moton “Dhuro gjak, shpëto jetë!”, batalioni i Mbështetjes së Luftimit çeli fushatën e dhurimit të gjakut në Forcën Tokësore, në bashkëpunim me Qendrën Kombëtare të transfuzionit të gjakut. Forca Tokësore qëndron gjithmonë në krah të njerëzve në nevojë.



Zëvendëskomandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Ferdinant Dimo, priti në takim ekipin e radhës të Brigadës së Asistencës së Forcave të Sigurisë së SHBA-së (SFAB), me rastin e përfundimit të periudhës së shërbimit të tyre pranë Forcës Tokësore.

Në vlerësim të punës së ushtarakëve amerikanë, për trajnimin e efektivëve të FT-së, gjeneral brigade Dimo, akordoi për personelin e SFAB Certifikatat e Mirënjohjes.



Vrapimi 27 kilometër me ngarkesë, ishte sfida më e fundit e kursantëve të kursit të XVIII-të “Komando”.



Përfundon në Forcën Tokësore “Junior Command and Leadership Course”

Në ambientet e sallës së konferencave të Forcës Tokësore, u zhvillua ceremonia e përfundimit të Kursit “Junior Command and Leadership Course”.

Pjesëmarrës në ceremoni ishin zëvendës ambasadorja e Britanisë së Madhe në vendin tonë, znj. Camilla Marzouk, zëvendëskomandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Ferdinant Dimo, atasheu ushtarak britanik në vendin tonë, nënkolonel Timothy Right-Boycott, komandanti i grupit britanik të trajnimit “British Military Advisory Training Team” (BMATT), kolonel Paul Morris etj.

Ceremonia u hap nga instruktorët britanikë të BMATT, me një prezantim përmbledhës mbi aktivitetin e zhvilluar gjatë periudhës njëmuajore, të këtij kursi.

Më pas, aktivitetin e përshëndeti zëvendës ambasadorja e Britanisë së Madhe në vendin tonë znj. Camilla Marzouk, e cila përgëzoi të gjithë pjesëmarrësit në kurs, për përfundimin e tij me sukses, duke uruar që trajnimi i përfunduar do të vlejë jo vetëm për karrierën e tyre ushtarake, por edhe më tej në jetën e tyre shoqërore, për t'i bërë ata qytetarë edhe më të denjë të shoqërisë ku jetojnë.

Kolonel Paul Morris, komandanti i BMATT, duke marrë fjalën shprehu urimet e tij më të mira për të gjithë kursantët, duke vlerësuar përgatitjen e tyre profesionale, qëndrueshmërinë dhe disiplinën e treguar gjatë periudhës së zhvillimit të trajnimit.

“Ky është vetëm fillimi i karrierës tuaj, ndaj do të kërkoja nga ju, që njohuritë e marra këtu t’i shpërndani edhe në repartet ku ju shërbeni. Mos harroni të bëni gjënë e duhur, në momentin më të vështirë ...”, - u shpreh kolonel Paul Morris.

Të pranishmit u përshëndetën edhe nga zëvendëskomandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Ferdinant Dimo.

Në fjalën e tij, drejtuar të pranishmëve ai shprehu mirënjohjen dhe falënderimet e tij për palën britanike për zhvillimin e kursit “Junior Command and Leadership Course”, duke e vlerësuar këtë, si një tregues i bashkëpunimit shumë të mirë, që ekziston mes dy ushtrive tona mike dhe aleate në NATO.

Më tej, duke iu drejtuar kursantëve të sapo certifikuar, gjeneral brigade Dimo, duke i falënderuar për përkushtimin e treguar, kërkoi nga ata që tempin e lartë të përgatitjes profesionale të treguar gjatë kursit, të vijojnë ta mbajnë edhe në të ardhmen. “Ju sot përfunduat një kurs të rëndësishëm për karrierën tuaj. Natyrisht që ky nuk duhet të jetë fundi, por vetëm fillimi i rritjes tuaj profesionale. Le të jetë ky kurs




një gur i sigurt themeli në karrierën tuaj. Në repartet ku do të shërbeni, vijoni të shfaqni më të mirën tuaj, duke i vënë në praktikë dijet dhe njohuritë e fituara gjatë kursit me instruktorët britanikë...”, - tha ndër të tjera gjeneral brigade Dimo.

Më herët gjeneral brigade Dimo priti në një takim kortezie zëvendës ambasadorën e Britanisë së Madhe në vendin tonë, znj. Camilla Marzouk.

Ceremonia vijoi me ndarjen e certifikatave dhe u mbyll me një foto të përbashkët.

Kursi “Junior Command and Leadership Course” u zhvillua për një periudhë gati njëmuajore në Forcën Tokësore me pjesëmarrjen e ushtarakëve të rolit bazë oficer dhe nënoficer. Ky kurs u zhvillua nën drejtimin e instruktorëve britanikë të “British Military Advisory Training Team” (BMATT) dhe synon rritjen e aftësive profesionale, me fokus ato të lidërshpit ushtarak të rolit bazë oficer dhe nënoficer.

Nga 31 pjesëmarrës në fillim të kursit, vetëm 24 prej tyre arritën të certifikohen.



ISH-PRESIDENTI ALFRED MOISIU

Një karrierë në ushtri,
dhe gjithë jetën për ushtrinë...

Intervistoi:
ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Alfred Spiro Moisiu, lindi më 1 dhjetor 1929, në qytetin e Shkodrës. Ka kryer studimet e shkollës së mesme në Tiranë, me ndërprerje për shkak të luftës, në vitet 1941-1945. Ka marrë pjesë në Lëvizjen Antifashiste Nacional-Çlirimtare që në vitin 1942, fillimisht në grupet edukative të rinisë antifashiste, më vonë në radhët e Ushtrisë Nacional-Çlirimtare, me armë në dorë. Gjatë viteve 1943-1944, pjesërisht ka qenë në ilegalitet, pasi familja e tij detyrohet të fshihej si pasojë e përndjekjes nga pushtuesit fashistë, meqenëse babai i tij, Spiro Moisiu, ka qenë eksponent i Lëvizjes Antifashiste, prej vitit 1943, i zgjedhur si Komandant i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Partizane.

Pas çlirimit, në dhjetor 1945, në moshën 16-vjeçare dërgohet për studime në BRSS, në Shkollën e Inxhinierisë Ushtarake në Moskë dhe Petersburg. Pas përfundimit të shkollës gradohet oficer dhe punon fillimisht si komandant toge e më vonë si pedagog në Shkollën e Bashkuar të Oficerëve në Tiranë. Në vitin 1951, transferohet si instruktor në Drejtorinë e Xhenios të Ministrisë së Mbrojtjes, më pas, në shtator 1952, dërgohet për studime në Akademinë e Inxhinierisë Ushtarake në Moskë. Studimet në këtë akademi i përfundon me medalje të artë në vitin 1958. Pas kthimit në atdhe, në vitin 1958, riemërohet në të njëjtën detyrë në Drejtorinë e Xhenios. Në vitin 1964 emërohet shef i Degës Operative po në atë drejtori. Në vitin 1966 emërohet komandant i Brigadës së Urave të Rënda në Kavajë, ku shërben deri në vitin 1971, kohë në të cilën emërohet Drejtor i Drejtorisë së Xhenios dhe më vonë i Fortifikimit në MM. Në këtë detyrë qëndron deri në maj 1981, kur emërohet zëvendës Ministër i Mbrojtjes. Gjatë kësaj kohe kryen edhe studimet në Kursin e Lartë të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Shqiptare.

Në tetor të viti 1982, për arsye politike shkarkohet nga detyra e zëvendësministrit dhe emërohet shef i Xhenios të Brigadës së Këmbësorisë në Burrel, ku qëndron deri në dhjetor 1984, kohë që nxirret në pension.

Pas kësaj, kthehet në Tiranë si pensionist deri në dhjetor 1991, kur emërohet Ministër i Mbrojtjes në Qeverinë Teknikë, deri në prill të vitit 1992. Më pas qëndron në Ministrinë e Mbrojtjes, fillimisht me detyrën e këshilltarit pranë ministrit,

më vonë si zëvendësministër i Mbrojtjes për Politikën e Mbrojtjes. Në këtë detyrë qëndron deri në gusht 1997, kohë që nxirret rishtas në pension. Në qershor 1994, themeloi Shoqatën Shqiptare të Atlantikut dhe kryen detyrën e Presidentit të kësaj strukture civile deri në vitin 2002, kur zgjidhet President i Republikës e deri në vitin 2007, kur del në pension për herë të tretë. Gjatë kohës që punoi në Ministrinë e Mbrojtjes, në qershor 1995, ndjek studimet në Kursin për Personalitete të Larta të Kolegjit Ushtarak të NATO-s, në Romë. Në dhjetor 1999 ndjek Seminarin Ndërkombëtar pranë Akademisë Ushtarake Franceze. Në vitin 2008 themelon Fondacionin “Moisiu”, ndërsa në dhjetor 2010, bashkë me ish-Presidentin Meidani, themelon “Forum Civil 2010”. Gjatë këtyre viteve ky forum ka organizuar një sërë tryezash për probleme të rëndësishme të politikës dhe të ndërtimit të demokracisë në Shqipëri.

Gjatë kohës që ka qenë në kryetë SHSHA-së, ka organizuar dhe drejtuar shtatë Konferenca Ndërkombëtare mbi



“Kur njeriu ka një formim politiko-ushtarak të shumanshëm e të plotë, një përvojë të gjatë drejtuese e pune me njerëzit, njeh shtetin, rëndësinë e zbatimit të përpiktë të ligjeve dhe të kushtetutës dhe e do vendin e tij, realizon me sukses dhe me nder çdo detyrë, sado e lartë dhe e vështirë qoftë.”

çështjet e paqes dhe sigurisë në rajon si dhe tre Konferenca mbi çështjet e kontrollit të armatimit. Është autor i mjaft shkrimeve, artikujve dhe studimeve të botuara në shtypin shqiptar e të huaj, për problemet e artit ushtarak, të politikës së mbrojtjes, të sigurisë rajonale si dhe për zhvillimet në Kosovë. Ka shkruar një sërë studimesh dhe artikujsh mbi problemet ushtarake, mbi çështjet e mbrojtjes dhe të sigurisë në Rajon. Në vitin 2004 boton librin “KOSOVA mes Luftës dhe paqes”; në vitin 2008 boton librin KUJTIME - vëllimi 1-rë, “Në gjurmë të Kujtimeve”; në vitin 2009 boton librin KUJTIME - vëllimi 3-të, “Midis Nanos dhe Berishës”. Në vitin 2012 boton vëllimin e 2-të “Në gjurmë të Kujtimeve”. Ka botuar 5 vëllime: Fjalime, Mesazhe dhe Intervista gjatë viteve 2002-2005. Në vazhdimësi ka botuar dhe vazhdon të botojë shkrime dhe intervista të ndryshme në shtypin shqiptar dhe atë huaj për zhvillimet politike në Shqipëri dhe marrëdhëniet ndërkombëtare.

Mban titullin Doktor i Shkencave Ushtarake, akorduar në vitin 1979.

Gjatë aktivitetit të tij është shpallur: Qytetar Nderi i Bajram Currit, Qytetar Nderi i Barit (Itali), Qytetar Nderi i Vlorës, Qytetar Nderi i Komunës Martaneshit, Qytetar Nderi i Komunës së Lipjanit (Kosovë - 28 nëntor 2010), Qytetar Nderi i Komunës së Shëngjinit (Korrik 2012), Qytetar Nderi i Bashkisë së Kavajës (nëntor 2012), Qytetar Nderi i Bashkisë së Gjirokastrës (maj 2014), Qytetar Nderi i Bashkisë së Beratit (14 nëntor 2014), Qytetar Nderi i Bashkisë së Çorovodës (20 nëntor 2014), Qytetar Nderi i Bashkisë së Durrësit (dhjetor 2014), Certifikatë Mirënjohjeje “Milan Šufflay” nga Ambasada Shqiptare në Zagreb (26 nëntor 2014), Qytetar Nderi i Preshevës (maj 2015).

Titulli “Doctor Honoris Causa” nga Universiteti “Marin Barleti” (dhjetor 2015); Titulli “Mirënjohje e Mallakastrës” nga Shoqata Atdhetare Kulturore Mallakastra (shkurt 2016).

Është dekoruar me: Urdhrin e Shën Mikelit dhe të Shën Gjergjit (akorduar nga Madhëria e saj, Mbretëresha Elisabeta II - 2003); Medaljen e Artë e Lidhjes së Prizrenit (akorduar nga Presidenti i Kosovës Ibrahim Rugova -2004), Urdhrin e Mbretit Tomisllav (akorduar nga Presidenti i Kroacisë Mesiç - 2007), Urdhrin e Meritës i Kryqit të Madh (akorduar nga Presidenti i Polonisë Kaçinskij - 2006), Urdhrin e Mbretit “Vyrtutas së Madh” (akorduar nga Presidenti i Lituanisë Adamkus-2007), Medaljen e Veteran-

it të Luftës së Dytë Botërore (akorduar nga Presidenti Jelcin-2000), Medaljen e Veteranit të Luftës së Dytë Botërore (akorduar nga Presidenti Putin - 2005), Medaljen e Veteranit të Luftës së Dytë Botërore (akorduar nga Presidenti Medvedjev -2010), Medaljen “Për Shërbime Ushtarake”, Urdhrin e Yllit të Kuq, Urdhrin e “Skënderbeut” Klasi II dhe i III, Urdhrin Për Shërbime Ushtarake, Medaljen e Çlirimit, Medaljen e 10-vjetorit të Ushtrisë, Medalja e Mirënjohjes nga Ministria e Mbrojtjes (14 tetor 2014).

Për shtypin ushtarak, ish-presidenti i Republikës së Shqipërisë, ushtaraku i karrierës, Doktor i Shkencave Ushtarake, z. Alfred Moisiu, vjen mes fjalës së tij për të treguar emocionet e më shumë se 40 viteve karrierë nën uniformën e gjelbër, përkushtimin dhe dashurinë për këtë profesion të nderuar.

I ardhur nga një familje, e cila i ka dhënë shumë luftës për liri dhe pavarësi, me kontribute të jashtëzakonshme në fushën ushtarake, ka ndikuar padysim në personalitetin tuaj, ndjenjat patriotike, vlerat qytetare dhe intelektuale. A ishte kjo shtesa që ju ndoqet rrugën e atit tuaj, gjeneralmajor i Ushtrisë Nacional Çlirimtare, Spiro Moisiu?

Ju falënderoj për mundësinë që po më jepni, nëpërmjet organit tuaj për të komunikuar direkt me ushtarakët shqiptarë. Kam kënaqësi, pasi është hera e parë, që pas shumë kohësh më jepet ky rast, duke më plotësuar një dëshirë të hershme, për të shfaqur disa mendime direkt me ata njerëz që sakrifikojnë shumë për të kontribuar në forcimin e mbrojtjes së atdheut.

I theksoj sakrificat e tyre, pasi profesioni i ushtarakut është një ndër më të vështirët. Të kërkohej që në kohë paqe të mendosh dhe të stërvitesh sikur paqja do marrë fund nesër, gjë që kërkon në vazhdimësi jo vetëm mentalitet luftarak, por edhe stërmundim fizik e mendor.

Para se t'i përgjigjem pyetjeve tuaja, meqenëse ju kërkoni disa mendime për të kaluarën time, po i lejoj vetes të flas për shkrimet e mia në lidhje me të kaluarën time si dhe aktivitetin në radhët e Forcave të Armatosura Shqiptare. Për moshën që kam, kam përjetuar dhe mbaj mend shumë ngjarje të ndodhura në disa nga periudhat e rëndësishme të vendit tonë. Kujtoj ngjarje nga koha e Mbretërisë Shqiptare, nga koha e pushtimit fashist, nga ngjarjet e veprimtarisë antifashiste të rinisë shqiptare gjatë pushtimit fashist Italian, për periudhën e Luftës Nacional Çlirimtare, periudhën e

pas çlirimit, nga koha e Diktaturës Komuniste dhe koha e zhvillimeve demokratike e deri më sot, pasi kam qenë dëshmitar okular si dhe pjesëmarrës aktiv i këtyre kohërave. Dëshira që këtë përvojë t'ua lë pasardhësve të mi me uniformë, më vuri para detyrës, për t'u përpjekur ta realizoj këtë gjë sa më mirë. Për këtë qëllim, pas largimit nga detyra e Kryetarit të Shtetit, fillova të shkruaj kujtimet e mia, në tre vëllime. Në vëllimin e parë dhe të dytë kam paraqitur kujtimet e mia të fëmijërisë, të formimit, të kohës së luftës, të çlirimit, të studimit tim në shkollën ushtarake dhe në Akademinë e Inxhinierisë Ushtarake, të punës time 40-vjeçare në radhët e Ushtrisë Shqiptare, të kohës të pensionit, të kohës të zhvillimeve demokratike deri në vitin 2002, kur u zgjodha për në krye të Shtetit Shqiptar.

Ndërsa në vëllimin e tretë kam përshkruar aktivitetin tim gjatë kohës së ushtrimit të detyrës si President i Republikës.

Dua të theksoj se në shkrimet e mia jam përpjekur të jem jo vetëm i sinqertë, por sa më i saktë, në mënyrë që ato të dhëna të bëhen të njohura për publikun e gjerë sa më afër realitetit bashkë edhe me disa përfundime që mund të jenë të vlefshme edhe për kohërat në vijim. Nisur nga fakti që unë, si indirekt ashtu edhe direkt, duke qenë në kontakte me Gjeneral Spiron dhe për shkak të detyrave të rëndësishme që kam ushtruar në Forcat e Armatosura, i kam përshkruar ndodhitë në atë mënyrë, që ato të vlejnjë jo thjesht për të përmbushur kuriozitetet, por edhe për të paraqitur në to, sipas rastit, edhe deduksione që mund të vlejnjë për ushtarakët tanë të së ardhmes. Pra këto dëshmi, të cilat nuk janë thjesht personale, t'i shërbejnë si publikut ushtarak ashtu edhe historianëve të ndryshëm, që janë të interesuar për historinë e Forcave të Armatosura Shqiptare.

Sigurisht që në kujtesën time janë stam-puar që në vegjëli shumë ngjarje dhe zhvillime të Ushtrisë Mbretërore, që ndikuan në lindjen dhe rritjen e dëshirës time që në të ardhmen të isha edhe unë pjesëtar i tyre.

Vetëkuptohet se, që nga mënyra e veprimtimit të major Spiros gjatë ditëve të pushtimit të Shqipërisë, udhëtimi i fëmijëve të oficerëve shqiptarë për në Mal të Zi, në Podgoricë, jo vetëm mua por gjithë atyre vocërrakëve të tjerë na la përshtypje të thellë dhe e ndjemë shumë se çfarë do të thotë pushtimi i vendit, ardhja e një ushtrie të huaj agresive, ngjarje këto që unë nuk mund t'i harroj sot e kësaj dite, megjithëse atëherë isha afro dhjetë

vjeç, ndërsa sot jam drejt nëntëdhjetë e katrës.

Kur isha për studime në gjimnazin e Tiranës, dhe im atë vinte për të më takuar si dhe për të bërë pagesat e ndryshme të konviktit apo të shkollës dhe unë përpiqesha t'i kërkoja ndonjë lek për ndihmë të partizanëve, mënyra sesi ai reagoonte ishte inkurajuese për veprimin tim, megjithëse unë nuk dija gjë, se vetë ai në atë kohë ishte i kredhur deri në fyt me aktivitetin e lëvizjes antifashiste.

Gjatë kohës që isha për studime në Tiranë u përfshiva në grupet edukative të rinisë antifashiste, që ishin ngritur në konvikt. Aty bëheshin mbledhje të fshehta, ku ne diskutonim për problemet e pushtimit, zhvillimet e luftës në tërësi dhe të asaj partizane në veçanti. Gjimnazi i Tiranës në atë kohë ishte kthyer në një qendër të rëndësishme të lëvizjes antifashiste të rinisë shqiptare.

Në rininë time të hershme kam lexuar dy libra interesantë, të shkruara nga shkrimtari Foqion Postoli. I pari, “Lulja e Kujtimit” dhe i dyti “Për Mbrojtjen e Atdheut”. Të dy këto libra përshkruanin ngjarje të Luftës së Dytë Ballkanike dhe të Luftës së Parë Botërore, ku tregohet se si silleshin ushtritë e huaja pushtuese ndaj popullsisë vendase dhe ndaj interesave tona kombëtare. Këto dy libra formuan dhe forcuan në subkoshiencën time, ndjenjën e patriotizmit dhe dëshirën për të kontribuar në mbrojtjen e vendit. Pa folur këtu për ndikimin e ngjarjeve të Luftës së Dytë Botërore, pjesëmarrja që në moshë fare të re në radhët e sipatizantëve të lëvizjes antifashiste si dhe pjesëmarrja direkte më vonë në formacionet partizane.

Pra të gjitha këto zhvillime dhe ngjarje nuk mund të mos linin gjurmë të rëndësishme në formësimin tim rinor dhe të përcaktonin rrugën time në jetën e mëvonshme.

Çfarë ndjesie ju krijoi uniforma ushtarake, kur e veshët për herë të parë?

Unë u rrita në mes të uniformave ushtarake. Pasi jo vetëm babai, por edhe miqtë dhe shokët kryesorë që ai kishte ishin gjithashtu pjesëtarë të ushtrisë. Pra kjo mënyrë jetese e kishte bërë shumë të afërt për mua uniformën ushtarake. Pa folur këtu se gjatë luftës në radhët partizane, megjithëse veshja e luftëtarëve ishte shumë laramane, për faktin se disa visheshin me uniforma italiane, disa me gjermane, disa me rrobat e tyre civile ose fshatare. Ndërsa më vonë, kur filluan të vinin ndihmat e aleatëve, shumica visheshin me uniformë angleze, veçanërisht pjesëtarët e brigadave par-

tizane. Por sido që të ishte, në të gjitha rastet ato ishin uniforma ushtarake. Vetëm pas çlirimit ushtarakët shqiptarë filluan të vishnin uniformën e miratuar për Ushtrinë Shqiptare.

Uniforma ushtarake, e cila në kohën e Mbretërisë ka qenë e mbushur me zbukurime, nuk ishte menduar e tillë rastësisht. Ajo luan rolin e saj të rëndësishëm në krijimin e dëshirës tek rinia për ta veshur atë. Ndaj dhe uniformat e studentëve ushtarakë gjithmonë janë të atilla që të tërheqin vëmendjen. E kam fjalën për uniformat festive, pasi ato të stërvitjes synohet të jenë sa më praktike dhe shumë pak dallojnë njëra nga tjetra.

Është për të ardhur keq që në ushtrinë tonë, që në kohën e diktaturës, uniformat dhe shenjat e gradave tona më shumë kanë qenë kopjim sesa ruajtje e traditës, gjë kjo që nuk ndodh në ushtritë e tjera. Shikoni uniformat austriake, italiane, franceze, hungareze, amerikane e të tjera, nuk ngjajnë fare me njëra-tjetrën, pasi ruajnë traditat dhe specifikat e së kaluarës. Kjo ishte arsyeja kryesore që menjëherë pas çlirimit të vendit, gjeneral Spiro Moisiu, në atë kohë Kryetar i Shtatmadhorisë, menjëherë kërkoi dhe ndryshoi uniformën e ushtrisë shqiptare, duke u bazuar në atë që kishin pasur në kohën e mbretërisë, por jo të fundit, pasi ajo ishte pothuajse e njëjlojtë me atë italianen. Kjo uniformë u ndryshua në vitin 1937, me presionin dhe ndikimin direkt të këshilltarëve italianë pranë Ministrisë së Mbrojtjes. Italia fashiste në atë kohë ishte furnizuesja kryesore e ushtrisë tonë me uniformat e gatshme. Ishte koha, kur çdo gjë në ushtri komandohej dhe drejtohej nga këshilltarët ushtarakë italianë.

Çfarë ndikimi pati uniforma ushtarake?

Uniforma ushtarake ka shumë rëndësi, ajo nuk vlen vetëm për paraqitjen, por ka edhe elementë të tjerë që duhet t'i plotësojmë kur gjykohet dhe vendoset për të. Uniforma duhet të ketë gjithmonë diçka tradicionale, pasi tradicionalizmi ka të bëjë me vazhdimësinë e traditës, gjë që rrit përgjegjësinë e atyre që e mbajnë për besnikërinë dhe gatishmërinë për të sakrifikuar për atdheun. Uniforma duhet të jetë e lehtë në mbajtje, praktike në përdorimin e saj, por edhe e bukur, për të tërhequr rininë në shërbimin ushtarak.

Nisur nga këto parime, uniforma e re

kishte mjaft gjëra të trashëguara nga uniforma e hershme e Ushtrisë Mbretërore Shqiptare, pra ruante traditën. Kjo nuk i pëlqeu këshilltarëve jugosllavë, pasi uniforma e mëparshme ishte identike me të tyre dhe kjo korrespondonte me planet e tyre të aneksimit, sikurse u bë e ditur më vonë. Më vonë, pas ndryshimit të drejtuesit të Shefit të Shtatmadhorisë, uniforma ndryshoi rishtas, por këtë herë ajo i ngjante pothuajse tërësisht asaj sovjetike. Ishte e njëjlojtë me përgjash-



tim të xhakëtës, e cila ishte e çarë nga prapa dhe kishte xhepa me kapak anash dhe sipër, ndërsa ajo sovjetike ishte e mbyllur me xhepa të hapur vetëm sipër. Të tjerat pastaj ishin identike, përfshi edhe gradat, me përjashtim të faktit se ne gradën e kapitenit ne e kishim në dy shkallë, kapiten i parë dhe i dytë, ashtu sikurse edhe ishte më përpara në kohën e mbretërisë. Kam mendimin, se disa nga këto gjëra që përmenda duhen mbajtur parasysh nga drejtuesit aktualë të ushtrisë.

Prej shumë vitesh si drejtues në radhët e uniformave ushtarake, keni kaluar mes dy "kohërave" të ndryshme

historike, regjimit totalitar dhe sistemit demokratik, si gjendet ushtria shqiptare mes këtyre dy kufijve?

Ndërtimi i ushtrisë, struktura e saj, madhësia, armatimi e gjithçka tjetër që ka të bëjë me të, varen dhe përcaktohen nga Strategjia e Mbrojtjes Kombëtare, e cila miratohet nga Kuvendi. Në kohën e diktaturës strategjia e mbrojtjes ishte: Të ndërtohet mbrojtja për të qenë të gatshëm të ndeshemi me Social Imperializmin Sovjetik dhe NATO-n, qoftë edhe së

bashku, dhe të dalim fitimtar. Kjo ishte në vija të përgjithshme, kur e shikon sot vërtet duket shumë qesharake, gati një çmenduri, por kjo ishte kthyer në bindje dhe për këtë punohej, si teorikisht ashtu edhe praktikisht. Ndërsa sot vendi ynë është anëtar i NATO-s dhe veprimet luftarake parashikohen në kuadrin e strukturës së saj.

Nga kjo përcaktohet edhe madhësia e ushtrisë, përhapja strategjike e saj, pajisja dhe gjithçka që ka të bëjë me mbrojtjen e vendit. Pra, në përputhje me këtë organizohet edhe stërvitja e ushtrisë dhe kuadrin e saj.

Në kohën e atëhershme, ushtria bazohej në masivitet, kurse sot i vihet rëndësi cilësisë së reparteve elitë. Atëherë kryerja e shërbimit ushtarak ishte detyrë e çdo qytetari, sot ushtria është rrogëtare.

Në këtë pikë dua të ndalem. Kam përshtypjen se pavarësisht nga strategjia e mbrojtjes, shërbimi i detyrueshëm ushtarak është më i përshatshëm se sa ai me rrogëtarë. Ose më mirë të themi duhen rrogëtarët, për arsye të specifikave të teknikës luftarake moderne, por nuk ka pse të hiqet dorë përfundimisht nga shërbimi i detyrueshëm ushtarak i qytetarëve të Republikës. Kjo do të kishte rëndësi edhe për një edukim

patriotik më të organizuar të rinisë, si dhe do t'i përgjigjej më mirë nevojave në rast mobilizimi.

Lufta e Ukrainës mendoj se e shtron këtë detyrë për të rishikuar sesi është më mirë të ecet më tej. Agresioni Rus nxjerr detyrë që të rishikohet në tërësi Strategjia e Sigurisë Europiane.

Ndryshimet e sistemit ekonomik dhe politik sollën ndryshime edhe në Forcat e Armatosura, por duhet thënë se këto ndryshime nuk u bënë shumë të studiuar. Rrjedhimisht ka shumë gjëra që duhen riparë dhe përshtatur kushteve të reja, duke pasur parasysh përvojën e deritanishme. Ushtria duhet të ketë një institut ose një sektor të veçantë që

të merret me studime për perspektivën, i cili mund të vendoset pranë Akademisë së Mbrojtjes. Në kushtet kur në Ballkan, kohë pas kohe nga koka të nxehta dalin thirrje për zgjidhje ushtarake të problemeve politike, veçanërisht pas ngjarjeve të Ukrainës, duhen menduar mirë si përbërja e ushtrisë, pajisja e saj, stërvitja, dislokimi dhe të tjera probleme logjistike. Kujdes i veçantë i duhet kushtuar mbrojtjes kundërtanke dhe asaj ajrore.

Këto gjëra mendoj se kanë vend të shihen me kujdes dhe të përcaktohen më qartë.

Në vitin 1994, ju themeluat Shoqatën Shqiptare të Atlantikut. Çfarë kishte për qëllim kjo shoqatë dhe çfarë impakti solli për Shqipërinë?

Me ndryshimin e sistemit politik dhe vendosjen e demokracisë, sigurisht që vendit i dilte për detyrë që në kushtet e reja të ripërcaktoheshin si dhe të caktoheshin sesi do të zgjidheshin dhe detyrat e mbrojtjes. Me shkurtime të ushtrisë ishte më se e qartë që edhe ne duhet t'i përshtateshim rrethanave të reja. Situata në rajonin tonë në vazhdimësi, përfshi edhe sot ka qenë shumë delikate. Tendencat e vjetra ballkanase për të uzurpuar tokat e të tjerëve u zgjuan rishtas dhe duhej menduar sesi duhet të mbroheshim. NATO tek ne njihet, por njihet si një armike, si një koncept imperialist e të tjera përcaktime të asaj kohe. Pra duhej punuar për t'u bërë pjesë e kësaj strukture të fuqishme ushtarako-politike. Në këtë kuadër puna duhej filluar me përpunimin dhe sqarimin e opinionit publik, duke iu bërë të qartë shqiptarëve se çfarë është NATO, e cila deri disa kohë më parë shihej si një gogol dhe pse ne duhej të punonim për t'u anëtarësuar në të. Me këto detyra duhet të merrej Ministria e Mbrojtjes, por kjo kërkonte një punë më të gjerë dhe më të thellë, ndaj, duke ndjekur edhe shembullin e vendeve të tjera europiane, u pa e arsyeshme që për këto qëllime edhe në Shqipëri të organizohej një strukturë e posaçme e shoqërisë civile, e cila u quajt Shoqata Shqiptare e Atlantikut.

Kështu, unë bashkë me disa ushtarakë dhe politikanë, mbështetur në përvojën e Bullgarisë, në vitin 1994, morëm nismën për organizimin e kësaj strukture. Që në fillim bëmë kujdes që kjo shoqatë të ishte pluraliste, pasi dihej që për ta arritur këtë objektivi do të duhej kohë, e cila do të kërkonte disa mandate zgjedhore, pra nuk dihej se cila forcë politike do të ishte në pushtet, kur të vinte koha e pranimit si dhe donte konsolidim të mendimit të përbashkët politik shqiptar. Pas organizimit

duhej punuar që kjo të njihej nga ATA, që është struktura qendrore europiane e këtyre shoqatave, gjë të cilën pas shumë përpjekjesh ne e arritëm një vit më vonë, në 1995-n. Vetëm pas kësaj, shoqatën tonë e njohu edhe NATO.

Shoqata bëri një punë të shumanshme dhe mjaft të organizuar për arritjen e qëllimeve që përmenda më sipër. Çdo vit ne organizonim Konferenca vjetore me tematika të posaçme, në të cilat ftonim përfaqësues nga vendet kryesore të Aleancës. Qëllimi ishte jo vetëm shkëmbimi i mendimeve reciproke, por që edhe ata të krijonin përshtypjen e qartë se çfarë përfaqësonte Shqipëria që po kërkonte të bëhej pjesë e asaj aleance të madhe.

Duhet thënë që Shoqata arriti vërtet rezultate të mira në këtë drejtim, si për të sqaruar shqiptarët pse duhet të bëhemi pjesë e aleancës, por edhe vendet anëtare që duhet të jepnin pëlqimin për pranimin e vendit tonë në aleancë të ndërgjegjësuesheshin se ia vlente që edhe Shqipëria të bëhej pjesë e saj.

Si përfundim mund të them se nëse nuk do të ndodhnin ngjarjet e vitit 1997, Shqipëria do ishte bërë pjesë e NATO-s shumë kohë para vitit 2008, dhe për rrjedhim do të ishim bërë anëtarë të BE-së me kohë.

Sa i vështirë është kalimi nga një botë si ajo e ushtrisë me rregulla strikte, në atë të politikës, ku rregullat shpesh shkelen...?

5 vitet tuaja si president u shoqëruan me debate të forta politike, gjithkush nga politikanët dhe analistët në Shqipëri mendon se ju keni qenë presidenti më i fortë në historinë e tranzicionit shqiptar.

Si arritët, i nderuar president, të bënit bashkë "mendjet e nxehta" të politikës shqiptare dhe a mund të na risillni në kujtesë disa prej arritjeve tuaja në ushtrimin e detyrës si kreu i shtetit shqiptar, në ato kohë të vështira që po kalonte Shqipëria?

Po, kjo është një pyetje e gjerë dhe interesante, që mua më është bërë që herët dhe po përpiqem t'u jap përgjigje. Nuk dua të zgjatem shumë, pasi kjo pyetje kërkon një përgjigje pak të zgjatur. Po ju them se kur njeriu ka një formim politik-ushtarak të shumanshëm e të plotë, një përvojë të gjatë drejtuese e pune me njerëzit, njeh shtetin, rëndësinë e zbatimit të përpiktë të ligjeve dhe të kushtetutës dhe e do vendin e tij, nuk ka pse të mos ia dalë me nder çdo detyrë, sado e lartë dhe e vështirë qoftë. Mund të them se ky është

sekreti, nëse mund të quhej kështu, i suksesit tim në kryerjen e detyrës së lartë të Kryetarit të Shtetit. Në botë njihen shumë shembuj, kur ushtarakë të nderuar kanë udhëhequr me sukses shtete të mëdha, si p.sh. Gjenerali Ajzenhauer, Gjenerali De Gol e të tjerë. Sigurisht ne jemi një vend i vogël dhe nuk mund të krahasohemi me ata, por e solla si shembull që zgjidhje të tilla nuk janë përjashtim.

Sigurisht që nuk është e lehtë të bindësh politikanët e ndryshëm për t'i bërë që të mendojnë e të veprojnë ashtu si duhet, aq më tepër politikanët shqiptarë, por mendoj se edhe ata, në rast se iu vihet përpara shembullit personal dhe argumentet e duhura, më në fund do ta kuptojnë se çfarë është e dobishme për vendin dhe çfarë jo. Gjatë pesë viteve të ushtrimit të detyrës, kam patur raste të shumta, kur më është dashur të gjej rrugëzgjidhje të vështira. Mendoj se më i spikaturi dhe më i rëndësishmi ka qenë Janari i vitit 2007, kur ishim në rrezik që të na dështonin zgjedhjet vendore. Atëherë u detyrova që t'i grumbulloj të gjithë drejtuesit e partive parlamentare në Presidencë dhe t'i mbaj më se 24 orë, duke i ushqyer me çaj dhe pica, deri sa u arrit marrëveshja e përbashkët, e cila u shpall në 12.00 të natës. Por, që kur i mblodha iu thashë: "Jemi mblodhur për ta zgjidhur këtë problem. Do rrimë këtu deri sa të gjejmë zgjidhje dhe vetëm kur të dalë tymi i bardhë, si në Vatikan, atëherë do të shpërndahemi." Të gjithë qeshën, edhe unë bashkë me ta, vetëm se unë nuk e kisha me shaka, por me gjithë mend. Dhe ashtu ndodhi. E bëra atë, pasi nuk kisha rrugë tjetër për të vazhduar zgjedhjet normale.

Por duhet të them se edhe media vizive na shoqëroi deri sa i dhamë fund dhe arritëm te vendimi i duhur. Kjo ishte një ndihmë e madhe për mua dhe e sensibilizoi opinionin publik në atë shkallë që edhe nëse dikush mund të donte të vepronte ndryshe do ta kishte të vështirë të përballej me atmosferën e krijuar.

Por dua të flas edhe për diçka që më duket se ia vlen shumë ta kujtoj. Në ushtri ne jemi mësuar se kur komandanti merr vendimin dëgjon fillimisht të gjithë anëtarët kryesorë të shtabit dhe pastaj merr vendimin. Pra në marrjen e vendimit në bazë të situatës së krijuar përdor gjykimin kolektiv të problemit.

Pikërisht bazuar në këtë metodë vendosa që për miratimin e ligjeve të rëndësishme të krijoja "Këshillin e të urtëve", ku bënin pjesë disa nga juristët më me emër të vendit tonë. Dhe ligjet e rëndësishme i miratoja vetëm pasi kisha dëgjuar me vëmendje

sugjerimet e tyre.

Kjo mënyrë vlerësimi dhe veprimi në fund dha një rezultat të çuditshëm, të cilin ma vunë në dukje analistët, në fund të mandatit tim. Gjatë viteve të Presidencës kisha kthyer të dy shumicave të njëjtën sasi të ligjeve. Kjo nuk u bë me synim, por mënyra sesi i shqyrtonim ne ligjet, që vinin për miratim, e solli natyrshëm një rezultat të tillë.

Z. President, jemi në 78-vjetorin e krijimit të Shkollës së mesme Ushtarake "Skënderbej", nga e cila kanë dalë me qindra djem dhe vajza, që sot janë ushtarakë karriere dhe jo pak prej tyre, zënë një vend të rëndësishëm me kontributin e tyre dhe në fusha të tjera të jetës. Pra një "fidanishte", e cila ka nxjerrë njerëz të vlerë.

Çfarë do t'u thoshit sot atyre, si një lider shpirtëror, të cilin shpesh i referohen për vlerat e larta si ushtarak, drejtues dhe akademik, të paktët e këtij vendi?

Po, është e vërtetë, shkolla Ushtarake "Skënderbej" ishte një fidanishte reale e kuadrit ushtarak shqiptar. Sikurse dihet, ajo u inaugurua në mars të vitit 1945. Në inaugurimin e Shkollës së mesme Ushtarake "Skënderbej" ka qenë Gjeneral Spiro Moisiu, në atë kohë shef i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Shqiptare.

Shkolla fillimisht u hap për partizanët e moshave të vogla, më vonë pastaj ajo mori përhapje më të madhe, duke përgatitur që në moshë të hershme kuadrot e ardhshme të Ushtrisë Shqiptare.

Dihet që në radhët e kësaj shkolle kanë kaluar më se 60% e oficerëve të Ushtrisë Shqiptare. Dhe duhet thënë se oficerët që vinin nga kjo shkollë ishin ndër më të përgatiturit nga ana fizike, njohjes të rregullave të ushtrisë dhe me njohuri të mira mbi armët e këmbësorisë, në krahasim me ata që vinin nga gjimnazet e tjera të vendit. Kjo pasi ata, krahas kulturës së programuar, si për të gjitha shkollat e mesme të republikës, kryenin edhe përgatitje ushtarake. Por kryesorja është se ata rriteshin me ndjesitë e seriozitetit dhe të rëndësisë së detyrës ushtarake që në vegjëli. Kishin të zhvilluar shumë mirë, që në moshë të re, ndjenjën e patriotizmit dhe gatishmërinë për të sakrifikuar për detyrën.

Fakti që kjo shkollë filloi nga puna gati dy muaj para mbarimit të Luftës së Dytë Botërore, tregon vlerësimin e rëndësishëm së përgatitjes së kuadrit për ushtrinë që në fillimet e para të fillimit të jetës normale të Shtetit të ri Shqiptar. Dhe shkolla "Skënderbej" e luajti më së miri këtë rol.

E vërteta është se kuadrot e dalë nga ajo

shkollë, gradualisht pasi kaluan në shkollat e ndryshme ushtarak si brenda edhe jashtë shtetit, u kthyen në oficerë të dalluar dhe me shumë vlera në të gjithë sektorët e ushtrisë. Duhet thënë së ushtria nga një ushtri partizane vullnetare do të kthehej në një ushtri bashkëkohore, të paktën të aftë për t'u përballur në rast nevojë me ushtritë e rajonit. Kështu, shumë prej tyre u bënë pilotë, marinarë, tankistë, artiljerë, xhënierë, ndërlihdës e të tjerë.

Pas viti 1992, kur u bë reforma e madhe në ushtri, shumë prej tyre dolën në pension të parakohshëm.


Sigurisht tani ata që e kanë kryer atë

trashëguar, në mënyrë që kuadrot aktuale jo vetëm të ruajnë dashurinë dhe besnikërinë për atdheun, detyrën, flakurin, por ta forcojnë atë në maksimum, veçanërisht në situatat që po kalon sot Ballkani.

Të ruajnë solidaritetin ushtarak, i cili tek ne është dëmtuar shumë, si gjatë kohës së diktaturës ashtu edhe më vonë.

Ndjenja e solidaritetit e mban të pastër ushtrinë nga veset e shëmtuara të kohës dhe forcon kompaktësinë e kuadrit ushtarak. Të ruajnë seriozitetin në detyrë dhe të mos bien pre e lojërave politike denigruese.

Me këtë rast iu uroj dhe iu dëshiroj atyre jetë të gjatë, të shëndetshme dhe të rri-



shkollë, një pjesë e madhe janë në pension, por ata ruajnë më së miri miqësinë dhe mirëkuptimin e tyre për jetën e vështirë të kaluar në ushtri në vitet e kaluara. Pavarësisht nga gjendja aktuale, ku një pjesë e tyre tani janë aktivizuar në biznese të ndryshme, ata kudo dallohen për disiplinë në punë, për organizim të përgjegjshëm të detyrave të tyre në biznes, për korrektësi dhe ndershmëri. Nga bisedat që kam pasur me biznesmenë të ndryshëm, më kanë thënë se i preferojnë ushtarakët e pensionuar pikërisht për ato cilësi që përmenda më lart.

Mendoj se si oficerët pensionistë ashtu edhe ata që janë në shërbim, nuk duhet asnjëherë t'i harrojnë ish-kolegët e tyre. Oficerët që kanë dalë nga kjo shkollë, nëpërmjet kontakteve me kolegët e tyre aktivë duhet të ndikojnë në ruajtjen e atyre vlerave pozitive që kanë

sin nipër dhe stërnipër që asnjëherë të mos e harrojnë dhe të mos e braktisin këtë vend, për të cilin, në shekuj është derdhur shumë gjak dhe djersë.

Në përfundim desha të shtoj se është më se arsyeshme që të kemi një historik të shkruar, jashtë ndikimeve të politikës tonë në shumë raste të harlisur, mbi Ushtrinë Shqiptare. Është një përvojë e gjatë, që nga shpallja e pavarësisë, në 1912, deri në ditët e sotme. Gjatë kësaj kohe ka pasur shumë ngjarje, ku ushtria jonë ka vepruar praktikisht me veprime luftarake për mbrojtjen e vendit, veçanërisht gjatë Luftës së Dytë Botërore, kur vendi ynë u rreshtua krahas aleatëve të mëdhenj antifashistë. E di që në kushtet e sotme, kur tek ne është në modë nihilizmi i realitetit, nuk është një detyrë e lehtë, por deri sa po punohet për një enciklopedi, edhe për historinë e ushtrisë duhet menduar.



Gjeneralmajor Manushaqe Shehu:

NËSE NUK KA TAVAN,

kufi kemi qiellin, prandaj forca, mos pushoni, derisa çdonjëra prej grave dhe vajzave të ketë mundësinë që meriton!

Gjeneralmajor Manushaqe Shehu, gruaja e parë në piramidën e ushtrisë shqiptare, burim frymëzimi dhe vlerash njerëzore, vjen nëpërmjet autobiografisë së saj, për të na treguar se si një femër ia del të realizojë në perfeksion raportet mes familjes, karrierës dhe jetës sociale.

Unë, bija, nëna, bashkëshortja, mikja, shoqja, ushtarakja e karrierës, gjeneralmajor Manushaqe Shehu! Jeta dhe karriera ime është e lidhur sa me jetën femërore, të shkollimit e të familjes, aq edhe me atë ushtarake. Janë dy ngjarje, dy kohë të lidhura me njëra-tjetrën që plotësojnë figurën time si vajzë, si nxënëse, studente, si bashkëshorte, si nënë, si vjehërr dhe si një ushtarake drejtuese në nivelet më të larta të drejtimit e komandimit strategjik, e mbi të gjitha me gradën madhore dhe më të lartën në Forcat e Armatosura, “gjeneralmajor”.

Arsimimi dhe karriera ushtarake

Kam lindur në fshatin Sohodoll të Dibrës, më 5 nëntor 1965, në një familje me traditat më të mira të krahinës së Dibrës. Fshati Sohodoll është një ndër tre fshatrat më të mëdhenj të Dibrës. Një fshat plot histori qëndrese, mençurie, diturie me njerëz bujarë e zemërbardhë. Fshat me natyrë e fizionomi të bukur, i cili merr nuanca edhe më të bukura nga banorët punëtorë e të urtë që të hapin dyert dhe të mirëpresin në çdo kohë. Sohodolli është një perlë e Dibrës. Sohodolli ka nxjerrë figura të shquara në

të gjitha kohët dhe në të gjitha fushat: në arsim, shkencë, sport, bujqësi, në krijimtari, në ushtri etj. E ndjej veten krenare që jam bijë e këtij fshati me tradita, siç është Sohodolli im.

Shkollën 8-vjeçare dhe atë të mesme i përfundova në vendlindje, në Dibër. Me mbarimin e shkollës së mesme, ashtu si çdo i ri dhe e re që kishte ëndrra për të ardhmen, edhe unë në kërkesën për të vazhduar shkollën e lartë vura tre degë: Juridikun, Mjekësinë dhe Shkollën e Bashkuar të Oficerëve, por që, nisur nga tradita e familjes, dëshira më e madhe ishte të bëhesha ushtarake, dëshirë e cila m'u plotësua, dhe sot ndihem krenare për zgjedhjen e bërë. Familja ishte shtysa dhe mbështetja kryesore për realizimin e ëndrrës dhe pasionit që në vogëli për uniformën e nderuar ushtarake. Menjëherë pas gjimnazit për mua nisi rrugëtimi në jetën ushtarake, duke përfunduar me sukses Shkollën e Bashkuar të Oficerëve, dega logjistike. Po bëhen mbi tre dekada që unë i shërbej me përkushtim vendit tim nën uniformën ushtarake. Ky rrugëtim në uniformë, ka pasur një sërë eksperiencash, arritjesh, promovimesh, që më kanë bërë

krenare kudo, jo vetëm në rrethin tim familjar, por edhe në atë shoqëror, të krahinës e më gjerë.

Si oficere aktive, karrierën time e nisa në vitin 1988, në pozicionin e shefit të Logjistikës në Brigadën e Këmbëorisë në Peshkopi. Në atë periudhë, organizimi strukturor i ushtrisë ishte krejt i ndryshëm, ku dislokimi i reparteve përfshinte rajone të ndryshme me një shpërndarje gjeografike mjaft të gjerë, por kjo nuk më trembi, pasi unë isha rritur në një zonë të tillë me vështirësi të klimës, por edhe të infrastrukturës. Por ishte përkushtimi, përgjegjshmëria, serioziteti, angazhimi, korrektësia si ushtarake, që sfidën e parë të profesionit të nderuar të ushtarakut, ta përballoja me sukses. Në karrierën time si ushtarake kam kryer një sërë detyrash në të gjitha nivelet operacionale të ushtrisë, që nga batalioni, brigada, divizioni, SHPFA e deri në institucionin më të lartë, atë të Presidencës. Konkretisht, nga viti 1989, kur përfundova me rezultate të shkëlqyera Shkollën e Bashkuar e deri në 1996, kreu disa detyra të ndryshme në Logjistikë si intendent batalioni, shefe e shërbimeve të ndryshme logjistike për ushqimin, veshmbathjen, karburantin e kazermimin në brigadë, deri shefe e Logjistikës e Divizionit të Shkodrës. Në vitin 1996 u emërova specialiste e Kontrollit Financiar dhe Rezervave të Paprekshme në Ministrinë e Mbrojtjes. Këtë detyrë e mbahta deri në mars të vitit 2000. Gjatë viteve 2000 - 2002 punova pranë ekipit amerikan të Departamentit të Mbrojtjes të SHBA-ve, në Ministrinë së Mbrojtjes. Më 8 tetor 2007, u emërova ndihmëse e presidentit të Republikës për çështjet ushtarake dhe integrimin Euroatlantik. Më 4 shkurt 2011, u emërova këshilltare ushtarake e presidentit të Republikës. Më 1 shtator 2012, u emërova drejtoreshë e Bashkëpunimit Civil - Ushtarak në Ministrinë e Mbrojtjes. Pas përfundimit të kualifikimeve në Akademinë e Mbrojtjes, më 1 nëntor 2016, u emërova komandante e Akademisë së Nënoficerëve. Ishte kjo detyrë, që do të shënonte kulmin në ecurinë time në karrierë për një ushtarak, e për më tepër për një grua, duke u promovuar, më 16

nëntor 2016, si e para ushtarake femër në historinë e Republikës së Shqipërisë me gradën madhore "gjenral brigade". Vlerësimi dhe besimi i treguar nga lidërsipit civil i asaj kohe, i MM, për thyerjen e tabusë mbi kontributin e gruas në pozicionet më të larta në Forcat e Armatosura Shqiptare, për mua do të ishte përgjegjësi, profesionalizëm dhe mbi të gjitha përkushtim ndaj detyrës, përkushtim ndaj punës, ndaj atdheut. Sfidat e radhës për mua, tashmë "gjenral", ishte marrja e detyrës së komandantit të Komandës së Doktrinës dhe Stërviçjes, më 1 dhjetor 2016, detyrë të cilën e kreu deri më 16 janar 2018, sfidë e kaluar me sukses. Sfidat në dinjitet, në vlerë, në përpjekje, në arritje, kulmuan përsëri deri në majën e piramidës së Forcave të Armatosura shqiptare si zëvendës shef i SHP të FA, detyrë të cilën vijoi ta kryej që nga data 16 janar 2018.

Cilësitë e shtuara në karrierën time, përsëri nuk ngelën jashtë vëmendjes së lidërsipit më të lartë të vendit. Kështu me dekretin nr.1313, datë 17.06.2021, të Presidentit të Republikës, mu dha grada madhore "gjenralmajor", një vlerësim i madh për mua, por edhe një përgjegjësi akoma më e madhe. E gjithë kjo ecuri pozitive, ka shkuar paralel edhe me kualifikimet e kryera nga ana ime. Përgjatë karrierës sime kam kryer të gjitha kualifikimet institucionale e funksionale, civile e ushtarake, si brenda vendit, ashtu dhe jashtë vendit, për fushat e

shërbimit ku kam punuar. Ndër më të rëndësishmet, janë:

- Gjatë viteve 1989 - 1994, përfundova Kursin Themelor të Oficerit në SHPFA dhe Kursin e Funksioneve në Akademinë e Mbrojtjes, Tiranë.
- Në vitet 2004 - 2010 përfundova Akademinë e Shtabit të Përgjithshëm, Kursin e Lartë të Oficerit, Master i Nivelit II në "Fushën e Sigurisë Kombëtare", si dhe Kolegjin e Lartë Rajonal të Sigurisë dhe të Mbrojtjes. Në muajin gusht 2018, në mbrojtje të temës "Lidërsipit dhe ndikimi i tij në menaxhimin e mjedisit të sigurisë. Rasti i Ballkanit e më gjerë", fitova gradën shkencore "Doktor".
- Përveç arsimimit ushtarak, kam kryer edhe studime e kualifikime në aspektin civil e ushtarak, të cilat më kanë ndihmuar edhe ato në kryerjen e detyrave ushtarake. Ndër më kryesoret do të përmendja:
- Gjatë viteve 1989 - 1994, përfundova Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin "Luigj Gurakuqi" të Shkodrës;
- Gjatë vitit 2017 kreu Kursin e Sigurisë në "Qendrën Marshall", Garmish, Gjermani;
- Në vitet 2004 - 2005 përfundova kursin ADAMS P&P (shkollë logjistike) në Turqi, Francë;
- Në 2013, kursin e CIMIC në Qendrën P&P, Ankara, Turqi;
- Në 2014, kursin "Gender Perspective in Peacekeeping Operations", në Zagreb, Kroaci;
- Në 2015, kursin e CIMIC&CIMI Oberamengau, Gjermani;





Kam botuar një numër të madh artikujsh shkencorë e ushtarakë, në revista ushtarake, brenda dhe jashtë vendit, në shtypin ushtarak e civil. Kam marrë pjesë në disa aktivitete ushtarake ndërkombëtare në vendet anëtare të NATO-s dhe ato partnere të saj. Jam dekoruar me urdhra e medalje të ndryshme nga ministri i Mbrojtjes dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, si dhe medalje, kupë e certifikata si “Sportiste e dalluar”, “Në ndihmë të popullsisë në donacione të ndryshme”, “Aktiviste e zbatimit të rezolutës 1325”, etj.

Hobi im, ka qenë dhe mbetet ai i ushtrimit të sporteve. Gjithashtu jam njohëse e mirë e dy gjuhëve të huaja, anglisht dhe italisht.

Kontributi im si ushtarake e karrierës në Forcat e Armatosura, ka qenë i lidhur me aktivitetin tim në familje, por edhe në jetën shoqërore. Unë para se të jem një ushtarake, jam një femër si gjithë të tjerat, jam një bashkëshorte, jam nënë e dy fëmijëve të mrekullueshëm, djalit Ilirit, financiar në BKT, i vajzës Kejsit, mjeke në Gjermani. Si e tillë kam detyrimet familjare si çdo grua. Por pavarësisht ngarkesave e detyrimeve në familje, për asnjë çast nuk më kanë penguar, që si ushtarake të jem aktive në çdo detyrë. Me të vërtetë, për shkak të detyrës e të uniformës ushtarake, në disa raste nuk kam qenë pranë fëmijëve, kur ata kanë pasur nevojën për nënën e tyre, por në çdo rast kam pasur ndihmën e mirëkuptimin e bashkëshortit, Saliut, edhe pse edhe ai ka pasur angazhimet e veta si politikan. Por dua të them se me unitet e marrëveshje kemi plotësuar njëri-tjetrin në detyrimet familjare, pa penguar a kufizuar asnjërin në angazhimet shtetërore por edhe ato shoqërore. Me iniciativë, këmbëngulje me ambicie e sedër për të arritur edhe të pamundurën, nuk ka sukses që nuk arrihet, nuk ka majë të karrierës që njeriu, qoftë mashkull apo femër, të mos e arrijë. Sot, si nënë, si bashkëshorte, si ushtarake them se me mund e djersë kam arritur diçka në jetë, por asnjëherë nuk jam e vetmja, pasi si unë ka gra të shumta ushtarake e civile që kanë bërë karrierë të suksesshme në jetë.

- Në 2016 kursin e “Luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore”, në Qendrën P&P, Ankara, Turqi;
- Në 2016, kursin e Leadershipit Strategjik, Budva, të iniciuar nga Mbretëria e Bashkuar, në Mal të Zi;
- Në 2017, kursin “Building Integrity”, në Mbretërinë e Bashkuar;
- Në 2018, kursin “The Mediterranean of the Future: conditions for a new equilibrium”, në Paris, Francë.

Gjithashtu kam qenë mjaft e angazhuar në aktivitete të ndryshme kombëtare e ndërkombëtare, ku mund të përmendja praninë time nismëtare e disa projekteve të ristrukturimit të FA-së dhe si anëtare e Bordit të Kompanisë Amerikane SAIC, për ndryshimin e strukturave të FA-së, anëtare e bordeve drejtuese të ndryshimit të

disa rregulloreve për Logjistikën në FA, si dhe drejtuese e Bordit të Ndryshimit të Normave të Ushqimit dhe Veshmbathjes e Kazermimit në FA. Gjithashtu, kam marrë pjesë si nismëtare e një sërë projektesh të përbashkëta civilo-ushtarake kombëtare dhe ndërkombëtare, ku një vend të veçantë zënë projektet për barazinë gjinore, për të cilat kam marrë mirënjohje dhe falënderime nga organizatat kombëtare dhe ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, por edhe nga shoqëria civile e strukturat e tjera të kontrollit civil në Forcat e Armatosura. Kam marrë pjesë aktive në stërvitje të përbashkëta me vende anëtare të NATO-s; aktiviste dhe drejtuese e nismave në ndihmë të grave ushtarake e civile të FA-së dhe të rajonit.

*Intervistë me komandantin e
AFA-së, gjeneral brigade Bilbil Bitri*



Drejt suksesit të "Defender Europe 2023"

Intervistoi:
ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Stërvitja e NATO-s në Shqipëri, “Defender Europe 2021”, është konsideruar si tregues i nivelit të ngushtë të bashkëpunimit dhe i marrëdhënieve që Shqipëria ka me SHBA-të. Shqipëria ishte vendi mikpritës i stërvitjes, me mbi 17 mijë trupa amerikane dhe 14 mijë të tjera nga 26 vende anëtare të NATO-s. Sipas Ministrisë së Mbrojtjes, 4 mijë ushtarë amerikanë u vendosën në Shqipëri dhe pjesa tjetër u zhvendosën në vendet fqinje.

“Defender Europe 21”, nga viti 1995, konsiderohet si një nga më të mëdhatë në Europë. Shqipëria u zgjodh ndër shtetet e tjera për shkak të vendndodhjes së saj strategjike dhe faktit se ka qenë një partner i vlefshëm për SHBA-të prej vitesh. Kjo stërvitje u krye në pjesën e Ballkanit dhe Detit të Zi.

Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë në angazhimin e tyre morën vlerësimet maksimale. Ambasadorja e SHBA-ve në Shqipëri, Yuri Kim, në mbyllje të kësaj stërvitjeje iu drejtua forcave shqiptare: “Ne e njohim trimërinë tuaj dhe jemi të nderuar t’ju quajmë Aleatët tanë!”

Tashmë jemi në prag të fillimit të stërvitjes së madhe të partneriteteve të fuqive të NATO-s, “Defender Europe 2023”. Për organizimin si vendi pritës dhe si komandant i Task Force South, gjeneral brigade Bilbil Bitri (komandant i Akademisë së Forcave të Armatosura), sjell për lexuesin një panoramë të kësaj stërvitjeje me rëndësi të madhe për Forcat e Armatosura.

Zoti Gjeneral, çfarë synon kjo stërvitje, e cila kërkon një bashkërendim midis kaq shumë kombesh?

“Defender-Europe” është një stërvitje e përvitshme e përmasave të mëdha e drejtuar nga Ushtria Amerikane,

shumëkombëshe dhe e bashkuar (joint), e projektuar të ndërtojë gatishmërinë dhe ndërveprueshmërinë midis SHBA-ve, NATO-s dhe vendeve Partnere.

Stërvitjet janë “mjeti” më i rëndësishëm, e ndoshta i vetmi, përmes të cilave formacionet ushtarake, më vete ose së bashku me formacione të tjera kombëtare, apo ndërkombëtare, testojnë dhe “certifikojnë” konceptet, teknikat, taktikat dhe procedurat. Një gjë e tillë është e vërtetë sot, po aq sa ishte 40 vjet më parë, kur në raportin e Shefit të Shtabeve të Bashkuara të SHBA-së për Kongresin amerikan shkruhej: “Stërvitjet janë mjeti më i mirë, përveç luftës, për të testuar aftësinë e forcave tona, për të përmbushur misionin e tyre në mënyrë efektive”.

Zoti Gjeneral, stërvitja “Defender Europe 21” është vlerësuar si më e madhja e zhvilluar ndonjëherë më parë në këtë rajon. A mund të na tregoni mbi përmasat dhe qëllimet e stërvitjes?

Angazhimi dhe pjesëmarrja aktive e vendit tonë “Swift Response”, “Immediate Response” apo “Saber Guardian”, janë emra të koduar stërvitjesh shumëkombëshe që zhvillohen prej vitesh në hapësirën Evropiane të Aleancës, nën drejtimin e Ushtrisë Amerikane në Europë (US Army Europe). Secila prej stërvitjeve ka të përcaktuar synimet

“DE - 23 synon të trajnojë dhe testojë gatishmërinë dhe aftësinë e forcave për t’iu përgjigjur rreziqeve potenciale të sigurisë dhe konflikteve në Europë.”





“Vendi ynë është pjesë e stërvitjes, jo vetëm si 'hapësirë gjeografike', por dhe pjesëmarrës aktiv me trupa dhe mjete në “Immediate Response”, “Saber Guardian” dhe “Astral Knight”. Pjesën më të qenësishme të angazhimit dhe kontributit do ta ketë në “Immediate Response 23”.

Ushtrisë Amerikane në Europë, vende aleate dhe partnere, Ministri i Mbrojtjes do të theksojë se “‘Defender Europe’ për ne, mbetet një mjet i fuqishëm i komunikimit strategjik, i paqes, sigurisë, stabilitetit dhe garancisë për qytetarët tanë, vendet e rajonit dhe mbarë Evropën”. Shefi i Shtabit të Përgjithshëm nga ana e tij do të shprehet se “‘Defender Europe -23’, përmes aktiviteteve dhe demonstrimit të aftësive të saj, do t’u japë kundërshtarëve një mesazh të qartë dhe të fortë parandalimi dhe mbrojtjeje”. Rreth një vit e gjysmë pas këtij aktivitetit të parë planëzues, jemi në “metrat” e fundit të përgatitjeve për të filluar fazën e ekzekutimit të “Defender Europe 2023”.

dhe objektivat e saj, por të gjitha këto janë pjesë e të njëjtës “paketë” – “Defender Europe”.

Në periudhën maj-qershor 2021, vendi ynë ishte njëherësh mikpritës dhe pjesëmarrës i “Defender Europe 21”, e cila ishte stërvitja më e madhe me trupa e zhvilluar në rajonin e Ballkanit që prej përfundimit të Luftës së Ftohtë. Numri i trupave, sistemeve dhe pajisjeve që zbarkuan, kaluan transit apo qëndruan në territorin e vendit tonë ishte më i larti që vendi ynë kishte pasur deri atëherë. Natyra e operacioneve të zbarkimit, dislokimit e të mbështetjes logjistike nga deti në breg/tokë ishte gjithashtu unike.

Të gjitha këto të vendosura në kontekstin gjeografik, shprehur me fjalët e Ambasadores së SHBA-ve në Tiranë, Yuri Kim, - “Kushdo që sheh hartën do kuptojë rëndësinë gjeostrategjike të Shqipërisë”, - e bëjnë vendin tonë pjesë të rëndësishme të serisë së stërvitjeve “Defender Europe”.

Cila është pjesa dhe roli që ka marrë përsipër ushtria e Shqipërisë?

Në tetor 2021, ndërsa vijonte identifikimi dhe analiza e gjetjeve të “Defender 21”, në Tiranë nisi “rrugëtimin” procesi i planëzimit për stërvitjen “Defender Europe 2023”. Duke iu drejtuar planëzuesve të stërvitjes, të ardhur nga komanda e

Kur daton fillimi i “Defender Europe 2023”?

Stërvitja “Defender Europe 2023” do të mbahet prej mesit të majit deri në mes të qershorit në disa rajone stërvitjeje në vende të ndryshme të Evropës. Gjeografikisht ajo do të përfshijë hapësirën nga jugu i Greqisë dhe Spanjës deri në kufijtë verior e lindor të Estonisë. Praktikisht të gjithë hapësirën Evropiane të Aleancës.



Po Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, çfarë angazhimi do të kenë?

Vendi ynë është pjesë e stërvitjes, jo vetëm si “hapësirë gjeografike”, por dhe pjesëmarrës aktiv me trupa dhe mjete në “Immediate Response”, “Saber Guardian” dhe “Astral Knight”. Pjesën më të qenësishme të angazhimit dhe kontributit do ta ketë në “Immediate Response 23”.

Stërvitja “Immediate Response 23” është stërvitje në nivel divizionit, që përfshin dislokim, zhvendosje në rajonet e stërvitjes dhe integrim të forcave, të mjeteve dhe pajisjeve; qitje luftarake me sisteme armatimi të ndryshme; dhe manovër me forca e mjete.

Divizioni i 34-t i Këmbëtorisë së Ushtrisë Amerikane do të jetë njësi e cilës i është ngarkuar “ekzekutimi” i skenarit të stërvitjes IR23. Në nisje të procesit të planëzimit D34K, u caktua si zonë operacioni Ballkani Perëndimor dhe u organizua në tre Task Forca shumëkombëshe në nivel brigade. Task Forcë e Veriut e vendosur në Koraci, Task Forcë e Jugut e vendosur në Shqipëri dhe Task Forcë e Detit të Zi e vendosur në Bullgari.

Mbi dhjetë vende dhe afërsisht dhjetë mijë trupa do të jenë pjesë e stërvitjes IR23. Vendi ynë do të jetë mikpritës por edhe do të drejtojë Task Forcën Shumëkombëshe të Jugut (Multinational Task Force South – MNTF South - nivel brigade), në përbërje të së cilës janë afërsisht 3500 trupa nga Shqipëria, Kosova, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe SHBA-të, ndërkohë që me element shtabi, pjesë e saj do të jetë edhe Kroacia. Tre rajonet kryesore të stërvitjes për Task Forcën e Jugut do të jenë Baba i Bokës (Kosovë), Krivolak (Maqedonia e Veriut) dhe Bize (Shqipëri). Ndërsa shtabi i Task Forcës do të vendoset në Tiranë (Zall Herr).

Çfarë misioni ka Task Forca?

Karakterit ‘shumëkombësh’ i organizimit të Task Forcës do të jetë në secilin nga rajonet e stërvitjes, pasi njësitë kanë në përbërje të tyre formacione nga vende të tjera. Në Bizë, batalionit të dytë të këmbëtorisë do t’i bashkohen



një kompani CBRN e Gardës së NJ, një nënrepart nga Maqedonia e Veriut, një nënrepart nga Kosova. Në shtabin e Task Forcës, i cili do të vendoset në Tiranë, gjysma e tij janë nga shtetet e tjera të TF (SHBA, Kosova, Kroacia, Maqedonia e Veriut, dhe Mali i Zi). Ndërkohë nënreparte nga Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi dhe Gjermania do t’i bashkohen Regjimentit të Këmbëtorisë së Kosovës të FSK-së, të vendosur në rajonin stërvitor Baba i Bokës. Edhe në Krivolak, batalionit të Maqedonisë së Veriut do t’i bashkëngjiten nënreparte nga Shqipëria, Kosova, Mali i Zi dhe SHBA-të.

Cilat janë disa prej objektivave që priten të arrihen nga kjo stërvitje?

Aktivitetet planëzuese dhe ato të sinkronizimit, të organizuara nga komanda e Ushtrisë Amerikane në Evropë, kanë mundësuar koordinimin, saktësimin dhe precizimin e çdo elementi e detaji të konceptit të mbështetjes dhe të manovrës, të cilët në mënyrë të padiskutueshme do të kontribuojnë në arritjen e objektivave të stërvitjes, të cilët përfshijnë:

- Rritjen e ndërveprueshmërisë dhe koordinimit midis shteteve partnere, zgjerimin e kapacitete të mbrojtjes të aleatëve Evropianë dhe forcimin e partneritetit transatlantik.
- Projektimin e një force të gatshme për të luftuar në operacione luftarake të përmasave të mëdha.
- Planëzim, sinkronizim dhe integrim të RSOI.
- Zgjerimin e lirisë së manovrës.
- Vendosjen e përdorimit të sistemit të komunikimit të sigurt me partnerët (Mission Partnering Environment), si mjet primar i komunikimit për SHBA-të dhe aleatet e NATO-s.
- Zhvillimin e sistemeve dhe proceseve për ndarjen e informacionit dhe të inteligjencës.
- Objektiv i veçantë i kësaj stërvitjeje është edhe eksperimentimi dhe testimi. Përmes “Project Origin”, një kapacitet kundërtank inteligjent (nuk operohet nga personel) do të testohet aftësia e përdorimit në luftën kundër tankeve.

Cili është synimi kryesor i “Defender Europe 2023”

DE23 synon të trajnojë dhe testojë gatishmërinë dhe aftësinë e forcave për t’iu përgjigjur rreziqeve potenciale të sigurisë dhe konflikteve në Europë.

Përgatitjet për fillimin e ekzekutimit të stërvitjes janë në fazën përfundimtare. Grupi i Planëzimit në SHP dhe elementët e shtabit të Task Forcës kanë filluar procesin e “transferimit” të planëzimit tek Shtabi. Paralelisht po koordinohen e sinkronizohen veprimet me Div 34 të Ushtrisë Amerikane për realizimin me sukses të stërvitjes dhe arritjen e objektivave të saj. 22 maji është dita e parë e stërvitjes dhe njëherazi “Dita e Vizitorëve të Shquar”. Ju faleminderit i nderuar gjeneral dhe në emër të redaksisë së shtypit ushtarak, ju uroj suksese në drejtimin e kësaj stërvitjeje me rëndësi kombëtare!



Udhëtim të mbarë
në shekullin XXI!



Anjeza Musollari,
Shefe e Sektorit
të Botimeve

Po lundrojmë nëpër dallgët e shekullit të XXI, herë përplasemi fuqishëm me ajsbergët e padukshëm dhe herë vozitim mbi qetësinë e rreme të detit tinëzar.

Shpeshherë pyesim veten, pse u gjetëm në këto ujëra?

Vetë ne, qeniet humane, po tjetërsojmë gjithçka që kishte një emër, një formë, një vlerë.

Sipas Sokratit “çdo shoqëri e krijon modelin e njeriut sipas vetes së saj”. Shoqëria që lamë pas krijoi modelin e njeriut, në kushte e rrethana historike, me ndjesi e identitet të shtuar kombëtar. Është shoqëria, janë marrëdhëniet ekonomiko-shoqërore, që përcaktojnë shkallën kulturore e të sjelljes së individit.

Një shoqëri e përparuar dhe e moralshme, krijon individë të kulturuar e të sjellshëm. Raporti shoqëri-individ është reciprok. Në këtë raport, primar është interesi i përgjithshëm, që është bazë e jetës së shoqërisë dhe e çdo individ në veçanti. Vetëm nëpërmjet interesit të përgjithshëm, mund të plotësohen interesat personale dhe prirjet e veçanta të individit. Shoqëria dhe individ nuk janë fenomene të ndara.

“Në thelb, jemi qenie kolektive”, thotë V. Gëte. Njerëzit i bashkon karakteri shoqëror i pronësisë, territori, ndërgjegjja kombëtare, gjuha, traditat, idetë dhe botëkuptimi se sa mentaliteti i një individ, i cili mbart në vetvete dhe prirje egoiste, individualiste, që po të shumohen shkojnë në dëm të jetës publike e të shoqërisë në tërësi. Në këtë raport përcaktuese mbeten marrëdhëniet në prodhim dhe karakteri i pronësisë.

Është shoqëria, janë marrëdhëniet në prodhim që përcaktojnë sjelljen e individit. Në të kundërt, shoqëria kthehet në anarki, siç është shoqëria e sotme shqiptare.

Shoqëria, në bazë të ligjësisë objektive, nxjerr normat juridike dhe një sërë normash morale, universale të pranuar nga shoqëria. Individit nuk mund të merret i shkëputur nga marrëdhëniet shoqërore. Njeriu është i prirë të jetojë në shoqëri, se është pjesë e saj dhe kjo e shtyn atë të zbatojë rregullat ligjore e morale.

Njeriu është produkt i mjedisit në të cilin rritet dhe edukohet. Teoria e përhapur aq shumë në ditët e sotme e së “drejtës” të individit, tenton ta shkëputë individin nga shoqëria. Liritë dhe të drejtat e tij t’i shkëpusë nga ato të shoqërisë deri dhe t’ia kundërvërë me pretendimin e “lirisë” së individit dhe të drejtave të tij, që realisht bien ndesh me të shoqërisë, ku ai është pjesëtar. Individit nuk ka vetëm të drejta, por dhe detyra, që rrjedhin nga marrëdhëniet në shoqëri.

Njeriu është qenie sociale. Ndarja e të “drejtës” së individit nga e drejta universale, njerëzore, çon dhunshëm në kundërvënien e individit ndaj shoqërisë e familjes, që është qeliza bazë e shoqërisë, e cila trashëgon virtyte dhe traditat më të mira të qytetarisë shqiptare, që u shfaqën dukshëm para viteve ’90. Traditat e mira, ruajnë dhe konsolidojnë identitetin e një kombi. Nga e shkuara trashëgojmë gjithë të mirat: identitetin kombëtar, bekimin dhe dashurinë familjare që është jetësore. Familja është e shenjtë, në kuptimin më të mirë të fjalës. Ajo është e shenjtë se krijon trashëgiminë gjinore. Të jep dashurinë e fëmijëve, rrit solidaritetin shoqëror, dashurinë ndaj prindërve, miqve e ndaj njëri-tjetrit. Fëmijët lumturohen e gëzohen me dashurinë e prindërve të tyre. Në familje merret edukata e parë.

“Edukata e mirë, është lulja e jetës”. Mikpritja dhe bujaria janë nga cilësitë më të mira që ka krijuar dhe edukuar familja shqiptare. Këto, krahas cilësive të tjera, siç është atdhedashuria, liria, ruajtja e gjuhës dhe e identitetit kombëtar janë vlera të shtuara në shekuj, që mbart kombi shqiptar. Nga këto nocione, “liria”, në kuptimin e lirisë themelore, është më e hershme. Ajo pothuajse ka lindur bashkë me njeriun. Liria ka në themel barazinë e kushteve materiale, të drejtën bazike



për të jetuar, për të pasur një shtëpi dhe për t’u arsimuar. Nuk ka liri abstrakte. Liria është domosdoshmëri jetësore, por ajo nuk është e pakufizuar, veçanërisht kur flitet për liri individuale. “Liria pa kufi, - thotë shkriktari i madh francez Albert Kamy, - është e kundërta e lirisë”. “Masa të jetë kurdoherë, - thotë Horaci, - gjithçka ka një kufi”.



Por si po projektohen jetët tona në këtë mes shekulli të XXI?

Jeta është një mundësi për të fituar përjetësinë e lumtur ose atë të shëmtuarën, dhe kjo varet nga ne, pasi secili mbetet peng i veprës së tij.

Jeta është një provim, me sprovë që shpesh të ulin ose të ngrenë lart, kjo varet nga çelësi i gjithë suksesit, i cili është durimi.

Jemi të ndërgjegjshëm që jeta nuk është një vijë e drejtë, e as fushë më lule, ajo shpesh është një vijë e lakuar për të sfiduar genien tonë.

Jeta njerëzore në këtë shekull ‘të çuditshëm’ nga forma dhe përmbajtja, të jep përshtypjen e një studioje projektimi, ku ravijëzohet me majën e një lapsi jeta e gjithkujt.


Nëse prania fizike merret si fakt për të dëshmuar jetën, atëherë pa asnjë dyshim mund të shkruhet trashë e me shkronja të mëdha, se ne jetojmë dhe gjallojmë në shekullin XXI. Se jetojmë në këtë shekull, si prova ndihmëse mund të merren edhe makinat, kompjuteri, avionët, librat, letra, celulari etj. Stacionimi i plotë është i pamundur apo shumë i vështirë, por në vija të trasha, simbolikisht, mund të vizatohet.

Çfarë i ndodhi këtij shekulli të sëmurë, që prishi balancat e jetës?

Oreket territoriale, sëmundje e trashëguar nga historia, apo grykësi bulimike?

Shpesh historianët përpiqen të sjellin në kujtesën tonë atë çfarë historikisht ka ndodhur dhjetëra e qindra vjet më parë. Por çuditërisht për brezin e ri kjo duket e njohur, e jetuar, ‘pa interes’, sepse thjesht ndryshojnë emërtimet e atyre që kanë shkaktuar këto ngjarje historike, aktualiteti është i njëjtë. Lebra, kolera, malaria vite më parë, sot Covid-19, të gjitha në paralel,

vdekjeprurëse, transformuese, (armë shkatërrimi në masë). Ndër shekuj uria gllabëruese e territoreve ka nisur në epokën e gurit dhe deri në vitin 2022 të shek. XXI. Raca ‘homosapi-ence’ grykësinë e paska tipar dallues, sado transformimit të plotë fizik (njeriu i sotëm), kësaj tendence nuk iu larguam dot, madje po kthehet në një trend botëror. Numri më i madh i fëmijëve, që jetojnë në zonat e konfliktit, është në Afrikë (170 mil-



ion), ndërsa dendësia më e lartë është regjistruar në Lindjen e Mesme, Afganistani, Iraku, Mali, Nigeria, Republika e Afrikës Qendrore, Republika Demokratike e Kongos, Somalia, Sudani i Jugut, Siria dhe Jemeni, mbeten dhjetë vendet me numrin më të madh të shkeljeve serioze të të drejtave. Fatkeqësisht, në këto vende regjistrohet numri më i madh i vrasjeve dhe i gjyftimeve, i dhunës seksuale, i rekrutimit dhe i përdorimit të fëmijëve nga forcat e grupet e armatosura. Europa ka hyrë në luftë. Ushtarakisht lufta zhvillohet mes një agresori dhe një vendi nën agresion, ndërsa në të gjitha aspektet e tjera, ku aspekti ekonomik është themelori, lufta zhvillohet mes të gjitha vendeve që refuzojnë kategorikisht agresionin dhe agresorin.

Zhvillimi teknologjik një hap para, apo hendek mes brezave?

Sot jemi dëshmitarë të shpejtësisë së madhe në avancime dhe ndryshime në fushën e shkencës, teknologjisë, kulturës dhe shoqërisë si dhe arritjes së informacioneve të tepërta që askush nuk mund të ballafaqohet me to.

Pa dyshim, kjo shpejtësi mahnitëse e ndryshimeve të shkaktuara nga teknologjia, krijon stresa të rënda, çorientim dhe kaos në individë dhe shoqëri.

Çdo popull ka tregimet dhe mitet e veta rreth së ardhmes. Njerëzit gjithmonë e kanë ndier të nevojshme të dinë se ku do shkojnë, çfarë do të jetë ardhmëria e tyre e afërt si dhe ajo e largëta. Në shoqërinë e sotme teknologjike, shkencëtarët, filozofët dhe shkrimtarët janë ata të cilët mundohen të imagjinojnë të ardhmen. Vizionet dhe parashikimet e tyre ndahen në dy doktrina, atë optimiste dhe atë pesimiste. Optimistët besojnë që progresi i plotësuar me hulumtime shkencore do të vazhdojë të bëjë jetën tonë më të mirë duke mposhtur tërë problemet. Pesimistët, në të kundërtën, besojnë që problemet përcjellin vetë njerëzimin, dhe teknologjia vetëm sa i shton ato, duke i liruar forcat e errëta njerëzore që mund të dalin kontrollit përgjithmonë.

Shkencëtarët kishin një ëndërr: të ndërtojnë një robot që është i përsosur, të mendojë, të mësojë e madje edhe të dashurojë, sikur qeniet njerëzore. Megjithatë, në thellësinë e imagjinatës së tyre qëndronte frika se një ditë roboti do të marrë pushtetin mbi humanët dhe do të humbë qëllimi i vërtetë i jetës sonë,

duke u bërë robër të asaj që dikur ndërtuam. Fatkeqësisht, kjo nuk është më pjesë e imagjinatës së ndonjë shkrimtari fantastiko-shkencor por ky është realiteti që na rrethon (epoka e teknologjisë informative), koha kur njerëzit posedojnë aq shumë fuqi por pak dituri se si ta përdorin atë.

Udhëtimi ynë në këtë shekull “të çmendur” vlerash

‘Shekulli ku rrobat vendosin për vlerën e një personi dhe të kesh para është më e rëndësishme sesa të kesh miq të vërtetë apo edhe familje.

Shekulli ku fëmijët janë në gjendje të braktisin dhe të përbuzin prindërit e tyre.

Këtu ku dashuria është një projekt.’

Vozitni njerëz, por kujdesuni për llojin tuaj, për të ardhmen pa luftëra, për jetën, dhuratën e shenjtë pa kthim, për buzëqeshjen e fëmijëve edhe në këtë marrëzi mes shekulli XXI!





1 PRILLI 'HISTORIK' I SHQIPTARËVE

“Flamuri i NATO-s, krahas flamurit kombëtar, është flamuri i shenjtë i shqiptarëve, flamuri, i cili çliroi së bashku me flamurin kombëtar, 2 milionë shqiptarët që përjetuan barbaritë, mizoritë më të egra në Kosovë.”

Organizata ka themeluar një sistem mbrojtjeje kolektive, ku vendet anëtare bien dakord të mbrojnë njëra-tjetrën në rast sulmi nga një palë e jashtme. Pas përfundimit të ratifikimit të protokollit të anëtarësimit nga të gjitha vendet anëtare dhe depozitimit të instrumentit të aderimit në NATO në Departamentin Amerikan të Shtetit, Shqipëria u anëtarësua zyrtarisht në NATO, më 1 prill 2009.

Shqipëria shënon 14 vjet si anëtare e NATO-s

Gjatë regjimit komunist, Shqipëria ishte pjesë e Traktatit të Varshavës, blloku ushtarak i vendeve komuniste të Evropës, ku ishte anëtarësuar që në vitin 1955, ndërsa u largua nga ky bllok në vitin 1968.

Pas përmbysjes së regjimit komunist, Shqipëria përcaktoi integrimin euroatlantik si një objektiv strategjik për vendin, duke mos ndërprerë proceset e integritit dhe duke u angazhuar në përmbushjen e detyrimeve në kuadër të këtij procesi. Ky proces për rreth 17 vite me radhë ka kaluar nëpër sfida dhe angazhime të ndryshme të vendit, si në politikën e brendshme ashtu edhe në politikën e jashtme.

Qershor 1992, Shqipëria aplikon dhe pranohet zyrtarisht në Këshillin e Bashkëpunimit të Atlantikut të Veriut (NACC).

Dhjetor 1992, shënohet vizita e parë zyrtare nga Presidenti i Shqipërisë, z. Sali Berisha, në selinë e NATO-s, ku takohet me Sekretarin e Përgjithshëm të Aleancës Z. Manfred Verner.

19 mars 1993, për herë të parë, viziton Shqipërinë Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Manfred Verner.

Maj 1993, Shqipëria pranohet anëtare e Asamblesë së Atlantikut të Veriut.

Janar 1994, NATO lëshoi dokumentin ftesë të Partneritetit për Paqe, duke e përcaktuar atë si një program të drejtëpërdrejtë dhe një mekanizëm praktik për të transformuar marrëdhëniet

ndërmjet NATO-s dhe shteteve jo anëtare, kryesisht të "Bllokut Lindor", që nuk përfshiheshin nën "ombrellën e sigurisë" sipas artikullit 5 të saj.

23 shkurt 1994, Presidenti, Dr. Sali Berisha nënshkroi Dokumentin Kuadër të Pfp, duke e bërë Shqipërinë zyrtarisht anëtare të kësaj iniciative (Pfp).



20 prill 1994, Parlamenti shqiptar ratifikoi dokumentin themelor të Pfp.

3 qershor 1994, u krijua Shoqata e Atlantikut të Veriut në Shqipëri në të cilën morën pjesë rreth 80 intelektualë të fushave të ndryshme.

22 shtator 1994, Shqipëria paraqiti në NATO dokumentin e prezantimit të Shqipërisë në Pfp, ku deklaroi kapacitetet dhe kuadrin e bashkëpunimit si vend partner.

25 janar 1995, u miratua programi i parë individual i partneritetit (IPP) të Shqipërisë me NATO.

9 qershor 1995, Shqipëria u përfshi zyrtarisht në procesin e planifikimit dhe rishikimit të partneritetit për paqe (PARP), proces i cili krijon kushte për të përfituar dhe aplikuar eksperiencën e NATO-s në fushën e planifikimit të mbrojtjes. Duke marrë pjesë në ciklet e PARP, Shqipëria nisi shkëmbimin me

NATO-n, të informacionit dhe marrjen më në detaje të ekspertizës për çështje të një spektri të gjerë, që përfshijnë politikën e mbrojtjes, zhvillimet për kontrollin demokratik të Forcave të Armatosura, mbi forcat që Shqipëria ofron në dispozicion të NATO/Pfp dhe planet përkatëse financiare. Viti 1996, NATO ndërmori për herë të parë një proces ambicioz studimi rreth mundësisë së zgjerimit të Aleancës, nëpërmjet 5 parimeve për zgjerim (NATO).

7 korrik dhe 11 tetor 1996, në selinë e

NATO-s, zhvillohen dy sesione të dialogut individual NATO-Shqipëri.

30 maj 1997, në Sintra të Portugalisë, Shqipëria mori pjesë në takimin e parë të organizmit të ri që zëvendësoi NACC, dhe që u quajt Këshilli i Partneritetit Euroatlantik (EAPC).

Me një rëndësi të veçantë ishte vullneti i shprehur nga pala shqiptare në këtë takim, që NATO të kontribuonte në procesin delikat të rindërtimit të ushtrisë shqiptare sipas standardeve e koncepteve moderne bashkëkohore.

sërë masave konkrete ku veçohen, mbajtja e një stërvitjeje të përbashkët ajrore të NATO-s mbi Shqipëri dhe Maqedoni, si dhe hapjen e zyrës së NATO/PfP në Tiranë.

Fushata ajrore e NATO-s kundër Serbisë, për të ndërprerë fushatën kriminale të spastrimit etnik të ndërmarrë nga regjimi i Millosheviçit, përbën një pikë kulminante në historikun e marrëdhënieve midis Shqipërisë dhe Aleancës.

Viti 1999, gjatë krizës së Kosovës, Shqipëria ofroi lehtësirat e saj aeropor-

si vend aspirant për anëtarësim në NATO.

Nëntor 1999, Shqipëria paraqiti për herë të parë Planin e Veprimit për Anëtarësim (MAP).

Gusht 2002, Shqipëria dërgon misionin e parë në Afganistan, misioni ISAF, 23 veta nga regjimenti Komando.

2003, Shqipëria dërgon misionin e vet të parë në Irak, një kompani Komando.

Viti 2003, në Samitin e Stambollit, çështja kryesore ishte përmirësimi në bashkëpunimin e strukturave NATO/

EAPC/PfP, që u përpunua tërësisht në raportin e rishikimit të gjithanshëm. Kryetarët e shteteve dhe qeverive e përshëndetën Shqipërinë për progresin e ndjeshëm në reforma, rolin e saj konstruktiv në nxitjen e stabilitetit rajonal dhe mbështetjen për Aleancën.

Maj 2003, Shqipëria, Kroacia dhe Maqedonia së bashku me SHBA-të nënshkruajnë "Kartën e Adriatik 3 - SHBA" (u konsiderua si një nismë që do të përgatiste hyrjen e të tre vendeve në NATO, sipas shembullit të "Grupit të Vilniusit").

Gjatë viteve 2004 – 2008, Shqipëria ka vazhduar procesin e konsultimeve me NATO-n gjatë takimeve të përvitshme që janë zhvilluar në kuadër të MAP, PARP dhe Ministerialit të NATO/

EACP etj. Shqipëria ishte e angazhuar në përmbushjen e 43 objektivave të partneritetit, që përcaktonin masat për të aftësuar më tepër Forcat tona të Armatosura për të operuar së bashku me forcat e Aleancës.

FASH kanë dhënë një kontribut domethënës në operacionet e mbështetjes së paqes të drejtuara nga NATO, por edhe BE e OKB. Janë pikërisht këto kontribute që ndikuan që Shqipëria të shihej si një vend që prodhonte siguri, në vend që të konsumonte atë.

FASH krahas pjesëmarrjes në misione



Mars 1998, Aleanca shndërrohet në një nga pikat kryesore të fokusimit dhe koordinimit të përpjekjeve politike-ushtarake të bashkësisë ndërkombëtare për zgjidhjen e krizës kosovare, duke përfshirë edhe opsionin e përdorimit të forcës.

Mars 1998, pala shqiptare u paraqiti vendeve të NATO-s shqetësimet dhe qëndrimet e saj pas përkeqësimit të situatës në Kosovë. Qershor 1998, duke iu përgjigjur zhvillimeve dramatike në Kosovë, Ministrat e Mbrojtjes të NATO-s vendosën adoptimin e një

tuale në ndihmë të operacionit të NATO-s në Kosovë dhe mund të thuhet pa mëdyshje se Shqipëria, de facto, reagonte e vepronte sikur të ishte një vend anëtar i NATO-s.

31 gusht 1999, NATO krijon KOMMZ (W) (Durrës) për mbështetjen e mëtejshme të misionit të saj në Kosovë. Shtabi i saj u integrua në strukturën e KFOR-it dhe përbënte forcën e parë operacionale të NATO-s të dislokuar në Shqipëri.

Pas Samitit të Washingtoni, 23-24 prill 1999, Shqipëria së bashku me 8 vende të tjera (me vonë dhe Kroacia) u pranua

luftarake kanë realizuar edhe një numër aktivitete të tjera të përbashkëta me NATO-n, të natyrës stërvitje, konferenca, etj.

Marrja e ftesës së anëtarësimit në NATO (në Samitin e Bukureshtit, 2 prill 2008) dhe anëtarësimi me të drejta të plota në Samitin e Strasburg&Kehl, 2 prill 2009, finalizoi ato përpjekje dhe atë aspiratë mbarë shqiptare për anëtarësim në NATO.

Populli shqiptar mbetet në treguesit më të lartë të mbështetjes së anëtarësimit të vendit në NATO dhe pjesëmarrjes në misione të drejtuara nga NATO jashtë rajonit.

Para, por edhe pas anëtarësimit, Shqipëria ka ofruar kontributin e saj në operacionet ndërkombëtare të paqes të drejtuara nga NATO, por edhe nga Bashkimi Evropian (BE) dhe Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB).

Sipas të dhënave zyrtare të Ministrisë së Mbrojtjes së Shqipërisë, nga viti 1994 kur filloi edhe angazhimi në misionet ndërkombëtare dhe deri sot, në misionet e drejtuara nga NATO, BE dhe OKB, kanë kontribuar një personel prej më shumë se 6982 ushtarakësh të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Forcat e Armatosura kanë përfunduar misionet paqeruajtëse në Irak, Çad dhe Gjeorgji, në detin Egje, në Mali, ISAF dhe atë RSM në Afganistan.

Forcat e Armatosura janë aktualisht të angazhuara në misione paqeruajtëse dhe luftarake në Bosnje dhe Hercegovinë, Kosovë, Sudani i Jugut dhe eFP Letoni. Dita historike e 1 prillit të vitit 2009, e cila përkon edhe me 61-vjetorin e krijimit të Aleancës, futi vendin si anëtar me të drejta të plota në Aleancën më të suksesshme që ka njohur koha. Aleanca, me vlerat, me garancinë që i dha lirisë bëri të mundur që sistemi i vlerave të ngadhënjë në mbarë botën e lirë. Aleanca e Atlantikut të Veriut u shndërrua në faktorin më përcaktues të shembjes së murit të Berlinit dhe të çlirimit të mbi 400 milionë qytetarëve të Europës dhe Azisë Qendrore, që lëngonin nën shtypjen e egër të regjimeve totalitare. Por, në dallim nga mbarë



popujt e tjerë, për ne, flamuri i NATO-s, krahas flamurit kombëtar, është flamuri i shenjtë i shqiptarëve. Ky ishte flamuri, i cili 24 vite më parë, çliroi së bashku me flamurin kombëtar, 2 milionë shqiptarët që po përjetonin barbaritë, mizoritë më të egra në Kosovë. Me çlirimin e

Kosovës, flamuri i NATO-s është flamuri i dytë, krahas flamurit kombëtar, është flamuri i dinjitetit tonë, është flamuri që i bëri të lirë shqiptarët, u dha atyre të drejtën, mundësinë të këndojnë këngën e lirisë, të ndërtojnë të lirë të ardhmen e tyre, në trojet mijëvjeçare ku jetonin.

BIOTERRORIZMI: A DUHET TË SHQETËSOHEMI?



A mund të bëhet
modifikimi i gjeneve
mjeti i zgjedhur i
bioterroristëve?

Kemi folur për luftën në pothuaj të gjitha aspektet dhe elementët e saj, por lufta kimike është ajo që tashmë ka filluar të frikësojë njerëzit për të ardhmen. “Armë biologjike”, frazë që të shkakton të dridhura. Por çfarë janë ato? Si funksionojnë? Dhe a jemi vërtet në rrezik? Të njohura edhe si “lufta e mikrobeve”, armët biologjike përfshijnë përdorimin e toksinave ose agjentëve infektivë me origjinë biologjike. Kjo mund të përfshijë baktere, viruse ose kërpudha. Këta agjentë përdoren për të paaftësuar ose vrarë njerëzit, kafshët ose bimët si pjesë e një përpjekjeje lufte. Në fakt, lufta biologjike po përdor jetën jo-njerëzore për të prishur, ose për t'i dhënë fund jetës njerëzore. Për shkak se organizmat e gjallë mund të jenë të paparashikueshëm dhe tepër elastik, armët biologjike janë të vështira për t'u kontrolluar, potencialisht shkatërruese në një shkallë globale dhe të ndaluara globalisht sipas traktateve të shumta. Sigurisht, traktatet dhe ligjet ndërkombëtare janë një gjë, dhe aftësia e njerëzimit për të gjetur mënyra novatore për të vrarë njëri-tjetrin është një tjetër.

Fillimet e luftës biologjike

Historia e luftës biologjike është e gjatë dhe e vjetër, kështu që nuk ka nevojë për përbërës elektrikë, shkrije bërthamore ose titan të shkallës së raketave, ose mënyra të tjera të avancuara për t'u përhapur. Një shembull i hershëm na kthen mbrapa më shumë se 2 mijëvjeçarë e gjysmë, kur asirianët infektuan pusët e armikut të tyre me një kërpudhë ergotash thekre, e cila përmbante kimikate të lidhura me LSD. Konsumimi i ujit të ndotur prodhoi një gjendje mendore konfuze, halucinacione dhe, në disa raste, vdekje. Në vitet 1300, luftëtarët tartarë (mongolë) rrethuan qytetin Kaffa të Krimesë. Gjatë rrethimit, shumë tartarë vdiqën nga murtaja dhe trupat e tyre të pajetë dhe të infektuar u hodhën mbi muret e qytetit. Disa studiues besojnë se kjo taktikë mund të ketë qenë përgjegjëse për përhapjen e murtajës së Vdekjes së Zezë në Evropë. Nëse po, ky përdorim i hershëm i luftës biologjike shkaktoi vdekjen e rreth 25 milionë evropianëve. Ky është një shembull kryesor i shtrirjes së mundshme të luftës biologjike, paparashikueshmërisë dhe thjeshtësisë së tmerrshme.



Më tej, në vitin 1763, Ushtria Britanike u përpoq të përdorte linë si armë kundër amerikanëve vendas në Rrethimin e Fort Pitt. Në përpjekje për të përhapur sëmundjen te vendasit, britanikët dhuruan batanije nga një spital i lisë. Edhe pse tani e dimë se kjo do të ishte një mënyrë relativisht joefektive për të transmetuar linë, qëllimi ishte aty. Gjatë Luftës së Dytë Botërore, shumë nga palët e përfshira shikuan luftën biologjike me shumë interes. Aleatët ndërtuan objekte të afta për të prodhuar në masë spore antraksi, brucelozë dhe toksina të botulizmit. Fatmirësisht, lufta përfundoi para se ato të përdoreshin. Ishin japonezët ata që përdorën më shumë armët biologjike gjatë Luftës së Dytë Botërore, pasi midis sulmeve të tjera tmerrësisht pa dallim, Forcat Ajrore të Ushtrisë Japoneze hodhën bomba qeramike plot me pleshta që mbanin murtajën bubonike në Ningbo, Kinë. “Ushtria japoneze helmoi më shumë se 1000 puse uji në fshatrat kineze për të studiuar shpërthimet e kolerës dhe tifos. Disa nga epidemitë që ata shkaktuan vazhduan me vite dhe vazhduan të vrisnin më shumë se 30 000 njerëz në 1947, shumë kohë pasi japonezët ishin dorëzuar.”

-Dr. Friedrich Frischknecht, profesor i parazitologjisë integruese, Universiteti i Heidelberg, Gjermani.

Bioterrorizmi dhe shqetësimet moderne

“Bioterrorizmi i referohet lëshimit të qëllimshëm të agjentëve biologjikë ose toksinave me qëllim të dëmtimit ose vrasjes së njerëzve, kafshëve ose bimëve, me qëllimin për të frikësuar ose detyruar një qeveri ose popullatë civile për të çuar më tej objektivat politike ose sociale”, - thuhet në Udhëzuesin për para-planifikimin dhe reagimin e incidentit të INTERPOL-it për Bioterrorizmin. Qendrat për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve (CDC) e përkufizojnë Burimin e Besuar të Bioterrorizmit si “lëshim i qëllimshëm i viruseve, baktereve ose mikrobeve të tjera që mund të sëmurin ose vrasin njerëz, bagëti ose të mbjella”. Kjo mund të arrihet në një sërë mënyrash, si p.sh.: nëpërmjet spërkatjeve me aerosol, në mjete shpërthyes, nëpërmjet ushqimit ose ujit, ose absorbohet ose injektohet në lëkurë. Përdorimi i armëve të tilla ka një tërheqje të caktuar për terroristët; ato kanë potencialin të shkaktojnë dëm të madh, por ato janë gjithashtu mjaft të lira për

t'u prodhuar në krahasim me raketat ose pajisje të tjera të teknologjisë së lartë.

Gjithashtu, ato mund të “shpërthehen” dhe, për shkak të kohës së gjatë që u duhet për t'u përhapur dhe për të hyrë në fuqi, ka mjaft kohë që autori të shpëtojë pa u zbuluar.

Armët biologjike mund të jenë të vështira për t'u kontrolluar ose parashikuar në një situatë në fushëbetejë, pasi ekziston një rrezik thelbësor që trupat nga të dyja palët të preken. Megjithatë, nëse një terrorist është i interesuar të sulmojë një objektiv të largët si një operant i vetëm, bioterrorizmi mbart shumë më pak rrezik për personin.

Antraksi

Ekspertët besojnë se sot, organizmi më i mundshëm për t'u përdorur në një sulm bioterrorizmi do të ishte *Bacillus anthracis*, bakteri që shkakton antraksin. Gjendet gjerësisht në natyrë, prodhohet lehtësisht në laborator dhe mbijeton për një kohë të gjatë në mjedis. Gjithashtu, është i gjithanshëm dhe mund të lëshohet në pluhur, spërkatje, ujë ose ushqim.

Antraksi është përdorur edhe më parë. Në vitin 2001, sporet e antraksit u dërguan përmes sistemit postar të Shteteve të Bashkuara. Në total, 22 persona u infektuan me antraks, pesë prej të cilëve vdiqën. Fajtori nuk u kap kurrë.

Lija

Një tjetër agjent i mundshëm i bioterrorizmit është lija, e cila, ndryshe nga antraksi, mund të përhapet nga personi në person. Lija nuk është më një sëmundje shqetësuese në botën natyrore, sepse përpjekjet e bashkërenduara të vaksinimit e eliminuan atë, dhe rasti i fundit i përhapur natyrshëm ndodhi në vitin 1977.

Megjithatë, nëse dikush do të kishte akses në virusin e lisë (ai ruhet ende në dy laboratorë të Besuar, një në SHBA dhe një në Rusi), ai mund të jetë një armë efektive, që përhapet shpejt dhe lehtë midis njerëzve.

Murtaja

Ne kemi përmendur tashmë përdorimin e murtajës nga Tartarët, *Yersinia pestis*, qindra vjet më parë, por disa besojnë se ajo mund të përdoret edhe në botën moderne. *Y. pestis* transmetohet te njerëzit përmes pickimit të një pleshti që është ushqyer me brejtës të infektuar.



Pasi një njeri infektohet, sëmundja që rezulton ose mund të zhvillohet në murtajë bubonike, e cila është e vështirë për t'u transmetuar midis njerëzve dhe mjaft e lehtë për t'u trajtuar me antibiotikë, ose, nëse infeksioni përhapet në mushkëri, bëhet murtaja pneumonike, e cila zhvillohet me shpejtësi dhe nuk i

përgjigjet mirë antibiotikëve.

“Duke pasur parasysh praninë dhe disponueshmërinë e murtajës në mbarë botën, kapacitetin për prodhimin në masë dhe përhapjen e aerosolit, shkallën e lartë të vdekshmërisë së murtajës pneumonike dhe potencialin për përhapje të shpejtë dytësore, për-

dorimi i mundshëm i murtajes si armë biologjike është një shqetësim i madh”, - Dr. Stefan Riedel, Departamenti i Patologjisë, Qendra Mjekësore Universitare Baylor, Dallas, TX.

Kolera

Si një sëmundje gastrointestinale potencialisht e rëndë dhe ndonjëherë vdekjeprurëse, kolera ka potencialin të përdoret në bioterrorizëm. Nuk përhapet lehtë nga personi në person, kështu që, që të jetë efektiv, do të duhet të shtohet në mënyrë të lirshme në një burim të madh uji. Në të kaluarën, bakteret përgjegjëse për kolerën, *Vibrio cholerae*, janë përdorur nga SHBA, Japonia, Afrika e Jugut dhe Iraku.

Tularemia

Disa e konsiderojnë tulareminë, një infektion i shkaktuar nga bakteri *Francisella tularensis*, si një bio-armë të mundshme. Shkakton ethe, ulcera, ënjtje të gjëndrave limfatike dhe ndonjëherë edhe pneumoni.

Bakteri mund të shkaktojë infektion duke hyrë përmes çarjeve në lëkurë ose nëpërmjet frymëmarrjes në mushkëri. Ai është veçanërisht infektiv dhe vetëm një numër shumë i vogël organizmash (më pak se 10) duhet të hyjnë në trup për të shkaktuar një periudhë serioze të tularemisë.

I studiuar nga japonezët gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe i grumbulluar nga SHBA në vitet 1960, *F. tularensis* është i fortë, i aftë të përballojë temperaturat e ulëta në ujë, bar të thatë, trupa të pajetë të kalbur dhe tokë të lagësht për shumë javë. Sipas Qendrës “Johns Hopkins” për Përgatitjen e Shëndetit Publik, përhapja me aerosol e *F. tularensis* në një zonë të populluar pritet të rezultojë në fillimin e menjëhershëm të një numri të madh rastesh të sëmundjes akute, jo specifike, febrile, duke filluar nga 3 deri në 5 ditë më vonë, me zhvillimin e pleuropneumonitit në një pjesë të konsiderueshme të rasteve. Pa trajtim me antibiotikë, kursi klinik mund të përparojë në dështim të frymëmarrjes, tronditje dhe vdekje. Ata patogjenë janë një përzgjedhje e shkurtuar, natyrisht. Të tjera që konsiderohen të kenë potencial si armë biologjike përfshijnë brucelozën, ethet Q, linë e majmunëve, encefalitet arbovirale, ethet hemorragjike virale dhe enterotoksinën B stafilokokale.

Një e ardhme shqetësuese?

Megjithëse armët biologjike janë

të vjetra, teknologjia moderne sjell shqetësime të reja. Disa ekspertë janë të shqetësuar për përparimet e fundit në teknologjinë e modifikimit të gjeneve. Kur përdoren për mirë, mjetet më të fundit të teknologjisë mund të bëjnë mrekulli. Megjithatë, si me shumicën e teknologjive më të avancuara, ekziston gjithmonë mundësia për keqpërdorim. *Një teknologji e modifikimit të gjeneve, e quajtur CRISPR ka ndezur kambanat e alarmit në komunitetin e mbrojtjes; teknologjia i lejon studiuesit të modifikojnë gjenomet, duke modifikuar me lehtësi sekuenat e ADN-së për të ndryshuar funksionin e gjeneve. Në duart e duhura, ky mjet ka potencialin për të korrigjuar defektet gjenetike dhe për të trajtuar sëmundjet. Megjithatë, në duart e gabuara, ajo ka potencial për më të keqen.*

Teknologjia CRISPR po bëhet më e lirë për t'u përdorur dhe për këtë arsye më e aksesueshme për individët e prirur ndaj bioterrorizmit.

Në një raport të titulluar “Vlerësimi i Kërcënimeve Mbarë botërore të Komunitetit të Inteligjencës së SHBA-ve”, shkruar nga James Clapper, Drejtori i Inteligjencës Kombëtare, thuhet se modifikimi i gjeneve përmban një listë të përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë. “Duke pasur parasysh shpërndarjen e gjerë, koston e ulët



dhe ritmin e përshpejtuar të zhvillimit të kësaj teknologjie me përdorim të dyfishtë, keqpërdorimi i saj i qëllimshëm ose i paqëllimshëm mund të çojë në implikime të gjera ekonomike dhe të sigurisë kombëtare”, - shpjegon ai. “Përparimet në modifikimin e gjenomit në vitin 2015, - vazhdon ai, - kanë detyruar grupe biologjesh të profilit të lartë, amerikanë dhe evropianë, të vënë në dyshim modifikimin e parregulluar të brezit të njeriut (qelizat që janë të rëndësishme për riprodhimin), të cilat mund të krijojnë ndryshime gjenetike të trashëgueshme”.

Me gjeneratat e ardhshme të teknologjisë së ngjashme me CRISPR dhe një njohuri të avancuar të gjenetikës, nuk do të kishte fund teorik për mjerimin që mund të shkatohej. Ekziston mundësia për të krijuar lloje sëmundjesh rezistente ndaj ilaçeve, për shembull, ose insekte të mbrojtura nga pesticidet, të aftë për të zhdukur të korrat kryesore të një vendi.

Megjithatë, tani për tani, metodat e tjera të bioterrorizmit janë shumë më të lehta dhe më afër përdorimit, kështu që kjo ka të ngjarë të jetë shqetësim për të ardhmen e parashikueshme.

Pyetja kryesore është nëse kërcënim i përdorimit të armëve biologjike është real apo produkt i të menduarit të frikshëm për të ardhmen?

Ne po kalojmë në një kohë ku inovacioni është çelësi i mbijetesës. Por për sa i përket grupeve terroriste, ata jo vetëm që dëshirojnë të mbijetojnë, por përpiqen të lulëzojnë me risi dhe improvizim të vazhdueshëm. Në këtë situatë, të gjitha vendet duhet të bashkojnë duart për të luftuar kundër kërcënimeve të mundshme të bioterrorizmit.

Mbikëqyrja në kohë, trajnimi i duhur i personelit mjekësor, zhvillimi i metodave të reja të testimit të shpejtë, hetimi i barnave terapeutike, hetimi i nevojës për qendra spitalore të specializuara me personel të trajnuar posaçërisht për të trajtuar viktimat e sulmeve bioterroriste dhe një rrjet i fortë komunikimi mund ta përmirësojnë situatën.

Nga ana tjetër, shkencëtarët duhet të zbatojnë masat e nevojshme të sigurisë në punën e tyre.

Kërcënim i bioterrorizmit është tashmë një alarm i përhapur.



Konflikti në Ukrainë, në një fazë të re dhe më të ndërlikuar të luftës

Kolonel **HYSNI GJERGJI**
Instituti Kërkimor
Shkencor Ushtarak



365 ditët e luftës së nisur nga Rusia në Ukrainë i kanë marrë jetën mijëra njerëzve dhe i ka kushtuar ekonomisë botërore rreth 3 trilionë dollarë, sipas VOA-s. Shumë politikë-bërës perëndimorë gabuan, pasi besuan para një viti tek “Putini Racional”, pasi argumentonin se pas më shumë se 20 vjetësh në

pushtet, lideri rus ishte bërë i njohur për sjelljet dhe taktikat e tij racionale dhe të zgjuara.

Të tjerë analistë që atëherë besonin tek “Vladimiri i Çmendur”, u nisën nga fakti i botimit të eseve, fjalimeve dhe retorikave me frymë nacionaliste, që presidenti Putin kishte publikuar gjatë vitit 2021. Një vit më parë, duke analizuar zhvillimet para agresionit rus,

unë, si dhe shumë analistë ushtarakë, u përpoqëm të parashikonim nëse do kishte sulm konvencional apo jo. Çështja shtrohej nëse do fitonte një "Putin Racional" apo një "Vladimir i Çmendur". "A do të ishte Putin lider i luftës apo strateg i paqes?", - shkruante, në janar 2022, për "Financial Times", Gideon Rachman. Luftërat lokale në Gjeorgji dhe pushtimi i Krimesë tregonin se "Vladimiri i Çmendur" do të kërkonte të rriste lavdinë e tij në 70-vjetorin e lindjes. Por ajo çfarë i bashkonte shumicën e analistëve, ishte përfundimi se Putin nuk do të sulmonte ushtarakisht një shtet sovran, aq më tepër në luftë konvencionale. Ky rezultoi një bast i humbur i inteligjencës europiane por jo i asaj amerikane dhe britanike, të cilët paralajmëruan saktësisht çfarë po ndodh sot.

Për të mos u përsëritur luftërat, nëse nuk parandalohen, të paktën duhet të lexohen mirë. Rusia përkufizohej nga Churchill si një "gjë e gjëzë e mbështjellë në një mister, brenda një enigme". Bazuar në nivelin e përdorimit aktual të dezinformacionit dhe luftës hibride, përshkrimi i Federatës Ruse sot do të ishte: "falsifikim i mbështjellë me një mashtrim brenda një gënjeshtre".

Në luftërat dhe konfliktet e mëparshme të armatosura, është e vërtetuar që udhëheqësit, në sisteme autokratike dhe diktatoriale, nuk duan të dëgjojnë të vërtetat e hidhura, por gënjeshttrat e "sheqerosura". Informacionet e dërguara nga shërbimet inteligjente ruse SVR dhe GRU para agresionit, nuk ishin aspak të bazuara në realitetin në terren, por të hartuara në mënyrën më të bukur të gënjeshtërt. Sipas informacioneve të dërguara nga agjencitë e zbulimit për presidentin Putin para 24 shkurtit 2022, "trupat ruse do të priteshin pa rezistencë dhe si shpëtimtarë". E kundërta u vërtetua në këtë një vit luftë dhe këto informacione madje u kthyen në një nga shkaktarët e disfatës. Kjo tezë e Putin u vërtetua nga shkarkimet dhe arrestimet në radhët e shërbimeve të inteligjencës ruse SVR, FSB dhe GRU. Planifikimi dhe ekzekutimi i operacionit special rus për pushtimin e Ukrainës, tregoi se personat përgjegjës për përgatitjen dhe planifikimin e strategjisë së pushtimit nuk e kanë

pasur informacionin e duhur për kundërpërgjigjen ukrainase. Të gjithë drejtuesit e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura ruse, besuan se nuk ishte i nevojshëm përdorimi i një force të madhe ushtarake, sepse ata nënvleftësuan mbi të gjitha gatishmërinë dhe shpirtin e ukrainasve për të luftuar për atdheun e tyre.

Pasi agresioni filloi, pritej që inteligjenca ushtarake ruse të ishte "maja e shpatës" në këtë luftë të Putinit, por zbulimi strategjik rus rezultoi të ishte thjesht "polici politike", tipike e një sistemi totalitar. Reagimi i menjëhershëm, i organizuar, profesional dhe intensiv i rezistencës nga të gjithë njësitë e ushtrisë, gardës kombëtare, legjioneve të huaja dhe të inteligjencës së Ukrainës, shfaqti qartazi dështimin e informacioneve dhe analizën e bërë nga agjencitë e inteligjencës ruse, të cilat deri në momentin e pushtimit kishin një rrjet shumë të madh të fuqishëm informatorësh dhe bashkëpunëtorësh në territorin e Ukrainës. Ukraina sot, më 24 shkurt 2023, është transformuar në "varrin rus" dhe një "skenë makabre krimi", por nga ana tjetër edhe një "Leksion Sigurie Ndërkombëtare", që po i tregon botës se si duhet të sillen në të ardhmen NATO dhe shtetet demokratike, me autokratët dhe diktatorët.

Brutaliteti i këtij agresioni që shënon mijëra viktima civile, miliona të zhvendosur, fshatra dhe qytete të shkatërruar, e kanë vënë Rusinë nën hetim nga GJNDNJ për krime lufte, apo edhe gjenocid. Gjatë këtij viti luftë, është përdorur si rrallë më parë arsenali rus i luftës hibride dhe jo lineare në fushën diplomatike, politike, ekonomike dhe mediatike, të përshkruara në doktrinën Gerasimov. Arsenali rus i spiunazhit, sabotazhit dhe subversionit (3S) vazhdon të përdoret masivisht, jo vetëm në Ukrainë, por ka shpërndarë me qëllim "tentakulat" në të gjithë Europën. Gjatë këtij viti, me qindra oficerë zbulimi rusë, të maskuar nën petkun e diplomatit, janë kapur, arrestuar, apo janë dëbuar si "non grata" në Europë. Shqipëria dhe Kosova në fillim të agresionit, janë deklaruar në listën e vendeve armiqësore të shpallura nga Rusia, si përkrahës të

Ukrainës. Lehtësirat e shoqërive të hapura demokratike, kanë bërë të mundur që kudo të ketë një fluks të shtetasve rusë, midis të cilëve është i lehtë depërtimi i operativëve të inteligjencës ruse.

Rusia para një viti, kishte krijuar një imazh të statusit të fuqisë, ekonomike dhe ushtarake, por që faktikisht po shkërmoqet me shpejtësi në Ukrainë. Armatosja e Ruisë është pranuar tashmë, që është bërë e mundur edhe si "kontribut" i tregtisë së saj me perëndimin. Me anë të parave të fituara në Europë, nga drithërat, gazi dhe nafta, Moska arrinte të plotësonte deri 25% të nevojave të Europës. Vartësia e BE-së nga gazi dhe drithërat ruse, i kishte dhënë Moskës dy armë të fuqishme; paratë për të blerë dhe prodhuar armët vrasëse, si dhe vartësinë ushqimore të Europës nga Moska. Ky realitet i planifikuar dhe i krijuar me kujdes në vite, e bëri Putinin të ndjehet i sigurt në gjuhëzimin e perëndimit, dhe me ironi ai të deklaronte në tetor 2022, se "Europa do të ngrijë si bishti i ujkut këtë dimër". Kjo strategji e Putinit nuk funksionoi dhe u zhvlerësua pa mbushur një vit. Europa e bashkuar dhe solidarizuar, tashmë ka krijuar burime alternative për energji dhe drithëra, ndërsa Gjermania, e cila deri në vitin 2022 kishte vartësi nga gazi rus deri në 60%, në janar 2023 është zero.

Mësim i nxjerrë nga lufta një vjeçare, pohohet të jetë vlerësimi jo sa duhet i rëndësisë së moralit të trupave, etikës, paaftësisë, trajnimit të dobët, niveleve të ulët arsimore, korrupsionit, raportimeve të falsifikuara, faktorëve ndëretnikë si dhe marrëdhënieve oficer-ushtar brenda ushtrisë ruse. Ndryshimi i Komandantit të Përgjithshëm të "operacionit special", më 10 prill 2022, duke emëruar gjeneralin Aleksandër Dvornikov, të njohur për krime dhe brutalitet në Siri dhe Çeçeni, ndërsa më 10 shkurt 2023, vetë SHSHP Valery Gerasimov si komandant operacioni, e pranon "de facto" fillimin e dështimit të luftës së Putinit, në drejtim të lidershipit. Humbjet në njerëz nga

ana e pushtuesit rus, duke mos u besuar palëve në luftim, i tejkalojnë humbjet e çdo konflikti të armatosur dhe lufte të zhvilluar deri tani në njësinë e kohës. Nga një ushtri e mbuluar me lavdi dhe krenari, si pasardhëse e “ushtrisë së kuqe”, ushtria e federatës ruse po e mbështet suksesin e saj tek mercenarët dhe të burgosurit, vrasës serial me pagesë.

Wagner vazhdon të rekrutojë të burgosur dhe ish-ushtarakë të shka-tërruar ekonomikisht, nga zonat rurale ruse madje edhe në Serbi, sipas sloganit “Ftesë për një piknik në Ukrainë”.

Si rezultat i rezistencës ukrainase dhe mbështetjes perë-ndimore, këto mercenarë po shkojnë drejt ferrit, sepse sipas raportimeve të mediave perëndimore janë vrrarë nga ky grup rreth 30 000 vetë.

Mercenarët Wagner janë të duhurit për të kryer operacione “False flag”, që fshehin krimet e forcave të rregullta ushtarake, për shkak të statusit të tyre “pa atdhe”. Duke folur, më 18 shkurt, në Konferencën e Sigurisë në Mynih, Sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken tha se ekspertët kanë llogaritur se rreth 200 000 trupa ruse janë vrrarë ose plagosur.

Ushtria ukrainase është shndërruar sot në ushtrinë me përvojën më të madhe në drejtim të operacioneve dhe përvojës luftarake. Ajo përdori me mjeshtri fuqinë “smart”, ku forcat u shpërndanë në grupe goditëse, me dronë dhe raketat “javelin”, “startreak” dhe “stinger”. Përzgjidhen objektivat me kujdes si: gjeneralët, vendkomandat, lëshuesit e raketave, cisternat e karburantit. Në këtë mënyrë paralizohen lëvizjet, përhapet panik dhe frikë mes ushtarëve rusë që dezertojnë çdo ditë. Të suksesshme kanë qenë operacionet “smart snajper” të forcave speciale ukrainase, të cilët arritën të eliminojnë disa gjeneralë dhe kolonelë rusë në pozita kyçe të trupave pushtuese ruse. Më 2 maj 2022 plagoset në Ukrainë SHSHP të Rusisë, Valery Gerasimov, që shënoi kulmin e këtyre operacioneve “smart”. Operacioni “smart” në det shënoi kulmin e suksesit, me mbyjtjen e kryqëzorit “Moskva”, me datë 14 prill, në Detin e Zi. Ukraina vlerësohet se po aplikon një aktivitet “special” dhe “smart” nëpërmjet shërbimit të saj të

inteligjencës (SBU), i cili zbuloi dhe ekzekutoi për tradhti të lartë, si agjent rus negociatorin e saj në bisedime me Rusinë, Denis Kireev. SBU rezultoi të ketë kapur shumë robër rusë si dhe politikanin pro rus të arratisur, Victor Medvedchuk, si dhe informacione të klasifikuara dhe të dobishme për planet e ushtrisë ruse në Ukrainë. Janë kapur dhe ekzekutuar disa agjentë të dyfishtë të Moskës në Kiev përfshirë këtu zëvendës drejtorin e SBU-së.

Krahas luftës me armë të rënda, artileri, avionë dhe tanke, Putin nuk ka ndalur, madje ka intensifikuar gjatë këtij viti luftën hibride kudo nëpër në Europë. Qëllimi ka qenë i shpallur qartë: Të investojë para, që të zgjedhë liderë pro rusë në krye të qeverive të

të liderëve botërorë dhe evropianë. “Lufta ka të keqe vetëm të vdekurit, pasi të tjerat janë para”, - thuhet në teorinë e luftërave dhe konflikteve. Kostoja e luftës, deri në mes të muajit shkurt 2023, për presidentin Putin, ka kaluar 90 miliardë dollarët.

Putin nuk është ndalur vetëm në blerjen dhe krijimin e elitave pro ruse në Lindje, por edhe liderëve perëndimorë.

Shtypi publikoi në prill 2022 se, ish-kancelari gjerman Gerhard Schröder; ish-kryeministri i Francës Francios Fillon, ish-kryeministri i Italisë Matteo Renzi, ish-ministria e Jashtme e Austrisë Karin Kneissi; ish-kancelari i Austrisë Christian Kern si dhe ish-kryeministri i Finlandës Esko



vendeve të ish-traktatit të Varshavës dhe Europës lindore, pasi kështu do rezultonte më lirë, më mirë, më shpejt dhe në mënyrë paqësore hegjemonia neo-sovjetike e tij në Europë. Fitoret e fundit të Orban në Hungari dhe Vuçiq në Serbi konsiderohen nga analistët e gjeopolitikës si “fitore të vogla” të Putinit, sikurse rizgjedhja e Makron në Francë, quhet “humbje e vogël” e tij. Politika e parasë dhe e korporatave ka qenë dhe besohet se do të vazhdojë edhe për disa kohë të përdoret nga Moska. Putini kishte punuar me kohë për të “blerë” mbështetjen politike

Aho, rezultuan të ishin në borderotë e kompanive ruse të gazit. “Këmbëngulja ime për ‘Nord Stream 2’ ishte një gabim i qartë. I hidhur është gjithashtu edhe fakti se ne dështuam në krijimin e një shtëpie të përbashkët evropiane, në të cilën përfshihet edhe Rusia. Dështuam me përpjekjen për të përfshirë Rusinë në një arkitekturë të përbashkët sigurie”, - deklaroi në fillim të agresionit, presidenti gjerman Frank Walter Stienmeier.

Leksioni “i përgjakur” i Ukrainës duhet të lexohet për të mos përgjakur në të ardhmen Ballkanin dhe veçanërisht

Kosovën. Studimi i këtij leksioni strategjike na tregon se çdo vonesë e anëtarësimit të Kosovës në NATO, si dhe Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut në BE, është në interesin “neo-sovjetik” dhe çdo minutë kohë e humbur, punon për Moskën. Nëse perëndimi do ta kishte pranuar në NATO, Gjeorgjinë dhe Ukrainën, besohet se Moska nuk do të guxonte të prekte Nenin 5 të aleancës. Nxitimi i Putinit për të filluar sulmin ushtarak para hapave të ngadalta të anëtarësimit në NATO të Kievit, e vërtetoi këtë gjë.

Në prag të 1-vjetorit të agresionit, vlerësojmë dështimet e njëpasnjëshme në drejtim të liderimit të ushtrisë ruse. Shumë pak njerëz në zinxhirin komandues të Kremlinit dhe

jekteve luftarake ruse: tanke, artileri, mbrojtje ajrore, autokolona, vendkomanda etj. “Starlink” ka rezultuar jashtëzakonisht i aftë për të përballuar sfidat dinamike të fushës së betejës. Përditësimet e reja të softuerit janë kryer me shpejtësi, duke u përdorur gjithashtu edhe nga Presidenti Zelensky për komunikime strategjike. NATO doli më e fortë dhe më e unifikuar gjatë kësaj lufte, jashtë pritshmërive të Moskës, e cila synoi çdo ditë të vitit të përçajë aleancën. Në prag të njëvjetorit, presidenti i SHBA-ve, gjatë vizitës së tij në Ukrainë dhe Poloni takon krerët e “9-shes së Bukureshtit”. Ky është një grup vendesh të kahut më lindor të aleancës së NATO-s, që u formua



të ushtrisë ruse kishin dijeni për fillimin e ‘Operacionit Ushtarak Special’ në Ukrainë. Presidenti Vladimir Putin, më datën 11 janar të vitit 2023, emëroi si komandant të përgjithshëm të luftës në Ukrainë, shefin e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneral Valeri Gerasimov.

Terminalet “Starlink”, ishin një risi teknologjike, e cila i ka ofruar nivele cilësore për komunikime të qëndrueshme të mundësuar nga një konfigurim satelitor, i ofruar nga Elon Musk. Kjo teknologji i ka bërë shumë efektive sulmet me dronë kundër ob-

në kundërpërgjigje të aneksimit të gadishullit të Krimesë nga Rusia, në 2014-n.

Aleanca përfshin Bullgarinë, Republikën Çeke, Estoninë, Hungarinë, Letoninë, Lituaninë, Poloninë, Rumaninë dhe Sllovakinë. Intensiteti i luftimeve gjatë këtij konflikti 12-mujor, nxori në pah nevojën e sigurimit të rezervave të mëdha strategjike në arsenalin e ushtrive të vendeve të NATO-s. Ky pushtim ka krijuar një mbështetje të madhe ekonomike, financiare dhe asistencë ushtarakë në një masë që po i kalon 100 miliardë dollarët.

Për këtë mbështetje presidenti Josef Biden, por edhe presidenti francez Macron, ka deklaruar se kjo mbështetje do të vazhdojë deri në mposhtjen e Federatës Ruse, por jo në shkatërrimin e saj. Shkatërrimi i Rusisë do të çonte në daljen e saj jashtë kontrollit, duke e bërë të pamënaxhueshme në aspektin e sigurisë globale.

Mësimet e nxjerra nga ushtria e Ukrainës gjatë konfliktit kundër ushtrisë ruse, duhet të shërbejnë si objekt studimi dhe të jenë pjesë e programeve të stërvitjes në ushtritë të NATO-s, duke rritur në këtë mënyrë kapacitetet e tyre në një përballje në të ardhmen me ushtrinë ruse. Ushtria e Ukrainës në ditët e sotme është ushtria më me eksperiencë luftimi në Europë që meriton absolutisht anëtarësim në NATO. Ajo është e aftë të planëzojë, ekzekutojë operacione të shkallës së gjerë, të përdorë sistemet ushtarakë dhe teknologjitë më të avancuara të perëndimit në fushëbetje, duke i shërbyer edhe ushtrive të shteteve të tjera të aleancës perëndimore.

Aktualisht, vetëm sulmi bërthamor është akoma në tavolinë për diskutim, pas tërheqjes nga START.

Më 11 shkurt 2023, Putin deklaroi për mospjesëmarrje në takimin për kontrollin dhe kufizimin e armëve bërthamore, START.

Aktualisht Moskë, pas një viti luftë, rrezikon të bëhet “non grata” e botës së civilizuar, duke kërcënuar edhe me përdorimin bombës bërthamore, pasi nuk i ka mbetur asnjë armë tjetër në dorë, e pa përdorur në këtë agresion.

Takimi në Moskë me ministrin e Jashtëm kinez, më 23 shkurt, duke deklaruar se perëndimi është fajtor që synon të asgjësojë fuqinë strategjike të Rusisë, dha një mesazh tjetër të orientimit të Rusisë në të ardhmen dhe konfigurimin e ri të këshillit të sigurimit të OKB-së. Krijimi dhe forcimi i një aleance anti-perëndim midis Federatës Ruse, Republikës Popullore të Kinës, Iranit dhe Koresë së Veriut përbën në të ardhmen një kërcënim të madh për demokracitë në botë. Këto lëvizje e bëjnë luftën në Ukrainë, më të ndërlikuar dhe të vështirë për t’u parashikuar paqja e shumëpritur.



Presidenti Bajram Begaj, vizitë në selinë e NATO-s

“Plani Evropian është një hap pozitiv dhe Shqipëria e mbështet rrugëtimin e Kosovës për anëtarësim në organizata ndërkombëtare, duke përfshirë aleancën e NATO-s, zgjerimi i së cilës, është me rëndësi të madhe në këto kohë sfidash.”

Në Konferencën e përbashkët për shtyp, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg theksoi se: “Është e mrekullueshme të kesh një President të Shqipërisë që e njeh NATO-n aq mirë sa ju, sepse ju keni qenë shefi i Shtabit të Përgjithshëm, dhe ne të gjithë e dimë se ju e njihni këtë Aleancë në shumë e shumë mënyra të ndryshme dhe kjo është një forcë për të gjithë ne dhe për të gjithë organizatën”.

Stoltenberg tha se Shqipëria është një aleat e çmuar me një histori të gjatë në rritje për të mbështetur aleatët dhe partnerët e NATO-s. “Ju kontribuoni në forcat shumëkombëshe të NATO-s në Letoni dhe Bullgari, duke ndihmuar në parandalimin e çdo agresioni. Forcat tu-

aja shërbejnë në misionin paqeruajtës të NATO-s në Kosovë dhe në misionin tonë për ndërtimin e kapaciteteve në Irak. Muajin e kaluar vendi juaj iu përgjigj me shpejtësi tërmetit shkatërrues në Turqi me dërgimin e personelit mjekësor dhe të kërkim-shpëtimit”.

Shefi i NATO-s tha se Shqipëria gjithashtu luan një rol kyç në promovimin e stabilitetit dhe bashkëpunimit në të gjithë Ballkanin Perëndimor, që është një rajon me rëndësi strategjike për NATO-n. “Unë mirëpres gjithashtu rolin tuaj aktiv në promovimin e politikës së dyerve të hapura të NATO-s dhe përgëzoj Shqipërinë që ratifikoi kaq shpejt Protokollet e Anëtarësimit për Finlandën dhe Suedinë. Kjo tregon se dera e NATO-s mbetet e hapur dhe se ne mbrojmë të drejtën e çdo kombi për të zgjedhur rrugën e tij”, - tha ai. “Të gjitha këto kontribute tregojnë përkushtimin e fortë të Shqipërisë ndaj Aleancës sonë dhe NATO është e përkushtuar ndaj Shqipërisë. Aleatët qëndruan me ju pas sulmeve kibernetike vitin e kaluar dhe ekspertët e NATO-s dhanë mbështetje urgjente”. Stoltenberg theksoi investimin në bazën Ajrore të Kuçovës, e cila do të rrisë sigurinë e hapësirës ajrore shqiptare.

Roli i NATO-s në dialogun Kosovë-Serbi

Duke folur për rolin e NATO-s në Kosovë, Sekretari i Përgjithshëm theksoi që NATO ka qenë e pranishme në Kosovë për shumë vite dhe falënderoi gjithashtu Shqipërinë për kontributin e saj në praninë e NATO-s atje. “Prania e KFOR-it, forca e NATO-s, ka luajtur dhe vazhdon të luajë një rol të rëndësishëm në promovimin e stabilitetit dhe paqes dhe sigurimin e lirisë së lëvizjes për të



gjitha grupet në Kosovë dhe aleatët janë të përkushtuar të vazhdojnë të kontribuojnë dhe të sigurojnë praninë e vazhdueshme të KFOR-it në Kosovë, që do të thotë se kjo është një prani e konsiderueshme e NATO-s që është dëshmuar jashtëzakonisht e rëndësishme për shumë vite”.

NATO punon krah për krah me BE-në në Kosovë dhe prania e trupave të KFOR-it mbështet përpjekjet diplomatike të Bashkimit Evropian. “Mirëpres bisedimet e fundit që u mbajtën këtu në Bruksel, si pjesë e dialogut të lehtësuar nga BE-ja ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit dhe NATO do të vazhdojë të mbështesë plotësisht dialogun ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit lehtësuar nga BE, sepse ne besojmë se kjo është e vetmja rrugë e qëndrueshme përpara drejt zgjidhjes dhe stabilitetit në Kosovë”, - tha

ai. “Kjo është një mundësi historike për paqe të qëndrueshme, nga e cila mund të përfitojë i gjithë rajoni. Prandaj, mirëpres qasjen konstruktive. Është e rëndësishme që të gjitha palët tani të tregojnë fleksibilitet dhe gatishmëri për kompromis dhe në fakt po tregojnë një vullnet të vërtetë, për të gjetur një mënyrë, për të gjetur zgjidhje të qëndrueshme”. Ai theksoi se çdo zgjidhje, duhet të marrë parasysh në respektimin e plotë të të drejtave të njeriut, vlerave demokratike dhe shtetit të së drejtës, reformat e brendshme dhe marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë. Nga ana e tij Presidenti i Shqipërisë, Bajram Begaj tha se Plani Evropian është një hap pozitiv dhe se Shqipëria mbështet rrugëtimin e Kosovës për anëtarësim në organizata ndërkombëtare, duke përfshirë aleancën e NATO-s, zgjerimi i së cilës, sipas tij, është shumë me rëndësi në këto kohë sfidash. “Plani Evropian për normalizimin e marrëdhënieve është një hap pozitiv që duhet të qëndrozohet në njohjen reciproke ndërmjet dy shteteve. Vlerësoj maksimalisht angazhimin dhe përkushtimin e NATO-s në rajon dhe misionin e KFOR-it si një histori suksesi. Jemi duke kaluar kohë sfidash të mëdha të cilat kërkojnë vendime të guximshme dhe të drejta. Në këtë kontekst është në bindjen time se është më se e justifikueshme për të konsideruar anëtarësimin e Kosovës në aleancën euroatlantike”, - tha zoti Begaj.

“Përfundimi i procesit të anëtarësim-it është një prioritet kryesor për NATO-n dhe për mua, dhe ne po bëjmë përparim”, - tha Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s për gazetaret në konferencën e përbashkët me presidentin shqiptar Begaj.



Kryetari i Komitetit Ushtarak të NATO-s thekson kontributin e Shqipërisë në Aleancë

Kryetari i Komitetit Ushtarak të NATO-s, Admirali Rob Bauer vizitoi Shqipërinë (6 deri më 8 shkurt 2023), me ftesë të shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Shqipërisë, gjeneral brigade Arben Kingji. Kryetari i Komitetit Ushtarak të NATO-s u takua me Presidentin Shqiptar, SH.T z. Bajram Begaj, Kryeministrin e Shqipërisë, Z. Edi Rama, Ministren e Shqipërisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, znj. Olta Xhaçka dhe ministrin shqiptar të Mbrojtjes, z. Niko Peleshi. Diskutimet u fokusuan në sigurinë euroatlantike dhe kontributet e Shqipërisë në Aleancë. Admirali Bauer iu drejtua edhe Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë së Forcave të Armatosura të Shqipërisë dhe vizitoi Regjimentin e Operacioneve Speciale Shqiptare. Gjatë takimit me Presidentin shqiptar, z. Bajram Begaj, Admirali Bauer përgëzoi Shqipërinë për kontributin e saj në sigurinë aleate. “Shqipëria jep një kontribut jetik në NATO. Jo vetëm që Forcat e Armatosura Shqiptare marrin pjesë në misionin paqeruajtës të NATO-s, KFOR në Kosovë, dhe në misionin e NATO-s në Irak, Shqipëria gjithashtu kontribuon me trupa në grupet e betejës shumëkombëshe në Letoni dhe Bullgari. Ky është një komponent i rëndësishëm i qëndrimit parandalues dhe mbrojtës të NATO-s në pjesën lindore të territorit të Aleancës”, - theksoi Bauer. Në diskutimet e tij me min-

istrin e Mbrojtjes z. Niko Peleshi, Admirali Bauer theksoi mbështetjen e Shqipërisë për Ukrainën dhe vuri në dukje mjedisin aktual të sigurisë në Ballkanin Perëndimor. Në ditën e dytë të vizitës, Admirali Bauer u takua me kryeministrin shqiptar, z. Edi Rama dhe ministrin shqiptar për Evropën dhe Punët e Jashtme, zonjën Olta Xhaçka. Diskutimet u fokusuan në rëndësinë e qëndrueshmërisë kibernetike dhe angazhimin e Shqipërisë në Ballkanin Perëndimor. Kryetari nënvizoi rolin pozitiv që Shqipëria po luan për të promovuar paqen dhe stabilitetin në rajon. “Vlerësoj angazhimin e Shqipërisë për të promovuar stabilitetin dhe bashkëpunimin në të gjithë Ballkanin Perëndimor. Kontributet e Shqipërisë në NATO forcojnë jo vetëm sigurinë rajonale, por edhe atë evropiane”, - shtoi ai.

Kryetari Bauer vizitoi gjithashtu Regjimentin e Operacioneve Speciale në Zall-Herr, ku vëzhgoi drejtpërdrejt një demonstrim të Forcave të Operacioneve Speciale Shqiptare. “Më bëri përshtypje shfaqja e bërë sot nga bashkimi më elitari i Shqipërisë, ata demonstruan unitetin e qartë të qëllimit, profesionalizmin dhe përbushën pritshmëritë në përputhje me reputacionin e tyre ndërkombëtar”, - nënvizoi Admirali Bauer për zëvendëskomandantin e Forcave Tokësore.

Në ditën e fundit të vizitës, Admirali Bauer iu drejtua anëtarëve të kurseve të nivelit të lartë në Kolegjin e Mbrojtjes



dhe Sigurisë së Forcave të Armatosura Shqiptare, në Tiranë. Në fjalën e tij, Admirali theksoi rëndësinë e të qenit i përgatitur dhe i gatshëm për t'u përshtatur dhe për të pritur të papriturën. Admirali Bauer: “Trupat shqiptare ndihmojnë për të mbajtur Aleancën tonë të sigurt. Këta ‘bija dhe bija shqiptonjash’ e ndihmojnë Aleancën të ngrihet lart. Ata janë të gatshëm t'i vënë të gjitha në linjë për të mbështetur rendin e bazuar në rregulla ndërkombëtare, për të promovuar demokracinë dhe për të krijuar siguri dhe stabilitet për vendin e tyre. Shqipëria është një aleat e vlerësuar. Në këtë epokë të re të mbrojtjes kolektive, ne jemi më të fortë së bashku.” Gjeneral brigade Kingji falënderoi Kryetarin Bauer për njohjen e kontributeve të Forcave



të Armatosura shqiptare në sigurinë euroatlantike dhe ripohoi angazhimin e Shqipërisë ndaj Aleancës. “Ne jemi krenarë që shërbejmë sot me dinjitet në vijën e parë të Aleancës. Në këto kohë të vështira, kur rrezikohet siguria jonë, ne jemi të rreshtuar përkrah aleatëve tanë nga Veriu i Evropës, në Letoni dhe në Bullgari dhe rajonin tonë, në Kosovë. Forcat tona të Armatosura do të ruajnë angazhimin dhe përkushtimin maksimal për të përmbushur me dinjitet çdo detyrim ushtarak të vendit ndaj Aleancës. Ne mbetemi gjithmonë të besueshëm me aleatët tanë të NATO-s, dhe admirali Bauer e ripohoi këtë. Ky është një inkurajim për ne dhe ne e vlerësojmë shumë”, - tha shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura Shqiptare.



UNIFORMA USHTARAKE, kjo përfaqësi historike në kohë lufte dhe paqe



Figura e Ali Pashës Tepelenës, e trajtuar si një figurë me impakt të fuqishëm, në gjallje të tij u pa si një ‘despot oriental’ nga turistët europianë apo dhe studiues historikë. I ndikuar nga influenca e rrymës së Filo-Helenizmit që mbizotëronte në atë kohë por dhe në kundërshtim me çfarë shprehte popullsia greke, ai konsiderohej si dhunues dhe shtypës i asaj që kishte mbetur nga Greqia e Lashtë. Gjatë shekujve të mëparshëm popullsia shqiptare në përgjithësi kishte qenë një element force. ndaj të gjitha Fuqitë e Mëdha që Ali Pasha hyri në marrëdhënie diplomatike u përpoqën ta përdornin në kundërshtitë që kishin me njëra-tjetrën në rajon, por kurrë nuk i dhanë mbështetjen e duhur diplomatike, për të shpallur pavarësinë. Veshja e ushtarit shqiptar të kohës së Ali Pashës Tepelenës ishte një kombinim midis petkave të lehta dhe fustanellës, e cila u mbajt edhe në uniformën e Regjimentit ‘Gjuajtësit e Orientit’, të formuar në ishujt Jonianë më 1807.



‘Gjuajtësit e Orientit’ ishte një regjiment i formuar kryesisht nga suljotët dhe nga shqiptarët e tjerë nga kontinenti, që ofronin shërbimin tradicional të mercenarit por edhe kishin braktisur vendet e tyre si rezultat i armiqësisë që kishin pasur me pushtetin e centralizuar të Ali Pashës Tepelenës.

Fustanella shqiptare, e cila duke qenë më shumë e pëlqyer mes popullsisë të Ballkanit u imitua më shumë nga popujt e tjerë më të largët. Me këtë veshje disa udhëtarë të huaj në XVIII-XIX vërejnë se ishin të veshur truporjat e oborreve princërore të Moldavisë, të Vllahisë në Bukuresht. Gjithashtu Major William Martin Leak, përfaqësues i Anglisë në Janinë, që kishte pasur mundësinë para Bajronit t’i vizitonte këto zona, kishte shkruar që në vitin 1805: “Veshja shqiptare po bëhet përditë e më e zakonshme, si në More edhe në pjesët e tjera të Greqisë, në këtë të fundit për shkak edhe të rritjes së madhe të fuqisë shqiptare. Kjo veshje është më e lehtë dhe më e volitshme se ajo turke ose greke”.

Të gjitha këto dëshmi hedhin dritë mbi influencën dhe “ekspansionin” etnografik, nëse mund ta quajmë kështu, të shqiptarëve, që duke qenë elita ushtarake e Pashallëkut të Janinës, përveç zakoneve dhe mjeshtërive të tyre të luftimit, u kishin imponuar nga ana estetike dhe veshjen e tyre kombëtare popullsisë të tjera në Ballkan.

Ndikimet dhe fryma kombëtare në uniformat e Ushtrisë Shqiptare

Qeveria e Përkohshme e Vlorës dhe veprimtaria e saj, më 28 nëntor 1912-1922, lëshoi udhëzime për të mbajtur në përdorim veshjen e ish-xhandarmërisë apo të ushtrisë turke. Për t’u dalluar që ishin në shërbim të Qeverisë Shqiptare, këtyre veshjeve iu qepën sipër jakave shiriti kuqezi, kurse në kapele (qeleshe) një shqiponjë të zezë. Në pamundësi të tyre u udhëzua që në krah të vendosej një shirit kuqezi që përfaqësonte simbolin kombëtar shqiptar.

Më 1913 qeveria mori masa të vishte me uniformë, atë të përshtatshmen dalluesen e xhandarmërisë së sapoformuar.

Veshja me të cilën u pajis xhandarmëria shqiptare, për arsye të shpjegueshme për atë kohë si dhe për faktin se nuk ishin ideuar apo qepur në Shqipëri, nuk kishte veçori apo karakteristika kombëtare, në prerje apo në qepje.

Ajo ishte uniformë ushtarake italiane me ngjyra gri-jeshile, kapela (kësula ushtarake) ishte pa strehë, gradat ishin vendosur në pjesën e përparme të jakës së xhaketës, për oficerët me yje, ndërsa për nënoficerët dhe tetarët me shiriti mëndafshi me ngjyrë të verdhë.

Për t’i dhënë kësaj uniforme një karakter dallues kombëtar jaja ishte punuar me copë kuqezi.





Imitimi i sllavëve dhe sovjetikëve

Kohët që pasuan sollën veshje, të cilat ishin një përshtatje e atyre të “aleatëve” apo “padronëve të radhës”, duke ia nisur që nga Italia e deri tek Kina. Fotot që po botoj, e ilustronjë më mirë këtë pretendim, ndërsa sheh për shembull, ish-ushtarakë shqiptarë në dy kohë të ndryshme, si ajo e Zogut dhe ajo e monizmit, në dekadën e “miqësisë së pathyeshme” me ish-Bashkimin Sovjetik, ku fare lehtësisht mund të besosh se sheh anëtarë të Ushtrisë së Kuqe, e jo të asaj shqiptare. Më parë, menjëherë pas Luftës, uniforma e Ushtrisë Shqiptare (por edhe e Policisë dhe Sigurimit) do të ishte një kopje 100% e asaj jugosllave, ku pustina do të vijonte të qëndronte edhe më tej në kohë.

Uniformat kineze

Por më vonë do të viheshin re edhe tendencat kineze në uniformat shqiptare, që do të sillnin, veç të tjerash, edhe një “risi” ekstreme në këtë aspekt: do të hiqnin fare gradat e oficerët mund t’i ngatërroje lehtësisht me ndonjë karrocier. Kjo marrëzi vijoi deri në rënien e regjimit në vitin 1991.

Veshja fashiste u përdor edhe pas rënies së Italisë

Por para saj, do të mbizotëronte ajo e Ushtrisë Fashiste, veshje me të cilat do të shiheshin rëndom jo vetëm hierarkët fashistë shqiptarë, por edhe anëtarët e Milicisë. Më 18 shtator 1939, Jakomoni nënshkroi dekretin për krijimin e milicisë fashiste, një nga organizmat e parë të Partisë Fashiste Shqiptare. Kjo strukturë bënte pjesë në Milicinë Vullnetare për Sigurimin Kombëtar. Kjo milici “garantonte zhvillimet e revolucionit fashist”, por angazhohej edhe si trupë elitare në kuadër të ushtrisë. Megjithatë në to shihen qartë edhe simbole kombëtare, si plisa apo qeleshe, e madje shkonte edhe më tej, kur sheh se anëtarët e “Gardës Mbretërore” (Guardia Reale Albanese) parakalonin në mes të Romës, të veshur tërësisht në kostume kombëtare shqiptare. Më tej, ndërsa oficerët do t’i riktheheshin uniformave të monarkisë (duke u hequr sidoqoftë simbolin e Zogut) ushtarët e Ushtrisë Kombëtare, të ringritur gjatë kohës së Regjencës gjatë periudhës së pushtimit gjerman, pas kapitullimit të Italisë, do të vijonin t’i mbanin në pjesën më të madhe për nevoja utilitare, uniformat e ushtrisë italiane, tashmë me emblemën e “shtetit të ripavarësuar” shqiptar.

Partizanët dhe nacionalistët përdorën xhaketat angleze

Ndër partizanët, madje ndër forcat



nacionaliste, do të shiheshin rëndom uniformat britanike, të parashutuara si ndihma nga aleatët, në Luftë ndaj gjermanëve.

Post monizmi dhe kamuflazhet e të gjitha ngjyrave

Periudha e demokracisë do të shihte shumëllojshmëri uniformash që reflektonin edhe varësinë e Ushtrisë

Shqiptare nga ndihmat e ushtrive mike, pa mundur të krijohet dot një model që reflektonte traditën shqiptare.

Shihje rëndom në vitet '90 kamuflazhe lara-lara e eksperimente të dështuara për të unifikuar, sistemuar e organizuar më mirë punën në këtë aspekt, por do të duhej të kalonin shumë vite derisa të vihej re një tendencë pozitive, edhe pse

ajo reflekton sërish një kahje (edhe pse jo negative) imituese përballë aleatëve tanë strategjikë.

Aktualisht, prej vitesh, sidomos pas anëtarësimit në NATO, vihet re një disiplinim edhe në këtë aspekt, duke sjellë më shumë dinjitet e seriozitet për Forcat tona të Armatosura.

2002, ekspozita “Shteti shqiptar në uniforma”

Siç do të kujtonte më vonë studiuesi Artan Lame, në dhjetor 2002, me rastin e 90-vjetorit të Ushtrisë, u hap në Galerinë e Arteve, ekspozita “Shteti shqiptar në uniforma”.

“Shteti shqiptar vuri në dispozicion djelmoshat e Gardës dhe korrentin, unë vura në dispozicion koleksionin tim të uniformave dhe... rezultati. Ekspozita qëndroi e hapur vetëm 4 orë, aq sa mund të rrinin pa ngrënë djemtë e mrekullueshëm të Gardës. Megjithatë ishte një sukses i jashtëzakonshëm dhe, për ditë me radhë, vijuan të shkonin njerëz në Galeri me dëshirën për të parë ekspozitën që nuk ishte më”.

Pranë Akademisë së Mbrojtjes, në kuadër të përmirësimit dhe kompletimit të uniformave ushtarake ngrihen grupe pune.

Në vitin 2004-2005 u bë një studim për uniformat në forcat e armatosura, ku kontribuuan komandat e FT, FA, FD, me specialistë të logjistikës dhe pas përfundimit të mostrave për çdo armë e shërbim, me të gjitha dekoracionet sipas gradave të armëve dhe shërbimeve, u miratua me Vendim të Këshillit të Ministrave. Mbi këtë bazë u përgatit albumi i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, një punë shkencore dhe kombëtare, mbi bazën e traditës shqiptare, përshtatur dhe me uniformat e NATO-s.

Është punuar në vite që të shkohet drejt një standardizimi të plotë të uniformës dhe së fundmi është mbledhur grupi i punës me specialistë të fushës, për rishikimin e modelit të uniformave, për përmirësimin, hartimin dhe kompletimin e dizajnovave, stilimeve, treguesve teknik të uniformave ushtarake, stemave, simboleve dhe shenjave të tjera dalluese të uniformës ushtarake që mban personeli ushtarak i Forcave të Armatosura të RSH. I miratuar me V.K.M nr. 694 datë 21.11.2018 si dhe ato që kanë qenë pjesë e V.K.M nr. 503, datë 13.7.2011 me synim, sigurimin e një prezantimi dinjitoz të ushtarakut të FARSH, mbartjen e simbolikave që evidentojnë identitetin kombëtar dhe sigurimin e lirshmërisë së personelit në kryerjen e aktiviteteve të ndryshme të përditshme, gjatë stërvitjeve dhe operacioneve brenda dhe jashtë vendit, të uniformës ushtarake që mbajnë FARSH.

1. Rregullorja e Uniformave Ushtarake të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë është akti normativ me të cilin rregullohet veprimtaria e strukturave



të FA-së, në lidhje me përdorimin e uniformave, rregullat e përdorimit të tyre si dhe pamjen e jashtme të personelit ushtarak të FA-së.

2. Rregullorja trajton kriteret dhe rregullat të përgjithshme për përdorimin e uniformës së FA-së, llojet e uniformave sipas qëllimit të përdorimit, kompetencat dhe përgjegjësitë e strukturave

ushtarake, në të gjitha nivelet e komandimit të FA-së, në raport me zbatimin e kësaj rregullorjeje.

3. Rregullorja trajton në mënyrë specifike, llojet e stemave të Ministrisë së Mbrojtjes dhe institucioneve të varësive, flamujt dekorativë të njësisë kryesore të FA-së.

4. Rregullorja trajton qartazi përdorimin



e uniformës ushtarake ceremoniale nga ushtarakët e dalë në rezervë dhe veteranët e luftës, gjatë kohës kur ata marrin pjesë në ceremonitë kombëtare dhe lokale, përvjetorë që organizohen nga njësia ku kanë shërbyer, ceremonitë e betimit, kortezhe të përmotshme, festa familjare.

Veshja e uniformës ceremoniale me medaljet përcaktohet me urdhër të komandës së njësisë ose garnizonit ushtarak. Uniforma e Forcave Territoriale, kur përdoret në stërvitje dhe kohë lufte, mund të vishet edhe uniformë e

përzier (civile-ushtarake), sipas rasteve dhe nevojave operative.

Uniforma ceremoniale për efektivin e Orkestrës Frymore dhe për Truprojën e Nderit, vishet vetëm në raste pritjeje zyrtare dhe me urdhër të veçantë.

Ministri i Mbrojtjes ka drejtë të caktojë se cilët ushtarakë mund të mbajnë veshje civile në vend të uniformës ushtarake.

Oficerët e Forcave të Armatosura, që nxirren në rezervë ose pension, me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes, për raste invaliditeti, plotësim moshe,

arsye shëndetësore, shkurtim organike dhe transferim në sektorë të tjerë civilë të pushtetit, kanë të drejtë të mbajnë uniformën ushtarake (me shenjën dalluese në supë), të përcaktuar me urdhrin e daljes në rezervë ose pension.

Burime të marra nga:

- 1) Z. Dorian Koci, studiues i historisë (drejtor i Muzeut Historik Kombëtar);
- 2) Z. Artan Lame (studiues i historisë shqiptare);
- 3) Rregullorja e Uniformës të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Punoi: Anjeza Musollari

SHKOLLA USHTARAKE “SKËNDERBEJ”, HISTORI SUKSESI NDËR BREZA

Shkolla Ushtarake “Skënderbej”, historikisht ka qenë jo vetëm “fidan-ishte e ushtrisë”, por dhe “fidan-ishte” e sportistëve cilësorë, diplomatëve me emër, artistëve me famë, heronjve e dëshmorëve në emër të atdheut, popullit e detyrës që u është besuar.

Të gjithë duhet ta dinë, se në Shqipëri ka ekzistuar një nga shkollat më të mira dhe kjo ka qenë Shkolla e Mesme e Përgjithshme Ushtarake “Skënderbej”, e cila e nisi jetën e saj, më 28 mars të vitit 1945, me pionierët partizanë.

Fillimisht, u emërtua “Shkolla e pionierëve të luftës”, pastaj “Shkolla e kadetëve” dhe më vonë Shkolla e Mesme e Përgjithshme Ushtarake “Skënderbej”. Historia e asaj shkolle është një fill i pashkëputur mësimi, edukimi e formimi kulturor, atdhetar dhe ushtarak. Kjo shkollë do të mbetet gur themeli në historinë e Shqipërisë.

Shkolla Ushtarake “Skënderbej” i dha ushtrisë modelin e ushtarakut të aftë e të përkushtuar, me formim demokratik dhe për rrjedhim, në transformimet e viteve 1990-1991, spikati bindshëm figura e oficerit qytetar të emancipuar dhe patriot.

Historiku i Shkollës së Mesme Ushtarake “Skënderbej”

Më 28 mars 1945, në Tiranë u hap “Shkolla e Pionierëve të Luftës”, ku nxënësit e parë ishin 200 partizanë të vegjël, midis tyre edhe 6 vajza. Në vitet që pasuan numri i nxënësve do të rritej ndjeshëm.

Në shkurt 1947, me urdhër të Komandantit Suprem të Forcave të Armatosura, Nr. A 1-85, datë 11 shkurt 1947, “Shkolla e Pionierëve të Luftës” mori emrin Shkolla e Mesme Ushtarake “Skënderbej”.

Shkolla e nisi veprimtarinë në garnizonin ushtarak të Laprakës, më pas u vendos tek Regjimenti i Ndërlidhjes e së fundmi u vendos tek kompleksi i shkollave ushtarake. Deri në vitin 1953 skënderbegasit morën arsim 7-vjeçar, disa klasë të mesme dhe njohuri ushtarake.

Në vitin 1953 u vendos që shkolla “Skënderbej” të bëhej shkollë plotësisht e mesme e arsimit të përgjithshëm, duke përfshirë në të edhe lëndë të karakterit ushtarak. Shkolla kishte program 4-vjeçar të gërshetuar me fushime dimërore e verore, 15-30 ditë për çdo vit.

Misioni i Shkollës së Mesme Ushtarake “Skënderbej” ishte të përgatiste nxënës me arsim të mesëm ushtarak të përgjithshëm dhe me formim të nevojshëm për ndjekjen e shkollave të larta civile dhe ushtarake, për t’u përgatitur si oficerë të aftë të Forcave të Armatosura.

Nga viti 1960, gati 60% e studentëve të Shkollës së Bashkuar të Oficerëve vinin nga Shkolla e Mesme Ushtarake “Skënderbej”. Në vitin 1992 Shkolla e Mesme Ushtarake “Skënderbej” u mbyll.

Akademia Ushtarake “Skënderbej”

Shkolla “Skënderbej”, që nga viti i parë i krijimit të saj e deri në mbyllje, me



Misioni i Shkollës së Mesme Ushtarake “Skënderbej” ishte të përgatiste nxënës me arsim të mesëm ushtarak të përgjithshëm dhe me formim të nevojshëm për ndjekjen e shkollave të larta civile dhe ushtarake, për t’u përgatitur si oficerë të aftë të Forcave të Armatosura.



Vendimin e Këshillit të Mbrojtjes Nr. 3, datë 17.8.1992, ishte furnizuesja kryesore e Shkollës së Lartë të Bashkuar të Oficerëve në Tiranë, Akademisë Ajrore dhe asaj të detarisë...

Akademia Ushtarake "Skënderbej" u krijua, më 8 nëntor 1944, si një kurs i ulët për përgatitjen e kadrove e oficerëve. Në janar të vitit 1945 u vendos në Tiranë. Më 8 janar të vitit 1949 ajo mori emrin "Shkolla e Lartë e Bashkuar e Oficerëve 'Enver Hoxha'". Për herë të parë në këtë shkollë në vitin mësimor 1967-1968 u pranuan femrat, qindra prej të cilave e kanë mbaruar me sukses atë. Shkollën e Bashkuar e kanë drejtuar gjeneralë e komandantë të shquar si Vaskë Gjino, Gjin Marku, Thoma Xhixho, Qazim Kapisyzi, Enver Begeja, Halil Xhuka, Spiro Adhami, Rustem Peci, Aleks Andoni, Perlat Sula, Armand Vinçani, Luan Hoxha etj.

Mijëra ushtarakë kanë studiuar në këtë shkollë, ndërkohë që dhjetëra prej tyre kanë arritur të drejtojnë strukturat më të larta ushtarake dhe të marrin gradën "gjeneral". Në vitin 1993 kjo shkollë mori emrin Akademia Ushtarake "Skënderbej". Ka qenë vatra kryesore e përgatitjes së oficerëve për ushtrinë shqiptare. Referuar sa më sipër, shkurtimisht,

në historikun e Shkollës së Mesme të Përgjithshme Ushtarake "Skënderbej", mund të përmendim:

Me vendim të qeverisë shqiptare, më 28 mars të vitit 1945, rreth katër muaj pas çlirimit të vendit, nis aktivitetin Shkolla e Mesme të Përgjithshme Ushtarake "Skënderbej"

- Nxënësit, skënderbegas të parë të këtij institucioni të rëndësishëm ishin gjithsej 200 djem e vajza të reja partizanë, që erdhën në bankat e kësaj shkolle me armë në dorë, direkt nga fronti i luftës.

- Mes 200 nxënësve të parë të kësaj shkolle ishin dhe 6 vajza partizane, ndër to, Katerina Prifti, Xhevahire Golemi e Veronika Murzaku...

- Komandant i parë i Shkollës së Pionierëve (më vonë u emërua Shkolla e Mesme të Përgjithshme Ushtarake "Skënderbej"), u vendos Thoma Frashëri.

- Ndër kuadrot e parë të kësaj shkolle ishin Dule Pashai (drejtor), komandant Isuf Bobaj si dhe kuadrot e mësuesit Kadri Mullai, Shuaip Laze, Filip Stefani, Miço Kola, Pavlina Grabocka, Selman Tafa, Hamdi Cani, Kadrie Kopliku, Arqile Kondi, Thoma Frashëri, Luto Haxhiu, Stavri Angjeli, Bajram Shamku, Fiqiri Shtepani, Sotir Polena...

Më 10 korrik 1945, ditën e krijimit të ushtrisë, kuadratet e skënderbegasve parakaluan në bulevardin e Tiranës.

- Në shkurt të vitit 1947, shkolla e pionierëve, me Dekret të Presidiumit të Kuvendit Popullor, mori emrin "Shkolla e Mesme e Përgjithshme Ushtarake "Skënderbej".

- Në fillim të vitit 1948, komisar i shkollës u emërua Koço Lako, ndërsa drejtor i saj Stavri Angjeli.

Në fund të vitit 1948, komandant i shkollës emërohet Ferit Radovicka, ndërsa komisar emërohet Bedri Gjergji. Në vitin shkollor 1949-1950, rritet numri i skënderbegasve, dhe shkolla transferohet në Laprakë.

Fillimi i vitit mësimor 1951-1952 u bë në Vlorë.

Në Olimpiadën Teatrale të zhvilluar në vitin 1954, Shkolla e Mesme e Përgjithshme Ushtarake "Skënderbej", mori Fletë Lavdërimi nga Ministria e Arsimit dhe Kulturës.

Në verën e vitit 1956, shkolla mori pjesë në aksionin për shpyllëzimin e kodrave të Zall Herit.

Në shtator të vitit 1959, Shkolla e Mesme e Përgjithshme Ushtarake "Skënderbej", zhvendoset në kazermat e Regjimentit të Ndërlidhjes.

Në gusht të vitit 1966, për një muaj

rresht, nxënësit e Shkollës së Mesme të Përgjithshme Ushtarake “Skënderbej”, bënë aksion në Bizë për të mbledhur humus për tokat e reja dhe në Tapizë të Tiranës për shpyllëzim e hapjen e tokave të reja.

Në shtator të vitit 1966, drejtor i shkollës emërohet Fiqri Shtëpani.

Në nëntor të vitit 1966, në festimet për nder të 28-29 nëntorit, ditës së pavarësisë dhe çlirimit, efektiv i shkollës “Skënderbej” manifestoi kalimin me not dhe pajime të liqenit artificial, në prani të Enver Hoxhës e udhëheqësve të tjerë të vendit.

Në qershor të vitit 1967, Shkolla e Mesme e Përgjithshme Ushtarake “Skënderbej”, kreu aksionin e njohur në ndihmë të bujqësisë (prashitje misri e korrje gruri) në Zall Herr.

Në maj të vitit 1967, Presidiumi i Kuvendit Popullor i RPSH i dha shkollës Urdhrin “Naim Frashëri” të klasit të III-të, për rezultate të larta të qëndrueshme sportive.

Në qershor të vitit 1967, Presidiumi i Kuvendit Popullor të Republikës Popullore të Shqipërisë, dekoron organizatën e rinisë së shkollës me Urdhrin “Për shërbime të shquara ushtarake dhe shoqërore të klasit të III-të” me motivacionin: “Është dalluar për rezultate të larta në përgatitjen politike-ushtarake, në forcimin e vigjilencës e të disiplinës dhe të rregullit ushtarak, për punë edukative me rininë në marrjen e iniciativave të reja për revolucionarizimin e stërvitjes dhe për ta bërë ushtrinë sa më pak të kushtueshme”.

Në vitin shkollor 1967-1968, kontingjente të maturantëve të shkollës, vijuan studimet e larta në Universitetin e Tiranës dhe në Institutin Fizkulturës “Vojo Kushi”.

Në gusht të vitit 1968, matura e skënderbegasve mori pjesë në aksionin kombëtar për hapjen e rrugës në Malësinë e Madhe. Për këtë punë të shkëlqyer në aksion, më 23 qershor të vitit 1968, Presidiumi i Kuvendit Popullor i Republikës Popullore të Shqipërisë, dekoron organizatën e BRPSH të Shkollës “Skënderbej” me Urdhrin e Punës së klasit të I, me motivacion: “Ka manifestuar një frymë të lartë gatishmërie për të kapërcyer pengesat.

Ka punuar në frontet më të vështira dhe ka arritur rezultate të larta në punë duke u bërë shembull për mijëra vullnetarë që

merrnin pjesë në ndërtimin e rrugës së Malësisë së Madhe. Ka qenë shembull në organizimin e një pune të vazhdueshme ideopolitike, duke e kthyer aksionin në një vatër të madhe për edukimin komunist të rinisë”.

Në fillim të vitit shkollor 1971-1972, (muaji shtator) shkolla “Skënderbej” kreu aksionin për tarracimin e kodrave të Ksamilit në Sarandë.

Nga 21 tetori 1972 deri në 4 nëntor, shkolla kreu aksionin për korrjen e misrit në Çermë të Lushnjës.

Në shtator të vitit 1973, vitet e II, III, IV të shkollës “Skënderbej” ishin në aksion për ndërtimin e hekurudhës Elbasan-Përrenjas, përkatësisht në sektorin e Hotolishtit. Puna e një muaji, u krye në 20 ditë.

Më datë 28 shkurt të vitit 1974, Presidiumi i Kuvendit Popullor të Shqipërisë, i dha organizatës së rinisë së Shkollës Ushtarake “Skënderbej” Urdhrin e Punës së klasit të I, me motivacionin: “Ka organizuar dhe ka drejtuar mirë punën për edukimin politik dhe ideologjik të rinisë. Ka arritur rezultate shumë të mira në punë për ndërtimin e hekurudhës Elbasan-Përrenjas, duke u bërë shembull për organizatën e rinisë. Ka zhvilluar aktivitete të gjithanshme, duke e kthyer aksionin në një vatër të madhe për edukimin klasor e revolucionar të rinisë”.





Në shtator të vitit 1975, shkolla “Skënderbej”, (viti i tretë), mori pjesë në aksionin për ndërtimin e Kombinatit Metalurgjik “Çeliku i Partisë” në Elbasan, përkatësisht në ndërtimin e TEC-it në këtë vepër.

Pas diplomimit në maturë (matura 1976-1977), një grup nga shkolla “Skënderbej” dërgohen për të ndjekur studimet në degën e Kufirit në Shkollën e Ministrisë së Brendshme.

Matura e vitit 1977, stazhin e prodhimit (një vit) e kanë kryer në ndërtimin e hidrocentralit “Drita e Partisë” në Fierzë.

Edhe maturantët skënderbegas të vitit pasardhës, stazhin në prodhim e kryen po në ndërtimin e hidrocentralit “Drita e Partisë” në Fierzë. Në këtë vepër energjetike, si pasojë e aksidentit në punë, humbi jetën tragjikisht skënderbegasi Arben Kiteni, i Elektro-Mekanikes, dega radio...

Në vitin 1978, skënderbegasit e vitit të tretë kryen një muaj aksion për fortifikimin

në Ballenjë të Matit e Shupenzë të Dibrës. Më 29 nëntor 1979, në Paradën e Madhe të 35-vjetorit të çlirimit të atdheut, kuadrat e Shkollës së Mesme të Përgjithshme Ushtarake “Skënderbej” ishin më të mirët në ceremoninë festive.

Skënderbegasit maturantë të vitit mësimor 1978-1979, stazhin e prodhimit (1979-1980) e kryen tre muaj në hidrocentralin “Enver Hoxha” të Komanit dhe 6 muaj të tjerë në hekurudhën Laç-Shkodër, përkatësisht në sektorin e Mjedës.

Viti mësimor 1980-1981 regjistron 1083 skënderbegas që ndjekin këtë shkollë në të gjitha degët e saj.

Në muajin qershor të vitit 1981, skënderbegasit e vitit mësimor 1980-1981, zhvilluan aksionin në Cepo të Gjirokastrës, për hapjen e rrugës së re automobilistike dhe në Patos për hapjen e kanaleve. Matura e vitit 1980, punën prodhuese njëvjeçare (viti mësimor 1980-1981) e kreu

në Ksamil të Sarandës.

Në qershor të vitit 1982, skënderbegasit e vitit të tretë bënë aksion për fortifikimin e vendit në Mal të Kuq të rrethit të Korçës dhe në Cerencë të Pogradecit.

Skënderbegasit e vitit mësimor 1982-1983 (vitet e treta), kryen aksion njëmuajor në ndihmë të bujqësisë në Rrëshen të Mirditës dhe në Brar të Tiranës.

Skënderbegasit e viteve të dyta e të treta, në qershor të vitit 1984, kryen aksionin në tarracat me agrume në Sasej (Bunec) të Lukovës. Maturantët e vitit 1985, punën prodhuese e kryen në uzinat ushtarake të Tiranës.



Në janar të vitit 1986, skënderbegasit shkuan për fushim dimëror në Voskopojë të Korçës.

Në qershor të vitit 1986, skënderbegasit e vitit të tretë kryen një muaj aksion në ndihmë të bujqësisë në Grabian të Lushnjës.

Në qershor të vitit 1988, skënderbegasit e vitit të tretë punuan një muaj për ndërtimin e hekurudhës Milot-Rrëshen-Klos, përkatësisht në sektorët Shkpezë, Tarazh dhe Prosek.

Në qershor të vitit 1989, skënderbegasit morën pjesë në aksionin për mbledhjen e bimëve medicinale në Qafëmollë dhe Feken të Tiranës.

15 nëntor 1993, në zbatim të një dekreti të veçantë të Presidentit Sali Berisha, me urdhër të Ministrisë të Mbrojtjes Sali Berisha, mbyllet Shkolla e Mesme Ushtarake "Skënderbej". Që nga krijimi i saj, më 28 mars 1945, deri në mbyllje më 15 nëntor 1993, në Shkollën Ushtarake "Skënder-

bej" kanë studiuar mbi 35 mijë vetë.

Thuajse gjithë gjeneralët që ka sot ushtria shqiptare kanë dalë nga bankat e asaj shkollë.

Niveli i përgatitjes së nxënësve të saj ishte i tillë sa në konkurset kombëtare të shkollave të mesme, kjo shkollë merrte pjesë jashtë klasifikimit, pasi mund të zinte pa diskutim vendin e parë me çdo ekip të saj, për mos të folur se gjithë ekipet e të rinjve të klubit sportiv "Partizani" dilnin nga kjo shkollë. Nuk mund të quhet rastësi që nga pesë oficerët e Ushtrisë Shqiptare, që shkuan vullnetarë në radhët e UÇK-së, brenda në territorin e Kosovës, para

Jemi skënderbegas

**Tani jemi bërë,
Gjyshër-baballarë,
Po s'harrojmë kurrë,
Strehëzën e parë.**

**Strehëzën e parë,
Shkollën "Skënderbej",
Ky emër-si gjaku,
Na rrjedh nëpër dej.**

**Atdheu-të vegjël,
Na kishte filiza,
Po ai na rriti,
Na bëri lisa.**

**Dhe na bëri lisa,
Në pyll' të Lirisë,
Dhe ishim të gjithë,
Djemtë e vegjëlisë.**

**Djemtë e vegjëlisë,
Punëtorë e fshatarë,
Gati për beteja,
Në vijën e parë.**

**Plot me ideale,
Dhe me ëndërrime,
Aty more udhë,
Moj rinia ime.**

**Frymëzim të shenjtë,
Kishim Skënderbeun,
Në sy e në zemër,
Mbanim gjithë Atdheun.**

**Mbanim fushat-malet,
E gjithë Shqipërisë,
Prag i asaj shkollë,
Si pragu i shtëpisë.**

**Ai na përkundi,
Në djep dashurie,
Emri "Skënderbegas!",
Emër krenarie!**

**Për jetë të gdhundur,
E kemi në ballë,
Jemi skënderbegas,
Sa të jemi gjallë.**

**Po dhe kur të sosim,
Këtu rrugëtimet,
Kur ne të mos jemi,
Do të jenë kujtimet!**

IN MEMORIAM



26-vjetori i rënies
në krye të detyrës së
Dëshmorit të Atdheut,
kapiten I Nuredin Gorçe

“Çdo gjë për atdhe, Komando jemi ne”

Kush bie për atdhe, mbetet një yll i pashuar, i tillë është dhe Dëshmori i Atdheut Nuredin Gorçe, i cili në 26-vjetorin e rënies së tij do të “rivijë” në memorien tonë mes kujtimeve të nënkolonelit Behar Mara, ish-koleg, protagonist i ngjarjeve të '97-s. “Kjo është motoja që ka udhëhequr Koman-

dot Shqiptare në të gjitha misionet dhe detyrat që kanë kryer anembanë vendit. Kanë kaluar plot 25 vjet që nga dita e rënies në krye të detyrës së heroit të parë të komandove, kapiten I Nuredin Gorçe. “Komando” janë një emër i dashur nga i gjithë populli ynë, kjo njohje vjen për

faktin dhe peshën e madhe të detyrave që ata kanë kryer, jo vetëm në misione jashtë vendit, por edhe rolin e veçantë që ata kanë luajtur në ngjarjet mjaft të vështira të trazirave të vitit 1999. Për çdo ushtarak, por edhe për çdo shqiptar ngjarjet e vështira të '97-s kujtohen me

mjaft dhimbje, për faktin se destabiliteti politik i vendit dhe anarkia e krijuar kudo i vuri strukturat e FA-ve në vështirësi të mëdha për të përmbushur detyrat e tyre. Kjo erdhi për faktin se vala e revoltës mbarë popullore, si rezultat i humbjes së të ardhurave në firmat piramidale, solli një tërmet dhe revoltë popullore, e cila, e shoqëruar edhe me paaftësinë e strukturave politike, institucionale, por edhe ushtarake për të drejtuar dhe menaxhuar situatën e krijuar, çoi në degradimin dhe përshkallëzimin e situatës, deri hapjen e depove të armatimit dhe marrjen e shkatërrimin e arsenalit ushtarak të kohës. Pa dashur të bëj

precipituar, armët kishin rënë në dorën e popullit, Reparti i Zall-Herrit tashmë po haste vështirësi, sepse kishte dyndje të popullatës që kërkonin armë, por ata u përballën me vendosmërinë e oficerëve të patrembur, të cilët kishin vendosur të mbronin repartin, kështjellën e tyre të palëkundur, të ruanin emrin e tyre të mirë, i cili ishte gdhendur në mendjen e çdo Shqiptari. Mbrojtja e repartit është detyrë për çdo ushtarak, por për ne ishte fatale të shkatërrohej kjo pasuri e ngritur me mund e djersë, rënia e kësaj strukture elitë do thoshte se ushtria s'do kishte ringritje, emri "Komando" nuk do të ekzistonte, sepse vlerat që mbanin në

nga turma njerëzish nga katër anët, të cilët të irrituar kërkonin medoemos hapjen e repartit nga ku të merrnin armët, duke na njollosur dhe turpëruar dhe vënë përpara historisë, e cila këtë gabim s'do na e falte kurrë. Të gjendur përballë vendosmërisë sonë, ligjit për ruajtjen e repartit, falë mbështetjes së gjithanshme të pjesës më të madhe të popullatës të fshatit Zall-Herr, turmat e irrituara u zmbropsën disa herë, duke bërë të pamundur rënien e këtij reparti elitë të quajtur , 'Komando'.

Mbrojtja e repartit na kushtoi shumë, ne humbëm heroin tonë të përkushtuar shefin e Xhenios, ushtarakun e nderuar, kapiten I Nuredin Gorçe, Dëshmorin e Atdheut, i cili ra në krye të detyrës për të mbrojtur infrastrukturën ushtarake të repartit, duke e bërë këtë repart të pamposhtur, përballë çdo rreziku sado i vështirë që ishte. Ne krenohemi me këtë repart, jo vetëm se pikërisht në këto ngjarje djemtë e kësaj njësie e kanë treguar veten, por më pas ishte ky repart të cilit iu dha detyra të kryente sigurinë e objekteve të rëndësishme shtetërore, jo vetën në Tiranë por anembanë vendit.

Emri 'komando' është lartësuar dhe vazhdon të lartësohet me misionet e tyre jashtë vendit, duke filluar nga Bosnje-Hercegovina, Afganistani, Iraku, Chadi dhe së fundi në Kosovë, ku komandot me disiplinën dhe profesionalizmin e tyre kanë shkëlqyer, duke mbajtur lart emrin e madh që kanë. Do doja të sillja në vëmendje të gjithë heronjtë e këtyre ngjarjeve, duke filluar nga Komandanti i Brigadës, kolonel Arben Çuko, kolonel Fatmir Lokaj, n/kol Rexhep Bleta, major Vladimir Vladi, major Shaqir Koliçaj, major Hajri Zhukri, major Përparim Tota, major Lulzim Sefa, major Asqeri Çeta, major Aleko Çuli, major Vangjel Ndini, kapiten Liman Hoxha, kapiten Behar Mara, kapiten Fatmir Lleshi, kapiten Haki Dingu, kapiten Elidon Shehu, kapiten Altin Bundo, kapiten Ylli Prifti, kapiten Musa Hida, toger Julian Prenga, kapiten Flamur Melani, kapiten Petrit Baçe, kapiten Besnik Saliasi, n/ oficerët Arjan Rasa, Lutfi Hoxha, Ramazan Xhepa, Astrit Hoxha e të tjerë, të cilët kanë meritat e tyre të veçanta që historia në memorien e saj do t'i përmendë, si heronjtë e heshtur, të cilët i bënë një shërbim të madh vendit të tyre. Ne mblidhemi çdo 20 mars, të kujtojmë heroin tonë të pavdekësisë, kapitenin e parë Nuredin Gorçe.

Nënkolonel Behar Mara, ish-koleg, protagonist i ngjarjeve të '97-s



analogji dhe analizë të këtyre ngjarjeve, ajo që duhet të them si bashkëvuajtës i këtyre situatave është se zemërat e brendshme popullore ishte e aq e madhe dhe e drejtë, saqë asnjë ushtarak nuk mund të reagonte ndaj turmës të dëshpëruar, të cilët kërkonin kursimet e tyre tashmë të humbura. Brigada Komando e Zall-Herrit, e cila ishte krijuar në vitin 1995, si pasuese e strukturave të zbulimit, tashmë me 6 batalionet e saj të dislokuara në qytete të ndryshme të vendit, si Shkodër, Përmet, Pogradec, Berat dhe 2 batalione në Zall-Herr Tiranë, ishin të angazhuara për të vendosur dhe ruajtur situatën e sigurisë tashmë të dalë jashtë kontrollit. Të ndodhur përballë kësaj situatë, në gjykimin tim ishte e pamundur për të kryer detyra, pasi revolta ishte aq e madhe, ku do ishte më e udhës të shmangej vëlla-vrasja dhe të merreshin masa për të ruajtur repartet dhe kontribuar më tej në vendosjen e rendit tashmë të dalë jashtë kontrollit. Situata tashmë kishte

këmbë këtë kolonë të fuqishme të FA-së do rrëzoheshin bashkë me atë fatalitet që sollën ngjarjet e zymta të '97-s.

A e përmbyesën komandot misionin e tyre përballë këtyre ngjarjeve të vështira?

Brigada Komando është ndër njësitë e vetme të FA-së e cila nuk u dëmtua gjatë trazirave të '97-s, kjo falë vendosmërisë, përkushtimit dhe profesionalizmit të oficerëve, n/ oficerëve dhe ushtarëve të kësaj njësie elitë, të cilët jo vetëm e mbrojtën garnizonin e tyre, por u bënë burim frymëzimi edhe për repartet e tjera, ku mund të shikonin sinjalit e shpresës për t'u ringritur dhe kryer misionin e tyre. Duke kujtuar me dhimbje këto ngjarje, por edhe duke qenë krenar për atë çfarë ne bëmë, jo vetëm për të ruajtur repartin, por edhe rolin që patën komandot më vonë në ruajtjen dhe sigurinë e objekteve të rëndësishme të vendit. Është vështirë të sjellësh në vëmendje ngjarje të tilla, si ato të marsit të vitit '97 ku ne qëndruam me ditë dhe net të tëra edhe pse reparti i rrethuar

Atdheu përjetë mirënjohës

Viti 1997 do të mbetet në memorien e shqiptarëve si një vit i tmerrshëm dhe i përgjakshëm.

Mijëra të rinj humbën jetën, pasi popullsia ishte e armatosur për shkak të hapjes së depove të armatimit. Shkodra mbetet një prej qyteteve me bilancet më të rënda nga kjo 'luftë civile', por falë sakrificave të disa oficerëve të policisë dhe ushtrisë, situata nuk u përkeqësua edhe më tej, pasi populli mund të pajisej me granata apo raketa.

Të gjithë shkodranët mbajnë mend mbrëmjen e 12 marsit të vitit 1997, ditën kur qindra qytetarë u nisën drejt repartit ushtarak dhe baterisë kundër-ajrore, që ndodhej në Dobraç, për të marrë armë. Atë mbrëmje të hidhur ranë dëshmorë të atdheut edhe 2 oficerët e ushtrisë, Muhamet Hasmuja dhe Arben Hoxha.

Muhamet Hasmuja, kapiten i parë, asokohe ishte 38 vjeç, ishte emëruar komandant i bazës, ndërsa Arben Hoxha nga Elbasani ishte toger, oficer i këtij reparti. Kolegë të tyre, kujtojnë ditën e 12 marsit, ku po shërbenin dy oficerët.

“Rreth orës 12.00 u inspektua baza kundër-ajrore në Dobraç, për t’u njohur me masat që oficerët kishin marrë për mbrojtje, pasi ishte situatë problematike. Muhameti si drejtues kishte marrë masa shumë të mira dhe gjithçka ishte e organizuar ashtu siç e kërkonte protokoli.

Orët e mbrëmjes së 12 marsit, u shoqëruan me sulmin e turmave ndaj reparteve ushtarake të Shkodrës. Rreth orës 19.30 minuta, ra Divizioni Ushtarak i Shkodrës, ku ishte e gjithë komanda e veriut. Urdhri ishte i qartë për drejtuesit e reparteve të tjera, që askush të mos përdorte armët, por të mbronin depot, zyrat dhe të gjitha godinat e ushtrisë. Pak orë më vonë, sulmi vazhdoi drejt Dobraçit, aty ku ishte bateria kundër-ajrore me drejtues. Kur turmat mbërritën tek reparti, ata tentuan të thyejnë barrierat dhe të futen. Ushtarët dhe oficerët ishin në njërin krah me armë në duar, por pa urdhër për të qëlluar dhe në tjetrin krah turmat, ku mes tyre ishin edhe të armatosur. Në këtë situatë, Muhameti vendosi të futej në mes të turmës dhe oficerëve të tij për të shmangur përplasjet, pasi ushtarët ishin nën presion.

“Ai po u bënte thirrje qytetarëve që të largoheshin dhe situata të qetësohej. Në një moment, ai u rrëzua. Një dorë e zezë, nga turma qëlloi me armë drejt tij. Komandanti nuk u dëgjua më dhe u dha alarmi se Muhameti është qëlluar. Drejt tij u nisën oficerët Arben Hoxha dhe Agron Kodra për ta ndihmuar, por është dëgjuar një tjetër breshëri zjarri dhe të dy u rrëzuan”, - tregon ish-shefi i shtabit të regjimentit kundër-ajror, Ndue Marku. Arben Hoxha, oficeri nga Elbasani, humbi jetën menjëherë, ndërsa oficeri tjetër Agron Kodra, u qëllua me 7 plumba, por për fatin e tij të mirë shpëtoi. Duke parë agravimin e situatës, ushtarët u detyruan që të qëllonin në ajër dhe të mbroheshin nga plumbat e turmave. Shkëmbimi i zjarrit ka vijuar deri rreth orës 3 të mëngjesit të 13 marsit, kur turmat janë tërhequr. Me një kamion, trupat e tyre janë transportuar për në spitalin e Shkodrës, ku janë njoftuar edhe familjarët. Arben Hoxha, u dërgua më pas në



Elbasan tek familjarët e tij.

Por çfarë pasojash do të kishte për Shkodrën dhe Shqipërinë, nëse reparti kundër-ajror nuk do të mbrohej deri në fund dhe do të ishte në duart e turmave?

“Pasoja fatale! Fatkeqësi të jashtëzakonshme. Kemi të bëjmë me topa kundër-ajror, raketa në gatishmëri për zjarr dhe tritol. Një pakujdesi sado e vogël, madje edhe një cigare, do të shkaktonte shpërthimin e tyre, pa llogaritur më pas nëse dikush do të aktivizonte topat apo raketat. Pasojat do të ishin fatale për mijëra njerëz”, - shpjegojnë ekspertët. Në vitin 1998, Muhamet Hasmuji dhe Arben Hoxhën, Këshilli i Qarkut të Shkodrës i shpalli “Dëshmorë të Atdheut”. Në nderim të tyre u ngrit edhe një obelisk tek ish-regjimenti kundër-ajror në Tepe.

“FIDANISHTJA” SKËNDERBEGASE, ELITA E SPORTIT KOMBËTAR

Krahas punës së madhe e të vazhdueshme mësimore të skënderbegasve, po kaq rëndësi i kushtojë edhe përgatitjes fiziko-ushtarake të tyre. Nisur nga perspektiva që i priste skënderbegasit, të cilët do të bëheshin oficerë në të gjitha llojet e armëve dhe shërbimeve të ushtrisë, kërkohet prej tyre që të ishin edhe të përgatitur mirë fizikisht e ushtarakisht, për të përballuar me sukses vështirësitë e detyrave. Për këtë qëllim, komanda dhe drejtorja e shkollës, së bashku me mësuesit e edukimit fizik, shpesh herë bënë edhe ndryshimet e programeve të përgatitjes fizike, duke shtuar orët e kësaj lënde e duke i dhënë më shumë rëndësi këtij komponenti. Për këtë qëllim u bënë ndryshime të mëdha në infrastrukturën e kësaj lënde mësimore. U ndërtua palestra moderne me të gjitha parametrat bashkëkohore, u ndërtua brezi i kalitjes fizike, palestra e boksit, mundjes dhe peshëngritjes, në territorin e shkollës u ndërtuan fusha futbollit, basketbollit, volejbollit etj. Të gjitha këto bënë që mësimi i edukimit fizik e ushtarak të marrë rëndësinë e vet dhe nxënësit të përgatiten sa më mirë dhe jo vetëm kaq, por gjatë orëve të pushimit dhe ditëve të diela shkolla e shtoi së tepërmi veprimtaritë e saj sportive. Skënderbegasit u bënë të njohur në gjithë vendin për përgatitjen e tyre fizike e nivelin e lartë sportiv.

KS “Partizani” u krijua mbas çlirimit, në vitin 1946, ku bazë e tij u bënë djemtë e brigadave dhe divizioneve partizane të ushtrisë e sidomos nxënësit e shkollës ushtarake “Skënderbej” dhe të kursit të oficerëve, të cilët përfaqësuan ushtrinë në veprimtaritë e para sportive.

Sportistët e mëdhenj e të gjithanshëm

Çfarë “Partizani” ishte ky kampion i ri, qysh në pjesëmarrjen e tij të parë?

Fitoret e ndritshme të “Partizanit” tregojnë se ç’ hov të madh kishte marrë fizikultura në Ushtrinë Kombëtare.

Ndërsa 20 emrat e parë kampionë të futbollit partizan janë Stërmasi, Kamberi, Njala, Fagu, Cuciqi, Vathi, Demneri, Sakiqi, Pelingu, Baçi, L. Hoxha, Pengjili, Tafmizi-Gjinali, Gavoçi, Dauti, Lisi, Bakalli, Merhori, me trajner-lojtar Sllave Llambi.

Pa mbaruar kampionati i futbollit, papritmas shfaqet një Partizan tjetër, “Partizani” i boksit, i cili shpallet kampion i



Shqipërisë, duke u bërë ky “Partizani” i parë që fiton si ekip një kampionat kombëtar të Shqipërisë. Madje, edhe me plot pesë tituj individualë në peshat përkatëse.

La paraqesim brezit të ri për të qenë krenar me arritjet në disiplinën e ndryshme, ky klub tashmë i formësuar do të arrinte fitore të njëpasnjëshme: Myftar Marku, Ndrek Zefi, Mehmet Kryeziu, Naum Gjançi, dhe tjetri, më i veçanti, është Ali Kastrioti që shpallet kampion, duke fituar ndaj legjendës shqiptare të boksit Rafail Dishnicës.

Është “Partizani” i sportit të boksit pra, ai i cili fiton për këtë klub ushtarak, titullin e parë të Kampionit të Shqipërisë si ekip. Dhe vetëm mbas tij, më 12 tetor 1947, fiton titullin e parë të



Kampionit të Shqipërisë, Skuadra e futbollit e “Partizanit” duhet të jetë më “modeste” e t’u lëshojë ende rrugë kampionëve të tjerë partizanas të Shqipërisë para saj.

Shpërthen i papërmbyshëm një “Partizan” shumë-sportesh që step Shqipërinë sportive, sikur të kërkonte t’i thoshte: “ke parë ende pak”.

Mbas titullit të boksit 1947, papritmas mbërrin çiklizmi

Është 15 qershor 1947 dhe një çiklist i mrekullueshëm, Gani Laçej i “Partizanit”, fiton titullin e Kampionit të Shqipërisë si fitues i Rrethit Çiklistik të Shqipërisë.

Ka përshkuar, duke mbetur i pari, plot 1120 kilometra rrugë të Shqipërisë, duke hyrë në qytete i pritur me buqeta me lule e duartkoqitje pafund.

Dhe pa kaluar muaji, më 13 korrik 1947, “Partizani” fiton për herë të parë titullin e Kampionit të Shqipërisë në not për meshkuj, duke marrë edhe tre tituj të kampionit në garat individuale: Ilija Gjymshana në 100 metra shpinë, Kamber Rrapushi në 200 metra stil i lirë, si dhe në stafetën 3 x100 stil i përzier.

Tashmë, në këtë vit 1947, thuhet kudo është “Partizani”.

Herë me yll e herë pa yll në gjoks, herë me fanella të kuqe e ndonjëherë edhe të bardha, herë me të reja e ndonjëherë me paksa të zhubrosura, ai shfaqet gjithnjë e më sundues, gjithnjë e më tërheqës, gjithnjë e më fitimtar.

Nuk ndalet “Partizani”

Është 24 gusht 1947. Mbërrin kampionati kombëtar i Atletikës së Lehtë dhe titullin e kampionit si ekip për meshkuj po për herë të parë në histori e fiton “Partizani” i Ushtrisë Kombëtare! Madje, duke rrëmbyer me meritë të plotë edhe plot 11 tituj të kampionëve individualë në gara: Zef Frania në 100 metra e 110 metra me pengesa; Galip Sojli në 800, 1500 e 10.000 metra; në stafetën 4x100 e 4x400 metra; me kampionin Tahir Puka në 400 metra me pengesa; në kërcimin me shkop me Fadil Bushatin, në disk me Zisi Kondin dhe në çekiç me Shahin Vatën.

Futbollit partizanas i është dashur të presë jo pak për të marrë titullin e parë të kampionit.

Datat e mëdha në një histori kronologjike themelimesh të çmuara të “Partizanit”, janë këto:

* 13 janar 1945, del për herë të parë në fushën e lojës për një ndeshje miqësore me Vllazninë (0-0) Skuadra e Ushtrisë Kombëtare;

* 7 prill 1946, del për herë të parë në fushën e lojës skuadra me emrin “Partizani” në ndeshjen miqësore (2-0) me 17 Nëntorin;

* 21 prill 1946, “Partizani” luan ndeshjen e parë ndërkombëtare të tij: Partizani - Spartak i Moskës 2-5;

* 10-12 gusht 1946, “Partizani” i Ushtrisë Kombëtare merr pjesë për herë të parë në një kampionat kombëtar të Shqipërisë. Është “Partizani” i sportit të notit, i cili shpallet nën kampion dhe jep dy kampionë në garat;

* 23 gusht 1946, “Partizani” merr pjesë në Kampionatin Kombëtar të Atletikës së Lehtë, ku renditet i treti si ekip, por për herë të parë në histori fiton tre tituj individualë të Kampionit Kombëtar;

* 7 tetor 1946, Xhavit Demneri dhe Bahri Kavaja bëhen lojtarët e parë të “Partizanit”, të cilët veshin fanellën e



Kombëtares. Është ndeshja hapëse e kampionatit ballkanik (Shqipëria- Jugosllavia 2-3);

* 9 tetor 1946, Besim Fagu bëhet lojtari i tretë i “Partizanit”, që vesh fanellën e Kombëtares (Shqipëria-Bullgari 3-1);

*13 tetor 1946, Bahri Kavaja i “Partizanit” është titullari i 11-shes së Kombëtares së Shqipërisë, që shpallet Kampion i Ballkanit (kurorëzimi te Shqipëria-Rumania 1-0);

* 23 mars 1947, “Partizani” del për herë të parë në fushën e lojës për një ndeshje të Kampionatit Kombëtar të Futbollit (Partizani- Tomori 5-2);

* 10 prill 1947, për herë të parë në histori “Partizani” fiton titullin e Kampionit të Shqipërisë në një lloj sporti dhe ky është sporti i boksit, duke pasur edhe 5 kampionë individualë;

* 9 maj 1947, “Partizani” arrin fitoren e tij të parë, madje të madhe, në një ndeshje ndërkombëtare të futbollit: 1-0 Partizani të Beogradit;

* 15 qershor 1947, Gani Laçej i “Partizanit” fiton titullin e kampionit të Shqipërisë si fitues i Rrethit Çiklistik të Shqipërisë;

* 13 korrik 1947, “Partizani” fiton titullin e kampionit të Shqipërisë në not për meshkuj, si dhe me tre kampionë në gara individuale;

* 24 gusht 1947, “Partizani” shpallet për herë të parë Kampion i Shqipërisë për meshkuj në atletikën e lehtë, duke pasur 11 tituj të kampionit në gara individuale, prej 6 atletëve të tij;

* 12 tetor 1947, “Partizani” fiton për herë të parë titullin e Kampionit të Shqipërisë në futboll. (Mbas ndeshjes Partizani-Shqiponja e Gjirokastrës 2-0 për mosparaqitje të gjirokastritëve).

SIGURIA, MBROJTJA DHE POLICIMI NË PUBLIKIMET ZYRTARE SHQIPTARE



Kolonel (R) Prof. Asoc.
Dr. Zaho GOLEMI

Për Shqipërinë e shqiptarët është shkruar nga historianë e albanologë, vendas e të huaj. Por publikimet mbi sigurinë e mbrojtjen zënë fill me themelimin e shtetit të parë shqiptar të Ismail Qemal Bej Vlorës. Faktikisht publikimet morën zhvillim masiv në shek. XX dhe sidomos pas shpalljes së Pavarësisë dhe këtua tema e Atdheut, sigurisë, independencës, gjuhës, zinte vendin themelor. Botime të karakterit ushtarak mbi luftërat, taktikat, artin, strategjinë, sigurinë e brendshme ishin shkruar dhe vazhdonin të shkruheshin, por të pjesësme, ku më tepër i jepej përparësi luftërave të popullit shqiptar për t'u çliruar nga sundimi osman, si dhe synimeve që kishin shtetet fqinje për aneksim të trojeve shqiptare. Ky boshllëk dhe kjo mungesë për botime ushtarake në hapësirën shqiptare po kompensohej me botime të pjesësme në disa vende të Ballkanit e të Evropës, por gjithsesi të pamjaftueshme. Këto ishin shkrime në gazeta dhe revista në gjuhën shqipe nga patriotë dhe atdhetarë të diasporës shqiptare. Vilajetet shqiptare patën disa botime në gjuhën e pushtuesve, por që nuk hidhnin politik mbi shqiptarinë. Vetëm në vitet 1883-1887 arbëreshët e Italisë botuan në Kalabri, organin mujor "Flamuri i Arbërit"; ndërsa në vitet 1884-1885, patriotët Sami e Naim Frashëri në Stamboll, botuan revistën mujore "Drita" dhe "Dituria". Në Bukuresht botohej gazeta "Shqiptari"; në Sofje publikohej "Shqipëria"; në Bruksel, Faik Konica në vitin 1897 boton gazetën "Albania"; në Beograd botohet "Kalendari i Kombit" e "Drita"; në Raguzë "Albania"; në Trieste e Romë "Shpresa e Shqypnisë". Gazetat që luajtën rol të madh ishin edhe "Përlindja e Shqipërisë", "Ylli i dritës", "Populli", "Koha e re", "Vëllazërimi", "Demokracia". Revista e gazeta botoheshin dhe në Londër, në Boston të SHBA-ve, në Kajro të Egjiptit etj. Libri "Shqipëria ç'ka qënë, ç'është e ç'do të bëhetë?" i Sami Frashërit ishte një traktat politik i botuar nga Shoqëria "Dituria" e Bukureshtit, pa emrin e autorit, në mars të vitit 1899, Sami Frashëri pasuroi më tej mendimin politik të Rilindjes dhe ndikoi fuqishëm për zhvillimin e lëvizjes kombëtare shqiptare. Që të gjitha kishin rol në ngritjen e ndërgjegjes kombëtare. Këto botime në fakt hynin, përhapeshin e lexoheshin edhe në Shqipëri. Ato luajtën një rol të veçantë në ngritjen e ndërgjegjes kombëtare, në zgjerimin e lëvizjes çlirimtare dhe masivizimin e saj. Kështu, u bënë pjesë e ndikimit pozitiv në kryengritjet e mëdha të viteve 1908-1911 dhe në fitoren e pavarësisë e krijimin

e shtetit shqiptar, më 28 nëntor 1912. Kur shqiptarët nuk e kishin shtetin e tyre, intelektualët dhe atdhetarët e saj u bënë pishtarët e parë të trajtesave publike përmes zinxhirëve në publikime në kufijtë e mbijetesës së kombit, gjuhës, kulturës sonë. Gazetat dhe revistat mbi sigurinë, policimin dhe mbrojtjen i kanë fillësat institucionale rreth viteve '30-të të shekullit të kaluar, edhe pse shkrime dhe tentativa rreth tyre ka pasur që me krijimin e shtetit shqiptar më 1912-tën.

Rregullorja e parë shqiptare me një faqe dhe shtatë nene

Botimet e kësaj periudhe përshkruajnë mjaft saktë heroizmin dhe trimërinë popullore, duke përcjellë traditën luftarake popullore, të pleksur me elemente të artit luftarak shqiptar të trashëguar në shekuj. Këto botime përligjin maksimën se, "historia njerëzore ishte histori luftërash". Moment i rëndësishëm për Shqipërinë ka qënë botimi, në vitin 1906, i "Programit të çetave". Kjo ishte një rregullore ku përcaktoheshin përgjegjësitë, detyrat dhe të drejtat e kryetarit e të anëtarit të çetës dhe të vetë çetës. Lufta për pavarësinë, për sigurimin e shtetit ishte boshiti themelor i veprimtarisë së çdo çete kryengritëse. Kjo rregullore ushtarake mbushte një boshllëk të konsiderueshëm për kohën. Në rregullore shtrohej nevoja e disiplinës dhe e rregullit ushtarak, për zbatimin me fanatizëm të urdhrit të eporit e të detyrave luftarake, duke hedhur kështu themelet për një organizim ushtarak sipas kohës dhe kushteve në vend. Momenti kulmor i historisë së shqiptarëve ishte shteti i parë i nëntorit 1912, ku u krijua në Vlorë qeveria e parë e përkohshme e Ismail Qemal Bej Vlorës. Pas formimit të qeverisë së parë mbushja e boshllëkut institucional dhe "ndeza" e "makinës shtetërore", ishte një përgjegjësi e madhe përfshi edhe sigurinë e brendshme dhe të jashtme e mbi të gjitha diplomacinë. Nuk bëhej fjalë për botime revistash e gazetash vetëm për sigurinë e mbrojtjen. Ndërkohë që Ministria e Luftës e Gjeneral Mehmet Pashë Dërrallës si dhe Ministria e Brendshme e Myfit Bej Libohovës, filluan përpjekjet për funksionimin institucional, duke menduar për rregulloret e para në planin e sigurisë dhe mbrojtjes, duke vlerësuar sipas kohës edhe milicinë me tipare policore.

Kështu, pas pesë muajsh del rregullorja e parë e Ushtrisë Kombëtare Shqiptare, që mban datën 22 prill 1913. Kjo ishte një përpjekje modeste dhe rregullorja ishte koncentrim rregullash, me një faqe dhe me shtatë nene, që shprehin identitetin kombëtar shqiptar, pas një pushtimi të gjatë prej pesë shekujsh nga Perandoria Osmane. Pas rregullores së parë ushtarake, në qershor të vitit 1913 kemi një tjetër rregullore të milicisë, me tre faqe, por e shkruar në gjuhën osmane, kopje origjinale e së cilës gjendet në fondet arkivore në Arkivin Qendror të Shtetit dhe e ekspozuar në AQFA.

Duhet pranuar se terminologjia e përdorur në vitin e parë të Pavarësisë mbartte ndonjë orientalizëm të përdorur dhe që ka arritur deri sot në gjuhën shqipe si dhe në ndonjë rast për mungesë të njohurive të plota në gjuhën shqipe mund të shkruhej edhe osmanllisht, italisht ose gjermanisht, sipas vendeve ku kishin studiuar ish-ushtarakët shqiptarë në këtë periudhë.

Krijimi i shtetit të ri shqiptar dhe Ushtrisë Kombëtare Shqiptare e

Shtabit Madhor, krahas problemeve të ngritjes së UKSH-së, bëri që të ngrihej edhe një Komision i Terminologjisë Ushtarake. Komisioni përfshinte personalitete me kulturë të gjerë ushtarake e gjuhësore, të cilët zotëronin gjuhë të huaja dhe njihnin mirë gjuhën shqipe.

Fjalori ushtarak ishte "i lehtë", sepse Shqipëria kishte një histori luftërash e betejash të shumta për liri dhe pavarësi kombëtare. Kështu, në gazetën "Liria e Shqipërisë", që botohej në Sofje, për herë të parë, më 29 korrik 1913, në artikullin "Kufizat e ushtrisë", u botua një listë me 26 terma shqip-turqisht, që rrokjin spektrin e sigurisë dhe mbrojtjes në gjuhën osmane. Botimi ishte një nisje e mbarë e terminologjisë ushtarake shqiptare, që u pasua edhe me botime të tjera të shkëputura brenda dhe jashtë vendit. Kopje e Rregullores së milicisë (xhandarmërisë) për tiparet e policisë së kohës, me tre faqe në osmanlisht gjendet aktualisht edhe në Arkivin Qendror të Forcave të Armatosura, në fondet dokumentare të Sektorit të Dokumenteve Administrativë. Kjo kopje e rregullores është marrë dhe pasqyruar për herë të parë e ekspozuar në AQFA.

Në këtë rast bëhet fjalë për terminologjinë ushtarake në fjalët: dylbi, fishek, bori, çizme, fitil zjarr-përcjellës, hendeklidhje, top, xhepa zjarri etj., që sigurisht ndryshonin nga terminologjitë ushtarake të gjuhëve ballkanike. Huazimet më të hershme janë zëvendësuar me fjalë nga brumi i shqipes dhe me terma neolatinë, si dhe për raste kur shqipja nuk gjente në fjalorin e sigurisë e mbrojtjes terma, veprohej me intuitën e përshtatshmërisë ose të përafërimit. Hartimi i rregullores për milicinë shqiptare, dëshmon për nivelin e dijeve dhe të kulturës profesionale të oficerëve, prandaj miratimi i rregullores rriti prestigjin e këtij organi ushtarak jo vetëm në vend. Për këtë rregullore konsulli austro-hungarez në Vlorë do të shkruante: "Zyra (e Shtabi Madhor) hartoi rregulloren mbi funksionimin e milicisë shqiptare, sipas së cilës, kjo e fundit duhej të ishte një forcë e organizuar, e ngritur mbi bazën e detyrimit ushtarak të përgjithshëm dhe që kishte për detyrë mbrojtjen e vendit deri sa të krijohet një ushtri e rregullt".

Personalitete të fushës së terminologjisë mbi sigurinë, milicimin e mbrojtjen ishin ushtarakë shqiptarë që kishin studiuar në akademitë më prestigjioze të kohës, si Major Mustafa Maksuti (Shehu), Kapiten Kamber Sejdiu etj., që bënë përpjekje serioze dhe punë të lavdërueshme për krijimin e termave të sigurisë dhe ushtarako-milicor shqip dhe për shqipërimin e kufizave të ushtrisë e xhandarmërisë, siç i quanin ata, sepse momenti historik e kërkonte që edhe në fushën e termave të kishte origjinalitet, mëvetësi, rilindje. Komisioni terminologjik hodhi bazat e një terminologjie të re ushtarake të gjuhës shqipe në kuptimin e vërtetë të fjalës. Në vargun e termave të krijuara prej tyre bëjnë pjesë komanda ushtarake, emërtime të pjesëve të armëve, të veprimeve me zjarr dhe të organizimit ushtarak si: gatitu!, qetësohu!, eja në radhë!, tetësh (për skuadër), tog(ë), tubë, trumbë (për kompani), griq (për batalion), sogorië (për regjiment), ushtret (për gjeneral), deder (për admiral), epror, depror, gjilpërë, këmbëz (e shkrepjes), shënjestër, siguresë, klith (për bori) e klithtar (borizan), etj.

Në revistën "Zgjimi" të Korçës, në numrat 2, 3 të vitit 1913, u botua një listë me 315 terma e togfjalësha terminologjikë ushtarakë. Në vitin 1912 në Konstanca të Rumanisë u punua fjalori i ushtrimeve ushtarake i emërtuar "Përvuajtjet vetmore", me 315 komanda dhe ushtrime stërvitore. Në Ushtrinë Mbretërore vijuan përpjekjet për pasurimin e mëtejshëm dhe kodifikimin e terminologjisë ushtarake, që kapin gjithë fjalorin e kohës për ushtrinë por edhe për xhandarmërinë. U botuan dy fjalorë të emërtuar: "Terminologji ushtarake", shqip-shpjegues-italisht dhe italisht-shqip, me rreth 700 terma, botuar në Tiranë, në 1932 dhe "Manual bisedimi me landë ushtarake", në shqip-italisht-sllavisht me 1350 fjalë e shprehje, botuar në Tiranë në vitin 1933. Në Statutin themeltar të Mbretërisë shqiptare, në vitin 1928, në artikullin 197 të saj thuhej se: "Liria e fjalës dhe e shtypit është e garantuar, censura parandaluese nuk mund të vihet, përveç në kohë lufte, mobilizimi dhe në raste të jashtëzakonshme të tjera, të parashikuara prej ligjit. Kushtet mbi rregullimin e shtypit, konfiskimi i shtypshkrimeve dhe ndjekjet ligjore mbi gabimet e shtypit caktohen me ligj. Vetëm shtetasit shqiptarë mund të nxjerrin gazeta në Shqipëri".

Pas organizimit të shtetit mbretëror shqiptar, kemi për herë të parë të organizuar një shtyp ushtarak. Ai kishte strukturat e veta dhe përfshinte shtypshkronjën e vet, në strukturën e vitit 1929, e dokumentuar kjo në Fletoret Zyrtare të këtij viti.

Pas pavarësisë shqiptare dhe në harkun kohor të këtyre dy dhjetëvjeçarëve u publikuan dhe botimet e para për Skënderbeun nga historianë e shkencëtarë si Fan Noli, Gega, Buda, Marinesku, Monti, etj. Historiani i shquar rumun Nikolla Jorga (1841-1940), i cili u pushkatua nga policia fashiste, ka zbuluar në bibliotekën "Laurentina" të

Firences, dokumentin e parë të shkruar në gjuhën shqipe "Formulën e pagëzimit: (1462), të shkruar nga këshilltari dhe bashkëpunëtori i Skënderbeut, kryepeshkopi i Durrësit, Pal Engjëlli. Pas tij ka pasur edhe shumë kërkues që kanë hulumtuar në këtë fushë dhe se ende ka shumë arkiva që, sikurse thonë historianët, ende nuk u është hequr "korja". Të gjithë këta botuan shkrime për heroin kombëtar, i cili ka qenë një prijës lufte dhe natyra e shkrimeve të tyre rrokte probleme të botës ushtarake dhe qëndrësën e shqiptarëve përballë pushtuesve. Intensiteti i studimeve për gjeneralizmin e Skënderbeut në shek. XX është rritur shumë, aq sa bibliografia e botimeve për veprën e tij arrin mbi 1000 libra në 21 gjuhë të ndryshme të globit.

Buletini dhe e përkohshmja ushtarake – erë e re për publikimet e mbrojtjes dhe sigurisë

Vitet 1920-1924, në kushtet e shtetit të ri, të një lufte botërore, të përpjekjeve për konsolidim të shtetit, ishin vite të turbullta për shtetin e brishtë shqiptar, kështu që nuk pati ndonjë interes të veçantë në fushën e botimeve ushtarake. Gjatë viteve 1920-1939 u hodhën hapa të rëndësishëm në ndërtimin dhe fuqizimin e strukturave shtetërore, çka mundësonte të vihen në themele më të organizuara edhe botimet ushtarake. Një numër rregulloresh, instruksionesh e teksteve mësimore për trupa dhe për shkollat ushtarake ndikuan në ndërtimin e administratës, në rregullimin e jetës së brendshme të ushtrisë, në përgatitjen luftarake të reparteve e në kualifikimin e kuadrove. Botimi i parë i shtypit ushtarak në Ushtrinë Kombëtare Shqiptare ishte revista "Buletini dhe e përkohshmja ushtarake", që doli më 1 qershor 1931, dhe pasuesja e saj "Revista ushtarake" në vitin 1937. Dalja e revistës së parë ushtarake ishte eveniment i kohës në jetën e institucioneve të sigurisë dhe mbrojtjes së periudhës së Mbretërisë shqiptare, që në këtë kohë ishte vetëm tre vjeçare. Tradita e dy dekadave pas krijimit të Ushtrisë Kombëtare dhe xhandarmërisë shqiptare ishte traditë e praktiketit holandez dhe britanik për xhandarmërinë edhe pse fusha e publikimeve ishte e varfër në këtë kohë.

Dalja e "Revistës ushtarake" nuk ishte përvoja e parë, sepse artikuj të ndryshëm për sigurinë ushtarake, organizimin, reformat, ideatorët, modernizimin, uniformat, armatimin, traditën etj., ishin të pranishme në shtypin e kohës, si në vend dhe jashtë hapësirës shqiptare, që me fillimin e shek. XX ka qenë tepër aktiv. Kjo edhe nga fakti që shqiptarët kanë qenë të etur për shtetin e tyre të qëndrueshëm në këtë periudhë.

Megjithëse nuk botohej asnjë titull gazete, buletin apo revistë për ushtrinë dhe problematikën rreth saj, përsëri shkrimet rreth saj gjenin vend në shtypin e shkruar brenda Shqipërisë, por edhe në diasporë.

Këto ndikuan në rrugën e gjatë luftarake të popullit për rritjen e vetëdijes kombëtare, si dhe përçuan traditat, përvojën dhe aftësitë luftarake të shqiptarëve në shekuj. Kjo qëndrësë shqiptare do të zinte vend edhe në faqet e shtypit ushtarak shqiptar në vitet '30 të shek. XX. Në gazetën "Përlindja e Shqipërisë" u publikuan veprat e Qeverisë së Vlorës, kryesuar nga Ismail Qemali dhe të intelektualëve shqiptarë përfshi kolonitë e mërgimtarëve, si dhe të gjitha përpjekjet e para për ngritjen e ushtrisë kombëtare shqiptare, të Ministrisë së Luftës si dhe të Shtabit Madhor. Thelbi, qëllimet dhe synimet e "Përlindjes së Shqipërisë", qëndron tek mbrojtja e tërësisë territoriale shqiptare, që ishte njëherazi edhe zëdhënëse besnike e Qeverisë së Përkohshme të Vlorës, tribunë e lëvizjes shqiptare gjithëkombëtare.

Me krijimin e Mbretërisë Shqiptare, më 1928-tën, u realizua organizimi i parë në fushën e botimeve ushtarake të shtypit ushtarak të shkruar, që synonin në respektimin e traditave historike dhe sidomos ushtarake të kombit shqiptar. Dalja e botimit të revistës së parë ushtarake ishte jo vetëm eveniment për kohën, por edhe një ngjarje në jetën e vendit, sepse Ushtria Kombëtare ishte një ndër bazamentet më të rëndësishme të qeverisë për kohën në të cilën kalonte vendi. Edhe zgjidhjet strukturore të vendit përballë Fuqive të Mëdha ishin mjaft komplekse kur dihet se prej vitit 1913 u lanë jashtë trugut shqiptar pothuaj gjysma e trojeve etnike. Nga analiza e publikimeve të viteve '30-të vërejmë se në numrin e parë të Revistës Ushtarake ka pasur tetë rubrika që fillon me Mesazhin e Naltmadhënisë së tij Mbretit, parathënia nga Gjenerali Aranitasi, qëllimi i revistës nga drejtorja e shkruar nga nënkolonel Enrico Grassi, "Sa gëzim i madh" nga kolonel Akif Pashë Përmeti, "Disiplina" nga kolonel Giuseppe Vitelli, "Mbi stërvitjen" nga nënkolonel De Michelis, Bashkëveprimi, nga kolonel S. Martino; Pjesëtime shkrimesh të ndryshme nga nënkolonel Vivaldi dhe së fundi një rubrikë "Buletini" me tre faqe gjithsej dhe që kishte 34 emërime ushtarake në të gjitha llojet e armëve e shërbimeve. Drejtor i revistës ishte një italian i afirmuar në fushën e publikimeve në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes, siç ishte italianin nënkolonel Enrico Grassi. Kështu

në ambientet ushtarake dhe ato të xhandarmërisë shqiptare po flitej edhe për shtypin e publikimet, ndërkohë që letër-punuesit, pergamentarët dhe libër-lidhësit kishin filluar punë në Evropë që në kohën e Gutenbergut në shek. XV.

Në mesazhin, që kryetari i shtetit, ai edhe mbreti i dërgon numrit të parë të saj shkruhej se: "Dy sende janë të nevojshme për me i dalë në krye kësaj pune: studimi që e ban të hollë mendjen dhe stërvitja që zhvillon kuptimin praktik. Atdheu, me therorët e tij, ju jep gjithçka asht e mundshme; asht detyra e juaj t'ia shpagoni dashtuninë dhe besimin e tij, tue u banun mësimtarë të zotë, në kohë paqe e prisja e trima në kohë lufte, me anë të studimit të papremë dhe të kujdesit me gjith' zemër". Ndërsa më poshtë vijon: "Përgatitni mendjen e juaj me zell, me besë e me qëndresë dhe forconi shpirtin e juaj me disiplinë të hekurte dhe me dashunie atdhetare, për me ken të zotët me ba çdo sakrificë për përballimin e të gjithë vështirësive që mund të pengojnë të mrijtunit e idealit të shenjtë të Atdheut". Përkujdesja serioze e elitës më të lartë politike dhe ushtarake të vendit ndaj shtypit ushtarak duket edhe në përhëndetjen që Komandanti i Mbrojtjes Kombëtare Shqiptare, Gjeneral Xhemal Aranitasi bënte në revistën "Buletini dhe e përkohshmja ushtarake", të titulluar "Parathanje", që në fakt ishte një "Thirrje!", që u drejtohej gjithë pjesëtarëve të Ushtrisë Kombëtare shqiptare: "Me këtë fashikull del për herë të parë një revistë shqiptare ushtarake që prej formimit të Ushtrisë Shqiptare, e cila do të jetë një bazë e mirë për përkohshimin e përgjithshëm kultural e ushtarak të gjithë ushtrisë. Dalja e revistës difton një përparim të ri në zhvillimin e ushtrisë, e cila e konsideron si detyrën e saj më të bukur, me ba gjithçka...". Deri në ditët tona kanë ardhur 75 numra të revistës që gjenden në Bibliotekën Kombëtare. Publikimi ka vijuar nga viti 1931 deri më 1938. Në përfundim të "Thirrjes" së Komandantit të Mbrojtjes Kombëtare Shqiptare, Gjeneral Xhemal Aranitasi nënvizohet: "Në këtë vështrim revista në artikujt e saj plot mision do të jetë një udhëheqëse besnike për pjesëtarët e ushtrisë, ajo do të influencojë e do të favorizojë dijen e artë ushtarake për me arrijt sukseset ma të nalta të vertyteve 'besnikëri e trimëri' për Mbret e për Atdhe". Duhet theksuar se në këtë përhëndetje kishte lavdërim të theksuara. Edhe në numrat e tjerë që vijuan "Buletini dhe e përkohshmja ushtarake" ruajti të njëjtën linjë. Në numrin e dytë të revistës nuk ishte përsëri me tetë rubrika, por u pasurua dhe u bë me 14 rubrika. Godina dhe zyrat e Drejtorisë së Revistës kanë qenë të lëvizshme. Kështu nga kazerma "Skënderbeg" drejtorja e shtypit ushtarak u vendos pranë Komandës së Mbrojtjes Kombëtare në Bulevardin "Benito Musolini", në nr. 73, të këtij bulevardi. Nga shfletimi i kësaj reviste rezultoi se numri 7, i revistës kishte 7 rubrika me 24 faqe, numri 8, publikuar në Kallunor 1932 dhe që fillon me një urim të kolonelit italian Enrico Grassi. Kjo revistë ka 40 faqe gjithsej. Më tej në revistën ushtarake shohim të bëhej dhe pyetje se cili ishte qëllimi i Revistës Ushtarake.

Mirëpo, qëllimi i Revistës Ushtarake ishte i prezantuar në numrin e parë të saj në dy faqe, dhe konkretisht në faqet 11 dhe 12. Ja si shpalosej qëllimi: "Qëllimi i Revistës asht me përhapë e me pasuruem kulturën ushtarake të kuadrove tue i stërvitë n'at njësi që e ban ushtrinë të bindun me një metodë të vetme e me një vullnet të vetëm". Tek qëllimi jepeshin edhe disa nga të dhënat fillestare për të si "Revista ishte mujore, e përkohshme, që kishte drejtorin, redaksinë dhe administratën pranë Komandës së Mbrojtjes Kombëtare. Numri i faqeve të Buletinit ishte i lëvizshëm dhe që paraqiste një vijmësi në rritje të faqeve nga 24-40 faqe, ku përmbledheshin shkrime të larmishme, buletini zyrtar me emërime, shkarkime, transferime si dhe komunikime të ndryshme. Në faqet e saj botoheshin edhe argumente morale e teknike ushtarake, si dhe ngjarje e lajme të huaja. Në fakt riprodhimet e botimeve të huaja ishin në platformën e saj. Staf i drejtues i kryesuar nga nënkolonel Enrico Grassi, në numrin e dytë të saj paraqitet me gradën Kolonel shprehej se, "Kjo revistë ka me qenë palestra e gjimnastikës së mendjes".

"Do të jetë një palestër për të gjithë lexuesit, të cilët kanë me mujtë m'e plotësue përgatitjen e tyre mendore tue bashkëpunue në këtë revistë". "Buletini dhe e përkohshmja ushtarake" i kushtonte vëmendje të gjithë armëve të ushtrisë, si një mjet të fuqishëm për të ngulur thellësisht ndjenjën e bashkëpunimit. Më konkretisht në faqet e tij gjejmë: "Kështu që shtypi, si topi, si pushka, si shpata, si zemrat e të gjithë shqiptarëve, ka me qenë një armë e re për shërbimin e besës shqiptare për me i bam të pakapërcyeshme kufijtë e Atdheut e të sigurt marshimin kah fati që i përket.

Me këtë frymë po e nis jetën e vet që sjell energji të reja dhe urim të

përzemërt për madhësinë e fuqive armate shqiptare", përfundon shkrimi redaksional që shpalos qëllimet e shtypit në numrin e parë të "Buletinit dhe të përkohshmes ushtarake". Në kohën e ringritjes së Ushtrisë Kombëtare shqiptare dhjetëra ushtarakë të huaj shërbyen me dekret mbretëror shqiptar. I tillë ishte edhe drejtori i parë i revistës, koloneli italian Enrico Grassi. Në dhjetor 1931, drejtori i gazetës botoi një urim me rastin e 8-mujorit të daljes së numrit të parë. "Kameratë! Kjo revistë e jonë po mbush tetë muaj. Simbas dëshirës së Naltmadhënisë së Tij Mbretit, filloi në maj. Ka ndjekë ligjën e natyrshme. Qiti lule në pranverë e dha frute verore e vjeshtore". Krahas direktivave se si i mirëpret shkrimet revista e parë ushtarake, jep edhe këshilla dhe orientime për të marrë shembull nga poeti Gjergj Fishta, si poet i madh kombëtar. Urimi i drejtorit u drejtohet të gjithë kategorisë së ushtarakëve: "Të shkruemet asht përfundimi i një vëmendjeje të pasueme. Vetëm ai që mendon thellë ka dijeninë mbi sa shkruhen prandaj dhe është përgjegjës". Karakteri i revistës del qartë në këto radhë: "Revista jonë asht ushtarake, fare ushtarake. Don të jetë shesh i ushtrimit i mendjeve ushtarake...". Urimi i drejtorit në tre faqe ishte mjaft poetik që synonte të rrënjoste dy elementë thelbësorë, progresin përmes bashkimit, duke parë në dritë të diellit "fatin shqiptar", dhe urimin e mbyllte me devizën: "Rroftë Mbreti! Rroftë Shqipnija!". Koloneli Enrico Grassi drejtoi "Buletin dhe të përkohshmen ushtarake" me profesionalizëm deri në vitin 1933, kur më pas vendi i drejtorit të revistës iu besua nënkolonelit Luigi Bonfatti, nga viti 1933 deri në 1934. Për tre vjet të tjera nga viti 1934 deri në 1936 revista u drejtua nga major Leonardo Motzoi. Në vitin 1937 stafi i revistës u ndërrua dhe revistës iu ndryshua emri i saj nga "Buletini dhe e përkohshmja ushtarake" në "Rivista ushtarake", emërtim që do të ripërsëritej dalja e kësaj reviste në vitin 1992. Nga pamja, nga formati, nga përmbajtja, nga ngjyra dhe nga simbolet që kishte në kopertinë nuk pati asnjë ndryshim. Në gusht të vitit 1936 për herë të parë në krye të shtypit ushtarak shqiptar ishte toger Shaban Strazimiri dhe më vonë nënkolonel Sami Koka, i cili e drejtoi këtë revistë të përmuajshme deri në 1939, në numrin 91, pra nga numri 78-91. Revista vijoi të publikohej me 60 faqe, në gjuhën shqipe dhe trajtonte po ato probleme ushtarake si më parë. Me pushtimin fashist italian, shumica e gazetave që dilnin gjatë kohës së mbretërisë e pushuan aktivitetin e tyre dhe filluan të dalin një sërë gazetash të tjera, në shërbim të fashizmit italian. Ndërmjet revistave dhe gazetave që ndërprejnë aktivitetin ishte dhe "Rivista Ushtarake", Organ i Komandës së Mbrojtjes Kombëtare shqiptare. Ka pasur gjithashtu edhe një revistë të ilustruar me katër faqe të titulluar "Fuqitë e Armatosura të 25-vjetorit", në vitin 1938. Në fakt është publikuar vetëm një numër special, me rastin e 25-vjetorit të Pavarësisë dhe ishte organ i Komandës së Mbrojtjes Kombëtare. Drejtor i kësaj reviste ishte toger Shaban Strazimiri. Tematika e shkrimeve gjatë një dekade në shtypin ushtarak ka qenë e larmishme, por e kufizuar brenda limiteve të politikës së "përbashkuar" italo-shqiptare. Ka pasur dhe numra që e gjithë revista të ishte një përkthim i tematikave të ushtrisë italiane si dhe i ushtrive të tjera të botës. Në faqet e revistës nuk mungonin edhe botimet enciklopedike të kohës nga shtete, ushtri, teknologji, kazerma, luftëra të njerëzimit në shekuj, zbulime të reja etj. Periudha e republikës së parë dhe ajo e mbretërisë, kishte organizim të atij niveli, që xhandarmëria që kryente funksione policore nuk kishte shpëputje nga rregullat ushtarake e administrative sepse, rregulloret ishin të përbashkëta, po kështu edhe publikimet ishin edhe për armën e Xhandarmërisë, sepse për çështje ushtarake si dhe për gradime, disiplinë, gjykime, faje xhandarmëria varej nga Ministria e Luftës, ndërsa për çështje administrative e qetësisë nga MPB-ja; ndërsa për çështje drejtësie nga Ministria e Drejtësisë. Nga pikëpamja organike ndahet në qark, në çdo prefekturë, në rreth për çdo nënprefekturë, në postkomanda për çdo krahinë ose fshat në vartësi me sasinë e banorëve. Emërimi e qarkullimi i oficerëve të xhandarmërisë bëhej me propozim të Komandës së Përgjithshme të Xhandarmërisë, por edhe me pëlqimin e MPB-së, për të gjithë organizimet e saj në të 4 seksionet, 9 qarkkomandat, 40 rrethkomandat dhe strukturat e vartësisë. Edhe në vitet që pasuan sërisht Policia nuk gjeti qetësi si rezultat i riorganizimeve dhe dekreteve për ngritjen dhe për shkrirjen e këtij formacioni të rëndësishëm të shtetformimit dhe qëndrueshmërisë e sigurisë së tij.

Lexuesi ushtarak, dhe jo vetëm, i kohës së mbretërisë gjente të dhëna sikurse janë në artikullin "Armët dhe të tjera", që bën "autopsinë" e zhvillimeve demografike të ushtrive dhe të shpenzimeve ushtarake të disa prej ushtrive më të përparuara të kohës. Kështu po të vëzh-

gojmë një ndër shkrimet karakteristike të kohës gjejmë të dhëna që lidhen edhe me kostot ushtarake të kohës, të disa prej ushtrive më të zhvilluara të globit si: Belgjika 16.5% të GDP. SHBA 20.1% të GDP; Jugosllavia 18.7% të GDP; Rumania 28.5% të GDP; Turqia 38% të GDP; Shqipëria shpenzonte për ushtrinë, veçanërisht për xhandarmërinë rreth 40-45% të GDP.

Rinia ushtarake shqiptare në nivele nëntogerë, togerë e kapitenë, si dhe gradat e tjera më të larta ishin pak të angazhuar në profilizimin e gazetarisë ushtarake, çfarë mbulohej jo në pak raste, sikurse thotë një shprehje e popullit tonë "me miell hua", ku edhe "buka" e letrarizimit ushtarak në shtyp vinte erë italo-perëndimore. Për publikimet në revistën ushtarake një burim i rëndësishëm ishin të dhënat për çështjet ushtarake, të cilat jepen edhe në të dy botimet e Teki Selenicës "Shqipëria në vitin 1927 e ilustruar" (botim i vitit 1928) dhe "Shqipëria më 1937" (botim i vitit 1938); si dhe një libër serioz në fushën e historisë ushtarake, i nënkolonelit italian Raul Vivaldi "Përmbledhje historike ushtarake" (botim i vitit 1931) i përkthyer në shqip, me rreth 140 faqe, ku trajtohen në mënyrë të përmbledhur historia e luftërave të popullit shqiptar dhe të ushtrisë shqiptare nga lashtësia deri në vitet '20 të shek. XX.

Përpjekje u bënë veçanërisht në fushën e rregulloreve, për policinë, por nuk kanë qenë efektive publikimet rreth saj; ndërkohë që organizimi strukturor policor ka qenë i brishtë.

Fakt është se, Policia ka funksionuar gjatë tre muajve në Luftën e Vlorës, në vitet 1920 – 1922, në vitet 1925 – 1935. Rol ka luajtur në Shqipëri edhe xhandarmëria shëtitëse me funksione policore. Në kohën e luftës u organizuan disa lloje policish. Policia ishte një institucion civil, e cila urdhërohej në nivel vendor nga prefekti, ndërsa varej tërthorazi nga Ministria e Punëve të Brendshme. Në qendrat e qyteteve ishin komiseritë e policisë me komisarë, inspektore, dektektivë, etj. Më 1922 u shkri Drejtoria e Përgjithshme e Policisë. Më 22.12.1925, me ligj të posaçëm u krijuan zyrat e policisë në Tiranë, Berat, Elbasan, Korçë, Vlorë, Gjirokastrë, Shkodër dhe Durrës. Ndërsa me Dekret të 20.12.1926, është formuar Drejtoria e Përgjithshme e Policisë me të drejtat e drejtorive të tjera të MPB-së, por pesha dhe rëndësia në piramidën shtetërore e policisë ishte në fakt mbi pagën e vendosur nga buxheti i shtetit të kësaj periudhe. Për sa i përket publikimeve do të kalonin vite që policia të kishte organet e veta të publikimit në formatin e një reviste por krejtësisht të kontrolluar nga ish-organet e specializuara të diktaturës. Pushtimi fashist italian solli vetëm erën e pushtimit dhe të gjitha qeveritë nën pushtim ishin të detyruara të vepronin vetëm sipas udhëzimeve, direktivave e dekreteve të Romës, sepse Shqipëria ishte bashkuar nën një mbretëri të madhe ushtarakisht e juridikisht, ndërsa diplomacia nuk kishte fare "ministri", sepse ajo mbulohej nga qeveria e Romës. Preteksti i xhandarmërisë së "riorganizuar" ishte patericë e pushtuesit, që komandonin në çdo qelizë të jetës së vendit. Më 8.3.1943, krijohet Arma e Xhandarmërisë "për me u kujdesun për sigurinë dhe rregullimin publik e për me përgjue respektimin e ligjeve dhe rregulloreve". Deri në vitin 1939, krahas organeve të sigurisë, mbrojtjes e xhandarmërisë u publikuan dhjetëra gazeta si në Tiranë, Korçë, Vlorë, Shkodër, Gjirokastrë etj., si "Gazeta e Korçës", që ishte vijim i gazetës "Korytza", "Posta e Korçës", "Gazeta e re", "Toska", "Shqipnia", "Besa", Gazeta shqiptare si botim në shqip i "La Gazzetta di Puglia" e më pas "La Gazzetta del Mezzogiorno". Gazeta shqiptare ishte vazhdim e gazetës "Çpallje e posaçme e Shqipërisë", që u botua në Bari, më 6 gusht 1914, deri më 1916, si dhe mjaft gazeta të tjera që trajtonin edhe çështjet e rendit, sigurisë dhe mbrojtjes, por nën këndvështrime të ndryshme, kryesisht për interesa pushteti dhe propagande.

Bum botimesh në rreshtat e brigadave e divizioneve partizane, por edhe pushtuesit dhe Aleatët anglo-amerikanë

Me pushtimin e Shqipërisë (1939-1944), dolën në treg shumë gazeta e revista, thellësisht propagandistike në shërbim të fashizmit apo nazizmit, si p.sh "Bolletino" (1940), "Buletini i jashtëzakonshëm" (1943-1944), Revista e përdyjavshme "Krahët e Luftës" (1941-1942), që botoi 26 numra në Romë; Gazeta "Lirija e Shqipnis" (1944) organ i Forcave të Armatosura gjermane që botohej në gjuhën shqipe. Gazeta përpunohej nga Fuqitë e Armatosura gjermane në Shqipëri, që bënin propagandë të ethshme lufte dhe fitoreje edhe në çastet kur ushtria hitleriane ishte në tërheqje nga të gjithë frontet, në tetor 1944. Në të gjitha këto lloj gazetash gjen artikuj bombastikë që as gjermanët si dhe as bashkëpunëtorët e tyre kudo që ishin nuk i besonin. Krahas shtypit ushtarak me karakter e ideologji fashiste, e më gjerë

dolën edhe mjaft gazeta antifashiste, gazeta të njëjseve, brigadave sulmuese, batalioneve, divizioneve partizane, qarqeve të çliruara etj. Por botoheshin dhe gazeta poetike të kohës dhe viti 1944, mbahet si viti më i pasur në botimin e gazetave dhe revistave ushtarake, në historikun e të gjithë shtypit shqiptar të krahasuar me shumë dekada, që ishte edhe viti më i vullshëm për shqiptarët përgjatë Luftës së Dytë Botërore. Fillimisht përvoja e botimeve direkt në vijën e luftës ishte sipas modelit të ushtrive të mëdha ndërluftuese që përveç armëve dhe përlëshjeve të gjakosura për jetë a vdekje luftohej me të gjithë format, edhe me publikime direkt në vijën e zjarrit, me parulla paniku për kundërshtarin, me pllakada, karikatura, këngë dhe gjithë mënyrat e tjera.

Disa nga gazetat e revistat e përkohshme, të cilat dolën gjatë Luftës së Dytë Botërore si nga ana e lëvizjes së forcave nacionalçlirimtare, ashtu edhe nga ato të forcave fashiste e naziste, si p.sh "Bolletino" (1940), "Buletini i Luftës Nacionalçlirimtare" (1943-1944), "Buletini i jashtëzakonshëm" (1943-1944), "Buletin i përdyjavshëm" (1944-1945), e shumë buletine të tjera. Publikimet përgjatë luftës ishin të shumanshme nga pushtuesit italianë e gjermanë, nga qeveritarët e Tiranës, që publikonin nën bekimin e pushtuesit si dhe publikime që bëheshin edhe drejtpërdrejt në rreshtat partizane. Një ndër publikimet gjatë LIIB ishte "Krahët e Luftës" (1941-1942), që ishte revistë e përdyjavshme. Botimi i parë është bërë më 10.6.1941. Revista "Lirija" (1943-1944), e cila botohej në dy gjuhë në Prishtinë ishte organ i frontit të përbashkët Nacionalçlirimtar të Kosovës e Metohisë dhe që trajtonte lajme nga lufta në të gjitha përmasat e saj. Kjo revistë doli deri në dhjetor 1944. Gazeta "Mundimi" (1943-1944) botohej në Bari të Italisë dhe shpërndahej në Shqipëri. Kjo gazetë ishte e përjavshme vetëm me dy faqe ishte organ politik propagandistik i aviacionit ushtarak britanik dhe ushtrisë amerikane; publikonte informacione të ndryshme propagandistike. Brigada e Parë Sulmuese e drejtuar nga Mehmet Shehu nxori gazetën "Përpara në sulm" (1944), ishte organ politik ushtarak i BrIS. Parulla dhe deviza e saj themelore ishte: "Në sulm, në zjarr, gjithmonë Brigada e Parë". Kjo gazetë kishte dalë në 26 numra gjithsej si dhe numri i parë doli në shkurt 1944, dhe që e vijoi publikimin e saj deri në fitoren mbi fashizmin në të gjithë botën, në vitin 1945. Gazeta "Bucitja", doli për herë të parë në maj të vitit 1944, edhe pse ishte përgatitur që në muajin prill 1944. Kjo gazetë i përkiste si organ ushtarak, politik Brigadës V sulmuese, ose brigadës së Labërisë së Vlorës dhe kishte 46-58 faqe, që mbarnte informacione nga lufta. Kjo gazetë u publikua gjithsej në tre numra. Gazetë politike, ushtarake e Forcave të Armatosura gjermane "Lirija e Shqipërisë" është botuar për herë të parë, më 19 qershor 1944, me dy faqe. Fakt ishte se kjo gazetë ishte naziste, e propagandës së fuqive të armatosura gjermane në gjuhën shqipe dhe shpërndahej çdo dy javë. Kjo gazetë doli me 36 numra, deri në fundin e luftës në vendin tonë. Gjithashtu fuqitë e armatosura gjermane në Shqipëri publikuan edhe "Zani i Atdheut", më 19 nëntor dhe 23 nëntor 1944, ndërkohë që po u sosej fryma e tyre e qëndrimit në Shqipëri. Gazeta "Ylli çlirimtar" (1944-1945), ishte botim politik ushtarak i Divizionit të Parë sulmues, i cili doli në qershor 1944, numri i parë vijoi deri në vitin 1945. Gazeta "Pishtari" (1944) ishte organ politiko-ushtarak i Brigadës VIII Sulmuese, me 48 faqe, doli vetëm katër numra dhe trajtonte problemet e luftës si dhe propagandimin e shtimit të radhëve e formacioneve partizane. Gazeta "Zëri i luftëtarit", organ politik dhe ushtarak i Brigadës IV Sulmuese, që kishte nga 20-24 faqe, por që u publikua vetëm katër numra. Gazeta "Horizonti në ndriçim", ka qenë organ politik e ushtarak i Brigadës XXII Sulmuese. Kjo gazetë u publikua më tetë faqe, doli vetëm katër numra për leximin nga partizanët. Gazeta "Përpara", organ politik dhe ushtarak i Divizionit të Dytë Sulmues (DIIS), gazetë e publikuar me 40 faqe, në vitin 1944. Shkrimtari në formim e sipër, që në rreshtat partizane që gjatë okupacionit, botoi në revistën ilegale "Kushtrimi i Lirisë", çka e bëri atë një zë poetik në rritje dhe një timbër thërës, për kohën, edhe pse politizimit nuk mund t'i shpëtohej dot për rrethanat e kohës. Gazeta e Brigadës XII Sulmuese quhej "Zëri i të riut", dhe ishte, sikurse edhe të formacioneve të tjera partizane, një organ politik, ushtarak, i cili vijoi të publikohej në vitet 1944-1945. Br12S ishte krijuar në Sukë të Përmetit dhe pati aktivitet të suksesshëm përgjatë LANC-it. Gazeta "Iriqi", ishte organ satirik, ushtarak i Brigadës VI Sulmuese, gazetë e cila u publikua me gjashtë faqe, vetëm në dy numra, sepse formacionet luftarake vijonin luftimet deri në çlirimin e plotë të Shqipërisë. Dalja e gazetave në radhët e forcave luftarake ishte sakrificë për fry-

mëzim për luftë dhe shfrytëzohej në intervalet e luftimeve ose marshimet për ridislokim. Duhet thënë se edhe italianët që erdhën si pushtues dhe u shndërruan në partizanë, përreth 1500 vetë, patën publikime të tyre dhe sidomos dokumente që i përkasin Komandës dhe SHP të UNÇSH-së, si dhe të divizionit "Antonio Gramshi". Fundi i Luftës së Dytë Botërore solli në pushtet një regjim të ri, komunistët e modelit të Bllokut Lindor, të cilët e nisën gjithçka nga e para, përfshi edhe revolucionin në shtypin ushtarak, policor, kufitar, të sigurisë së brendshme etj. Tashmë ndryshimi i rendit të ri politik, solli ndryshime rrënjësore edhe në shtyp, duke e parë këtë të fundit si një mjet të fuqishëm të propagandës së vet komuniste, një erë të re ideologjike, erën e bllokut lindor, të gjatë e të vështirë me ndryshime e përmbyse rrënjësore. Që në vitin 1945 dolën organet e para në shërbim të politikës së re komuniste, por në mes tyre dolën edhe organet e para ushtarake të fushës së sigurisë dhe të mbrojtjes.

Shtypi mbi sigurinë e mbrojtjen drejtuar me "dorë të hekurt"

Lufta e Dytë Botërore e renditi Shqipërinë në krahun e fitimtarëve dhe solli ndryshime në formën e organizimit të shtetit, ndërkohë që në pushtet erdhën komunistët, si pjesëtarë të Koalicionit të Madh Antifashist. Riorganizimi shtetëror nisi nga e para me një rend të ri politik, ku solli edhe ndryshime në shtypin mbi sigurinë e brendshme dhe të jashtme si dhe mbrojtjen e atdheut në tërësi. Tashmë është katërcjësorish të pranueshme se, mekanizmi kryesor i propagandës në një shtet diktatorial padyshim që është shtypi i shkruar, shtyp që i nënshtrohej censurës së vazhdueshme, shtypi dhe literatura e kohës ishin armë në duart e shtetit. Informacioni i dhënë ishte në përputhje me parimet ideologjike të diktura nga Partia-Shtet. Gazetat si "Zëri i Popullit", "Bashkimi", "Zëri i Rinisë" dhe "Gazetat e Murit" etj., ishin përcuese të ideologjisë së kohës. Fillimisht gazetat qarkullonin kryesisht në qytete, por shpejt filluan të shkonin edhe në fshatin më të largët me synim informimin e popullit me fjalën e partisë-shtet. Gjatë kësaj kohe roli indoktrinues i shtypit u përdor si instrument kryesor i propagandës shtetërore. Ndalimi i të gjitha organeve alternative të shtypit u shoqërua me krijimin e strukturave që kontrollonin çdo qelizë të veprimtarisë së shtypit të shkruar dhe të medias. Shtypi ishte një organizim në duart e shtetit, shtypi i shkruar, letërsia në çdo lloj forme të saj synonte të përcillte tek njerëzit mesazhin që donte të jepte udhëheqja ideologjike e kohës. Përdorimi i propagandës si mënyrë komunikimi për të manipuluar masat mori përmasa shumë të mëdha, duke marrë në konsideratë edhe izolimin ndërkombëtar të Shqipërisë, sidomos pas ndërprerjes së marrëdhënieve me Kinën. Nga ana tjetër shtypi ushtarak e policor i spektrit të Sigurisë dhe Mbrojtjes, ishte pjesë e së tërës i kontrolluar dhe i censuruar nga partia-shtet. Panorama e shtypit partiak, por edhe atij ushtarak dhe të sigurisë e mbrojtjes në tërësi përfshi gjithë gazetat e revistat ka qenë i konsiderueshëm më funksion të parë propagandën e më tej edhe çështje që kontrolli i censurës e shikonte të arsyeshme për të parë dritën e botimit, por pa i bërë dëm të përgjithshmes, vijës politike dhe ideologjike të drejtimit të kohës.

Në vitin 1945 filluan të lulëzonin shtypi i centralizuar në funksion të një ushtrie të re, Ministrie të Mbrojtjes kombëtare të re si dhe Ministrie të Brendshme të re. Gazeta "Luftëtari", e cila kishte dalë që gjatë luftës, sepse numri i parë doli në tetor 1944 në Tiranë, u bë një ndër gazetate e para që rrokte aspekte të sigurisë e Mbrojtjes në të katër faqet e saj, në të cilën i bëhej jehonë ushtrisë partizane, luftës për çlirimin e Tiranës dhe të gjithë Shqipërisë.

Por gazeta me emrin "Luftëtari" doli rregullisht që nga data 1 maj i vitit 1945, si organ i Ministrisë së Mbrojtjes Kombëtare të vendit dhe u shndërrua në një armë të fuqishme propagandistike për edukimin politik, ideologjik e ushtarako-profesional, të të gjithë efektiveve të Ushtrisë. Edhe pse ka ndryshuar herë pas here formatin, faqet, gazetaret, stafet, në thelb mbeti një gazetë ushtarake, më praktika, me probleme të ditës dhe kryesisht ushtarake. Edhe pse ishte ndër më jetëgjatet e pushoi jetën e saj në vitin 1992, me erën e re demokratike, jo për t'u shuar, por për t'u transformuar.

Gazeta "Luftëtari" u evidentua si një "armë e fuqishme për edukimin politik, ideologjik e ushtarako-profesional, të të gjithë efektiveve të ushtrisë kombëtare". Gazeta "Luftëtari" mbeti një gazetë ushtarake, praktike, teoriko-ushtarake, por gjithnjë në përshtatje me kohën ajo ishte një gazetë propagandistike, për edukimin e njeriut të ri, të brezit të ri të ushtarëve dhe ushtarakëve të të gjitha niveleve me "tiparet e njeriut të ri". Gazeta "Luftëtari", kishte një staf të plotë gazetarësh dhe dhjetëra korrespondentë në të gjithë vendin. Ndryshimet e mëdha demokratike

në vend për këtë tip gazete, prandaj vijuesja e "Luftëtari" u bë gazeta "Ushtria dhe koha", por shpesh njerëzit e ngatëronin në këtë periudhë me gazetën "Koha jonë", që filloi të dilte në Lezhë. Gazeta "Luftëtari" mbi bazën e të dhënave të ish-stafit të saj, ishte si një shok i barabartë me ta, shkante i takonte atje ku shërbenin ushtarakët, i pyeste si ndjeheshin, u jepte zemër, u thoshte një fjalë të mirë, ishin fjalë zemre inkurajuese për misionin e mbrojtjes së atdheut. Në 47 vjet të ekzistencës së kësaj gazete, stafi ishte i shumtë, por po sjellim në vëmendje disa nga stafi i dy dekadave të fundit, që shërbyen te kjo gazetë, të vetëdijshëm se ajo i kishte mundësitë tepër modeste për të na dhënë emër e popullaritet të gjerë si autorë, megjithatë sa herë uleshin të shkruanin, mendonin sikur këtë po e bënim për gazetën më prestigjioze të vendit.

Gazeta "Ushtria dhe koha" u përket viteve 1991-1993 dhe 1993-1997, gazetë që filloi të dilte me 16 faqe. Ajo do të vijonte të trajtonte problemet ushtarake, të para në këndvështrimin e ri politik e shoqëror, e çliuar politikisht, pa censurë dhe pa propagandë, një gazetë ushtarake që trajtonte probleme nga jeta në ushtri deri tek traktatet, aleancat, misionet dhe organizimin e ri të ushtrisë shqiptare, në parametrat evropianë, që kërkonte koha si dhe çështje të sigurisë kombëtare e ndërkombëtare. Ishte një periudhë e shkurtër që pranë Ministrisë së Mbrojtjes doli edhe si revistë "Ushtria dhe koha", vijimësi e revistës "10 korriku", një paralelizëm gazetë-revistë që pothuaj ishin dubël të njëra-tjetrës derisa u hoq nga qarkullimi për t'u zëvendësuar.

Por vjen një kohë dhe në marsin e 1997-tës shteti shqiptar u lëndua rëndë nga hapja e depove dhe protestat për falimentimin e kompanive piramidale. Një dëm i pallogaritshëm për shtetin dhe ushtrinë. Por rifilloi ringritja dhe gazeta e Ministrisë së Mbrojtjes do të emërtohej "Ushtria", që e nisi rrugën e saj më 1997 dhe vijon edhe sot më 2023-shin. Pas trazirave në institucionin e Ministrisë së Mbrojtjes, erdhën emra të rinj, stafe të rinj, dhe gazeta "Ushtria", u rifut në hullinë e kohës. Problematika ishte po ajo, por gjatë kësaj kohe vend të rëndësishëm zuri Lufta e Kosovës dhe gjithë zhvillimet pas saj, përballë makinës ushtarake serbe. Në shekullin e ri gazeta "Ushtria" u bë frymëzuese, aspiruese, mbështetëse e objektivave dhe dëshirës që edhe Ushtria Shqiptare të ishte më së fundi në gjirin e ushtrive perëndimore, për të qenë pjesë e NATO-s, gjë që u arrit me shumë dinjitet, marja e ftesës në Bukuresht, më 2008-tën dhe një vit më vonë anëtarësimi me të drejta të plota. Sot kjo gazetë vijon misionin e saj, nën këtë emër, si një organ dinjitoz i një ushtrie dinjitoze, që kontribuon fuqishëm në prodimin e sigurisë në vendet më problematike të globit brenda kuadrit të NATO-s. Tani Shqipëria nuk është më "konsumatore" e sigurisë, por prodhuese e saj, prandaj kjo pasqyrohet qartë në faqet e "Ushtrisë", edhe pse që nga viti 2014 ajo nuk del më në print, por vetëm në format elektronik, online.

Krahas gazetave rëndësi iu kushtua edhe daljes së revistave, profesionale dhe me ngjyra që të ishin sa më tërheqëse për njerëzit. Kështu revista "10 korriku" u botua në vitin 1947, ku doli dhe numri i parë i saj, si organ i Ministrisë së Mbrojtjes, që trajtonte probleme të edukimit, të jetës artistike e kulturore, të propagandës dhe të përgatitjes teorike dhe ushtarake të ushtarëve. Revista pati jetën më të gjatë dhe vijoi të dalë deri në nëntor 1991. Revista "10 korriku" ishte një revistë ilustrimi dhe më e afërt me ushtarët e kufitarët dhe më e drejtpërdrejtë. Ndërsa numri i 12-të i këtij viti, dhjetor 1991, doli me emrin "Ushtria dhe koha". Mbyllja e "10 korriku"-t (1947-1991), ishte si mbyllja e një epoke.

"Revista ushtarake" doli në vitin 1948, si organ i Ministrisë së Mbrojtjes dhe trajtonte probleme teorike ushtarake, fjalime politike, tema dhe biseda për edukimin komunist, tema ndërkombëtare, të miqësisë e vëllazërisë me Bashkimin Sovjetik, tema historike etj., në funksion të regjimit të formës lindore. Kjo revistë u shndërrua edhe në propaganduese e bllokut të sigurisë e Mbrojtjes të lindjes të kryesuar nga BS, pasi, më 14 maj 1955, edhe Shqipëria aderoi në "Traktatin e Varshavës". "Revista ushtarake politike" kishte si mision kryesor trajtimin e problemeve të përgatitjes politike të ushtarëve dhe oficerëve. Aktiviteti i kësaj reviste zgjati deri në vitin 1954, kur kësaj reviste iu shtua fjala "politike" dhe u shndërrua në "Revista ushtarake politike", e cila trajtonte probleme në rrafshin politik, në edukimin komunist, në forcimin e ushtrisë dhe të kufijve, dhe mbi të gjitha shërbente si udhëzues për përgatitjen politike të ushtrisë shqiptare. Revista u bënte edhe jehonë "tradhtive" ndërkombëtare, forcimi i ushtrisë dhe kufijve, mbi të gjitha ngjante si një udhëzues mbi përgatitjen politike e luftarake të ushtrisë shqiptare nën udhëheqjen e lidershipit politiko-ushtarake.

"Revista politike ushtarake" doli në vitin 1967, pas heqjes së gradave në ushtri dhe rivendosjes së komisarëve dhe të komiteteve të partisë

Në vitin 1945 filluan të lulëzonin shtypi i centralizuar në funksion të një ushtrie të re, Ministrie të Mbrojtjes kombëtare të re si dhe Ministrie të Brendshme të re. Gazeta “Luftëtari”, e cila kishte dalë që gjatë luftës, sepse numri i parë doli në tetor 1944 në Tiranë, u bë një ndër gazetatat e para që rrokte aspekte të sigurisë e Mbrojtjes në të katër faqet e saj, në të cilën i bëhej jehonë ushtrisë partizane, luftës për çlirimin e Tiranës dhe të gjithë Shqipërisë.



në ushtri. Me zbatimin e reformave të marra nga ana e Ministrisë së Mbrojtjes, drejtuesit e revistës menduan që të ishte e përmuajshme, duke i ndryshuar emrin e mëparshëm. Duke bërë si të thuash një rokadë të vogël mes dy mbiemrave revista nga ushtarake-politike do të kalonte në politike-ushtarake. Kështu në radhë të parë ishte politika, pastaj ushtria, përgatitja fizike e teorike e ushtrisë shqiptare. “Për mbrojtjen e atdheut” u motivua si ristrukturim dhe si një rrugë e re për ushtrinë e kohës. Kështu nisi veprimtarinë e saj në vitin 1975, revista “Për mbrojtjen e Atdheut”, pas “shpartallimit të grupeve puçistë” dhe fshesës së hekurt në ushtri, dënimit e ministrit dhe gjithë stafit të lartë ushtarak të Ministrisë së Mbrojtjes, revista mori këtë emër. Revista e mëparshme funksionin e saj politik nuk e kishte luajtur sa duhet dhe “armiku e kishte bërë punën e vet sabotuese” në faqet e saj. Ndaj dhe drejtuesit e rinj ndërruan emrin e revistës teorike, politike, luftarake, ushtarake. Në vitet '70-të u ngrit një Institut, që u quajt “Institut i Studimeve dhe Kërtimeve Ushtarake e Shkencore”, që do të merrej me çështjet më madhore operativo-strategjike të mbrojtjes së vendit, me hartimin e materialeve të domosdoshme mbi AUP, analiza, publikime, konkluzione, raporte për Këshillin Kombëtar të Mbrojtjes, përkthime në interes të ushtrisë dhe sidomos zbulimit, si dhe

rekomandime për udhëheqjen e partisë dhe të shtetit për zhvillimet ushtarake shqiptare dhe perspektivën e mbrojtjes së vendit. Megjithatë ky Institut e pati jetën e shkurtër sepse në të bënë pjesë kadro elitare të ushtrisë që kishin qenë me përvojë nga lufta, kishin kryer akademitë ushtarake në Bashkimin Sovjetik si dhe, më 1 maj 1966, ishin hequr gradat, çka kishte një hatërmetje e fshehur. Për këtë ushtarakët madhorë shikoheshin me dyshim dhe si “puçistë” të mundshëm ndaj pushtetit. Materialet e tyre në atë periudhë publikoheshin në organin “Revista politiko-ushtarake” si dhe më vonë në “Për mbrojtjen e Atdheut”, revistë që është publikuar në Shqipëri, në periudhën e gjysmëshekullit të kaluar. Pas eliminimit të trurit të ushtrisë në Institutin e Studimeve Ushtarake u emëruan ushtarakë të tjerë të sapo thirrur në ushtri, bile kishte edhe nga ata që ishin marrë nga klasa punëtore, duke e kthyer Institutin jo eficient dhe pa produkt. Në 1974-ën pjesa më e madhe e kadrove të Institutit u burgosën për “punë të dobët” të Institutit të Studimeve Ushtarake dhe makina-cione të tjera, ku në fshesën e hekurt të goditjes së ushtarakëve të lartë të Ministrisë së Mbrojtjes, të kryesuar prej Beqir Ballukut, Petrit Dumes dhe Hito Çakos, u përfshinë rreth 400 oficerë si grupi puçist që drejtohej nga “koka e grupit të puçit në ushtri”, që ishte një ndër dëmtimet më të mëdha në të gjithë historikun e ushtrisë shqiptare.

